

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА
ЕВРОПА**



FAKULTETI I DREJTËSISË

FACULTY OF LAW

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

ЦИКЛИ I TRETË I STUDIMEVE-STUDIMET E DOKTORATËS

TEMA E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS:

**SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË TË DREJTËN
KOMPARATIVE ME THEKS TË VEÇANTË NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS**

Kandidati:

MSc. Asmir SADIKU

Mentori:

Prof. Dr. sc. Adnan JASHARI

Nëntor, 2023

DEKLARATË

Vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij hulumtimi.

Deklaroj se ia kaloj Universitetit të drejtat autoriale të punimit, për përdorim për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Kjo temë e disertacionit të doktoratës është shkruar sipas kritereve të përcaktuara dhe duke u bazuar në Rregullorën për ciklin e tretë të studimeve akademike - studime të doktoratës të UEJL-it.

Asmir Sadiku

Nēnēs time, Lirijes...

PËRMBAJTJA

A B S T R A K T I.....	11
A B S T R A C T.....	14
HYRJE.....	18
1. LËNDA DHE NATYRA E PROBLEMIT.....	18
2. RËNDËSIA DHE ARSYESHMËRIA E TEMËS.....	19
3. ZBATUESHMËRIA NË PRAKTIKË, LIDHSHMËRIA ME KOMUNITETIN.....	19
4. HIPOTEZAT.....	20
5.1. Nënhipoteza e parë e veçantë.....	21
5.2. Nënhipoteza e dytë e veçantë.....	22
5.3. Nënhipoteza e tretë e veçantë.....	22
5.4. Nënhipoteza e katër e veçantë.....	22
5.5. Pyetjet kërkimore bazë për këtë punim.....	22
6. Metodatat e hulumtimit.....	23
7. Struktura e disertacionit të doktoratës.....	24
PJESA E PARË.....	26
KAPITULLI I.....	26
1. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME PËR SHKAKTIMIN E DËMIT SI BURIM I DËTYRIMEVE.....	26
1.1. Zhvillimi historik i shkaktimit të dëmit.....	26
1.2. Llojet e përgjegjësisë civile – juridike.....	27
1.3. Shkaqet e shkaktimit të dëmit jomaterial.....	29
1.3.1. Shkaktimi i dëmit jomaterial me sjelljen (veprimin) e njerëzve.....	29
1.3.2. Shkaktimi i dëmit jomaterial nga sendet e rrezikshme ose veprimtaritë e rrezikshme.....	30
1.4. Shkaktimi i dëmit jomaterial nga ngjarjet natyrore.....	31
1.5. Shkaktimi i dëmit jomaterial nga veprimet e njerëzve-aktet terroriste, demonstratat publike dhe manifestimet publike.....	33

1.6.	Shkaktimi i dëmit jomaterial (moral) nga fyerjet, shpifjet dhe cenimi i dinjitetit.....	33
1.7.	Kushtet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.....	34
1.7.1.	Shkaktimi i dëmit.....	35
1.7.2.	Llojet e dëmit.....	35
1.7.2.1.	Dëmi material (i pasurisë).....	36
1.7.2.2.	Dëmi jomaterial (moral).....	37
KAPITULLI II.		38
1.	SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT.....	38
1.1.	Kuptimi i shpërblimit të dëmit.....	38
1.2.	Shpërblimi i dëmit material.....	39
1.3.	Realizimi i shpërblimit të dëmit material.....	41
1.4.	Kriteret për caktimin e lartësisë së shpërblimit me para të dëmit material.....	42
1.5.	Rastet e veçanta të shpërblimit të dëmit material.....	43
1.5.1.	Shpërblimi i dëmit material për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit.....	43
1.5.2.	Shpërblimi i dëmit material për shkak të shkaktimit të vdekjes.....	44
1.5.3.	Shpërblimi i dëmit material për shkak të cenimit të dinjitetit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta.....	45
1.5.4.	Shpërblimi i dëmit material të shkaktuar nga ana e më shumë subjekteve.....	46
1.6.	Shpërblimi i dëmit jomaterial.....	46
1.7.	Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial.....	48
1.8.	Kushtet e domosdoshme për ekzistencën e dëmit jomaterial.....	49
1.9.	Disa nga format e shpërblimit të dëmit jomaterial.....	50
1.9.1	Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të frikës.....	50
1.9.2.	Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të lëndimit trupor.....	51
1.9.3.	Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të vuajtjes psikike.....	51
1.9.4.	Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shëmtimit.....	52
1.9.5.	Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të vdekjes.....	53
1.10.	Paraqitja e padisë.....	54

1.11. Parashkrimi i padisë për shpërblimin e dëmit.....	55
1.12. Barra e provës.....	56
1.13. Angazhimi i ekspertit.....	56
1.14. Kriteret për caktimin e dëmit jomaterial.....	57
KAPITULLI III.....	60
1. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN KOSOVËS.....	60
1.1. Vështrim i përgjithshëm.....	60
1.2. Lartësia e kompensimit të dëmit jomaterial.....	61
1.3. Rregullimi ligjor i shkaktimit të dëmit nga automjetet në Kosovë.....	63
PJESA E DYTË.....	67
KAPITULLI IV.....	67
1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË DISA NGA VENDET E RAJONIT.....	67
1.1. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Republikën e Shqipërisë.....	67
1.2. Pretendimi i dëmit jomaterial në Republikën e Shqipërisë.....	69
1.3. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Republikën e Maqedonisë e Veriut.....	69
1.3.1. Kriteret për shpërblimin e dëmit jomaterial në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	70
1.4. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Republikën e Malit të Zi.....	72
1.5. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Republikën e Serbisë.....	73
1.5.1. Disa nga format e shpërblimit të dëmit jomaterial në Republikën e Serbisë.....	74
1.5.2. Disa raste të shpërblimit të dëmit jomaterial nga praktika gjyqësore në Serbi.....	77
1.6. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Federatën e Bosnjë e Hercegovinë dhe Republikën Serbe.....	78
1.7. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Kroaci.....	78
1.8. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Slloveni.....	79

KAPITULLI V.....	81
1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË DISA NGA VENDET E UNIONIT EUROPIAN.....	81
1.1. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Republikën Federale të Gjermanisë.....	81
1.2. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Francë.....	83
1.2.1. Dallimi ndërmjet dëmit material dhe jomaterial sipas legjislacionit francez.....	85
1.3. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Itali.....	86
1.4. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Austri.....	88
1.4.1. Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të lëndimit personal sipas ligjit austriak.....	89
1.5. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Zvicër.....	89
1.6. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Greqi.....	90
1.7. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Poloni.....	90
KAPITULLI VI.....	92
1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË VENDET E SISTEMIT ANGLOSAKSON.....	92
1.1. Shpërblimi i dëmit jomaterial në SHBA.....	92
1.2. Shpërblimi i dëmit jomaterial në Angli.....	94
PJESA E TRETË.....	100
KAPITULLI VII	100
1. TË METAT DHE PËRPARËSITË E SISTEMIT JURIDIK NË KOSOVË NË LIDHJE ME SHPËRBLIMIN E DËMIT JOMATERIAL NË ASPEKTIN LEGJISLATIV DHE PRAKTIK.....	97
1.1. Korniza ligjore lidhur me shpërblimin e dëmit jomaterial në Kosovë.....	97
1.1.1. Dhimbjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.....	114
1.1.2. Dhimbjet shpirtërore për shkak të shëmtimit.....	118
1.1.3. Dhimbjet shpirtërore në rast vdekjeje të personave të afërm.....	120
KAPITULLI VIII	122
1. RASTE NGA PRAKTIKA GJYQËSORE LIDHUR ME SHPËRBLIMIN E DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	122

1.2. Të dhënat statistikore lidhur me lëndët për shpërblimin e dëmit jomaterial në Gjykatat themelore të Republikës së Kosovës.....	132
KONKLuzionET	136
REKOMANDIMET	142
LITERATURA	144
I. Tekste universitare dhe publikime shkencore.....	144
II. Kode, Ligje dhe akte të tjera juridike.....	148
III. Vendime gjyqësore.....	150
IV. Burime nga Interneti.....	152

FALËNDERIM

Trasimi i rrugës së doktoratës sigurisht që nuk është i lehtë. Kërkon shumë punë dhe përkushtim, por mbi të gjitha duhet të kesh udhëheqës që do të udhëzojnë gjatë këtij rrugëtimi. Prandaj, mirënjohje dhe falënderime për të gjithë që më ndihmuan.

Në fillim falënderoj mentorin tim Prof. Dr. Adnan Jashari, i cili më përkrahu në vazhdimësi, po ashtu për ndihmën e tij maksimale, profesionale dhe akademike që ky punim të dalë në formën e tij më të mirë.

Falënderim dhe mirënjohje edhe për të gjithë profesorët e Universitetit të Evropës- Juglindore që më ndihmuan gjatë studimeve të mia të doktoraturës, për leksionet dhe për njohuritë që më dhanë.

Dhe, në fund për nga renditja, por jo për nga rëndësia, falënderoj familjen time që më përkrahën dhe më mbështetën gjatë këtij rrugëtimi sa të vështirë po aq edhe të bukur.

LISTA E SHKURTESAVE

LMD Ligji për marrëdhënie të detyrimeve i Kosovës

LPK Ligji për procedurën kontestimore i Kosovës

KCSH Kodi Civil i Shqipërisë

KCF Kodi Civil i Francës

KCI Kodi Civil i Italisë

KCA Kodi Civil i Austrisë

KCGJ Kodi Civil i Gjermanisë

Abstrakti

Disertacioni i doktoratës ka për objekt studimi shpërblimin e dëmit jomaterial në të drejtën komparative me fokus në Republikën e Kosovës. Detyrimi për shpërblimin e dëmit krijohet në çastin kur shkaktohet dëmi material ose jomaterial. Shpërblimi i dëmit synon që t'i mënjanojë pasojat e dëmshme të dëmit të shkaktuar. Shpërblimi i dëmit, si i tillë, nuk ka për qëllim pasurimin e të dëmtuarit, as që dëmtuesi pas shpërblimit të dëmit të bie në gjendje të vështirë materiale.

Shpërblimi i dëmit në të kaluarën ka pasur karakter ndëshkues, ndërsa në të drejtën bashkëkohore ajo ka një karakter preventiv, pra, karakter të kompensimit përkatës kurse shpërblimi i dëmit jomaterial është një satisfaksion. Detyrimi, që dëmi i shkaktuar duhet të shpërblehet, ndikon te pjesëmarrësit që në marrëdhëniet detyrimore të sillen në mënyrë të disiplinuar. Çështja e kompensimit të dëmit jomaterial është një nga çështjet më të diskutueshme dhe aktuale në teorinë dhe në praktikën gjyqësore, jo vetëm për faktin se brenda vetes përfshin çështjet e mbrojtjes së individit, të drejtat e tij në pacenueshmërinë si individ, mirëpo edhe për faktin se mungesa e kriterëve për vlerësimin e dëmit jomaterial, ka ndikuar në referimin në kriterë të ndryshme, duke krijuar kështu ndryshime në praktikën gjyqësore, sa i përket lartësisë së kompensimit të përcaktuar për raste të ngjashme. Mirëpo përtej kriterëve që lidhen me kompensimin e dëmit jomaterial, vetë dëmi jo material është një institut që në vete është i ri, dhe si të tillë fillimisht e gjejmë në jurisprudencën franceze, ndërsa më vonë, ky institut u zhvillua edhe nga teoria ligjore gjermane, duke njohur kështu një zgjerim gradual të nocionit të dëmit, e që ky zhvillim është drejtpërdrejt i ndikuar nga koncepti i të drejtave të personalitetit, përkatësisht të drejtave që lidhen me personalitetin, siç janë të drejtat për liri, jeta, emri, reputacioni etj., e që përfaqësojnë një kategori të veçantë të drejtash dhe që si të tilla janë objekt i mbrojtjes edhe i të drejtës private, përveç të drejtës penale e familjare, nisur nga mbrojtja kushtetuese që të njëjtat gëzojnë si të drejta të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme. Duke u nisur nga objekti i mbrojtjes, mund të themi se ndryshe nga dëmi material, dëmi

jomaterial është një koncept gjenerik, thuajse në përvijim e sipër, pra vështirë i definueshëm nisur edhe nga terminologjia e përdorur për t'iu referuar të njëjtit, ashtu që është përkufizuar si të gjitha dëmet të cilat në natyrën e tyre nuk janë materiale, e që më së shpeshti hasim të referuara si dëm extra-material, dëmet joekonomike, dëme morale apo dëme ideale, mirëpo që ka një tendencë në rritje për të përcaktuar objektivisht sfera e interesa jomateriale, të mbrojtura ligjërisht.

Duhet theksuar se dëmi material ekziston kur dëmtohen sendet e një subjekti, kur thyhet dera, vetura, kur cenohet dinjiteti dhe përhapja e fakteve të pavërteta që pasqyrohen nëpërmjet faktit se i dëmtuari nuk ka mundur të punojë, i ka humbur klientët e vet, ose nuk mund të punësohet; por, dëmi material mund të shkaktohet edhe me vepër penale dhe, shpërblimi i dëmit material mund të realizohet para Gjykatës Civile, para së cilës iniciohet procedura e veçantë dhe, në rast se dëmi material shkaktohet me vepër penale, këtë mund ta shqyrtojë Gjykata Penale, por nëse paraqitet ndonjë vështirësi, kjo gjykatë e drejton dëmtuesin deri te Gjykata Civile.

Teoria juridike civilei njih dy mënyra përmes të cilave mund të realizohet dëmshpërblimi material, edhe atë: dëmshpërblimi në natyrë dhe me para.

Dëmshpërblimi në natyrë bëhet me kthimin e gjendjes së mëparshme – *restitutio in integrum in natura*, në pasurinë e të dëmtuarit pra, me kthimin e sendit në atë gjendje në të cilën ka qenë para se të shkaktohet dëmi dhe, këtë mënyrë të shpërblimit të dëmit, Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Kosovës, e ka paraparë në nenin 169 para 1 gjë që gjen shprehje kur dëmtuesi që ka dëmtuar sendin e të dëmtuarit, e riparon atë send ose kur të dëmtuarit i jep tjetër send me vlerë dhe lloj të njëjtë (me ndreqjen e sendit të dëmtuar ose dhënien e ndonjë sendi tjetër të llojit të njëjtë në vend të sendit të asgjësuar) ndërkaq, kur kemi të bëjmë me dëmtimin e shëndetit, kthimi në gjendjen e mëparshme bëhet me përmirësimin e shëndetit të të dëmtuarit ose aftësimin e tij për punën që e ka kryer më parë por, në praktikë megjithatë ka raste kur shpërblimi në natyrë nuk mund të realizohet dhe, rasti i tillë është kur sendi i dëmtuar nuk mund të riparohet e as të zëvendësohet.

Dëmshpërblimi i dëmit me para, si mënyrë e shpërblimit të dëmit nënkupton atë se i dëmtuari në vend të sendit të asgjësuar merr një shumë të caktuar parash për ta blerë sendin e llojit të njëjtë dhe, kjo mënyrë e shpërblimit të dëmit gjen shprehje në rast se shpërblimi në natyrë nuk është i mundshëm, ose kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë subjekti përgjegjës, prandaj gjykata do të caktojë që ai të dëmtuarit t'ia paguajë shumën përkatëse të parave në emër të shpërblimit të dëmit dhe, ky është shpërblim i dëmit me të holla si barasvlerë e përgjithshme andaj, në praktikën gjyqësore më shumë zbatohet kjo mënyrë e dëmshpërblimit për shkak se është më e përshtatshme dhe në disa raste shërben si e vetmja mënyrë e dëmshpërblimit.

Shpërblimi për dëmin e shkaktuar material realizohet në kontestin e veçantë civil para gjykatës kompetente ndërkaq, në rast se dëmi është pasojë e veprës penale, Gjykata Penale mund ta shqyrtojë çështjen e dëmshpërblimit dhe, përveç në rastet kur vërtetimi i dëmit dhe caktimi i lartësisë së tij do ta zgjaste punën e Gjykatës Penale, kjo gjykatë mund të udhëzojë të dëmtuarin në kontestin civil me qëllim të realizimit të kërkesës për dëmshpërblim.

Duhet theksuar se ndër kriteret më të rëndësishme që i merr parasysh gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit material janë: lartësia e dëmit, shkalla e fajit, gjendja materiale e dëmtuesit dhe e të dëmtuarit.

Si raste të veçanta të shpërblimit të dëmit material, të cilat do të trajtohen në punim më gjerësisht, janë: shpërblimi i dëmit material për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit, shpërblimi i dëmit material për shkak të shkaktimit të vdekjes, shpërblimi i dëmit material të shkaktuar me cenimin e dinjitetit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta dhe shpërblimi i dëmit material kur dëmin e shkaktajnë shumë subjekte.

Po ashtu në punim do të analizohen edhe format e dëmit jomaterial, siç janë: shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të frikës, shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të lëndimit trupor, shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të

shkaktimit të vuajtjes psikike, shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shëmtimit dhe shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të vdekjes.

Fjalët kyçe: Dëmi, shkaktimi i dëmit, dëmi material, dëmi jomaterial, shpërblimi i dëmit jomaterial, kushtet për shpërblimin e dëmit jomaterial, format e dëmit jomaterial, Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve.

Abstract

The subject of the doctoral dissertation is the award of non-pecuniary damage in comparative law with a focus on the Republic of Kosovo. The obligation to compensate the damage is created at the moment when the material or non-material damage is caused. Compensation for damage aims to remove the harmful consequences of the damage caused. The award of damages, as such, does not aim to enrich the injured party, nor that the injured party after the award of damages falls into a difficult financial situation.

The award of damages in the past had a punitive character, while in contemporary law it has a preventive character, the character of relevant compensation, while the award of non-material damage is satisfaction. The obligation, that the damage caused must be compensated, influences the participants to behave in a disciplined manner in the relations of obligations. The issue of compensation for non-material damage is one of the most controversial and current issues in theory and judicial practice, not only because it includes issues of protecting the individual, his rights to inviolability as an individual, but also because of the fact that the lack of criteria for the assessment of non-material damage has influenced the reference to different criteria, thus creating changes in judicial practice, as regards the amount of compensation determined for similar cases. But beyond the criteria related to the compensation of non-material damage, the non-material damage itself is a new institute, and as such we first find it in French jurisprudence, while later, this institute

was also developed by German legal theory, thus recognizing a gradual expansion of the notion of damage, and that this development is directly influenced by the concept of personality rights, namely rights related to personality, such as the rights to freedom, life, name, reputation, etc., and which represent a special category of rights and which as such are the object of protection of private law, in addition to criminal and family law, starting from the constitutional protection that they enjoy as indivisible, inalienable and inviolable rights . Starting from the object of protection, we can say that unlike material damage, non-material damage is a generic concept, almost in outline, that is, difficult to define even from the terminology used to refer to it, so that is defined as all damages which in their nature are not material, and which are most often referred to as extra-material damages, non-economic damages, moral damages or ideal damages, but there is a growing tendency to determine objectively the sphere of intangible, legally protected interests.

It should be noted that material damage exists when a subject's belongings are damaged, when a door or car is broken; when the dignity is violated and the spread of untrue facts that are reflected through the fact that the injured party has not been able to work, has lost his clients, or cannot be employed. Material damage can be caused by a criminal offense. The compensation of material damage can be realized before the Civil Court, before which a special procedure is initiated. In case the material damage is caused by a criminal offense, this can be examined by the Criminal Court, but if any difficulties arise, this court directs the injured party to the Civil Court.

The civil legal literature recognizes two ways through which material compensation can be realized: compensation in kind and in money.

Compensation in kind is done with the return of the previous state - *restitutio in integrum in natura*, to the property of the injured party. Compensation for damage in kind is done by returning the item to the condition it was in before the damage was caused. This method of compensation for damage, the Law on the relations of obligations of Kosovo, has foreseen in article 169 par. 1. This way of compensating the damage is expressed when the injured party who has damaged the property of the

victim, repairs that property or when he gives the victim another item of the same value and type (by repairing the damaged item or giving any item another of the same kind instead of the destroyed item). When we are dealing with health damage, the return to the previous state is done by improving the injured person's health or making him capable of the work he did before. In practice, there are cases when the reward in kind cannot be realized. Such a case is when the damaged item cannot be repaired or replaced.

Compensation for damage in money, as a way of compensation for damage, means that the injured party receives a certain amount of money instead of the destroyed item to buy the item of the same type. This way of compensating the damage is expressed in the event that compensation in kind is not possible, or when the court considers that it is not necessary for the responsible entity to do so, therefore the court will determine that he pays the corresponding amount to the injured party of money in the name of compensation for damage. The award of damages in money is the award of damages in money as a general equivalent. In judicial practice, this method of compensation is mostly applied because it is more suitable and in some cases serves as the only way of compensation.

The compensation for the material damage caused is realized in the separate civil dispute before the competent court. In case the damage is a consequence of a criminal offense, the Criminal Court can examine the issue of compensation. Except in cases where proving the damage and determining its amount would prolong the work of the Criminal Court, this court can instruct the injured party in the civil dispute in order to realize the request for compensation.

It should be noted that among the most important criteria that the court takes into account when determining the amount of compensation for material damage are: the amount of the damage, the degree of fault, the material condition of the damager and the injured party.

As special cases of compensation for material damage, which will be dealt with in the paper in more detail, are: compensation for material damage due to bodily injury

and damage to health, compensation for material damage due to causing death, compensation for damage material caused by the violation of dignity and the spread of false facts and the compensation of material damage when the damage is caused by many subjects.

The doctoral dissertation also deals with forms of non-material damage, such as: compensation for non-material damage due to causing fear, compensation for non-material damage due to bodily injury, compensation for non-material damage due to causing mental suffering, compensation for damage immaterial due to disfigurement, award of immaterial damage due to causing death.

Key words: Damage, causing damage, material damage, non-material damage, compensation for non-material damage, conditions for compensation for non-material damage, forms of non-material damage, Law on Obligations.

HYRJE

1. Lënda dhe natyra e problemit

Lënda dhe problemi kryesor i trajtimit në këtë hulumtim do të jetë shpërblimi i dëmit jomaterial në aspektin komparativ (vendet e rajonit, vendet e sistemit kontinental dhe anglosakson), me fokus të veçantë në Republikën e Kosovës. Shpërblimi i dëmit jomaterial është mënyrë e zhdëmtimit të subjektit të dëmtuar, për shkak të cenimit të të mirave personale ku cenimi i të mirave personale ekziston kur cenohet e drejta në jetë, integritet trupor, shëndeti, nderi, kur përhapen fakte të pavërteta për të dëmtuarin dhe, cenimet e këtyre të mirave shkaktojnë humbjen e nderit, autoritetit, dhembje fizike, vuajtje psikike, frikë dhe zvogëlimin e gjasave për martesë.

Për të realizuar shpërblimin e dëmit jomaterial, duhet të plotësohen disa kushte si në vijim: dëmi i shkaktuar t'i cenojë vlerat personale të njeriut, të ekzistojë faji i dëmtuesit, të ekzistojë intensiteti dhe kohëzgjatja e përjetimit të dhembjeve dhe gjendja materiale e dëmtuesit.

Dëmi jomaterial mund të jetë si pasojë e veprës penale, e veprimit deliktor dhe si pasojë e cenimit të kontratës ku Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Kosovës, në nenin 183 para2, ka paraparë se, me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, që me tëtë mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

Individit që ka pësuar dëm jomaterial i gjykohet shpërblimi me para dhe me këtë ndërmjetësim ndikohet në zbutjen e tronditjeve subjektive të shkaktuara në personalitetin e viktimës dhe shpërblimi i dëmit jomaterial në para të dëmtuarit i gjykohet jo se paratë paraqesin çmimin për dhembjen e përjetuar ose pse paraqiten si substitucion i vlerës materiale në vend të dëmit të pësuar, por kjo gjë ka për qëllim që të dëmtuarit t'i mundësohet rivendosja e ekuilibrit psikik-emocional që ka ekzistuar para veprimit të dëmtuesit dhe, funksioni i tillë i shpërblimit të dëmit jomaterial quhet satisfaksion dhe ka një karakter subjektiv.

Vlen të theksohet se në këtë punim në aspektin komparativ trajtohen edhe rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial, siç janë: cenimi i autoritetit, nderit, lirisë, frika, dhembja fizike, vuajtja psikike, shëmtimi, vdekja e të afërmit, zvogëlimi i aktivitetit jetësor; po ashtu në këtë punim do të trajtohet edhe shpërblimi i dëmit jomaterial në vendet e rajonit, siç janë: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe, gjithashtu trajtohet shpërblimi i dëmit jomaterial në vendet e sistemit kontinental, siç janë: Gjermania, Franca, Italia dhe Austria dhe, shtjellohet edhe shpërblimi i dëmit jomaterial në vendet e sistemit anglosakson, siç janë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Anglia prandaj, në këtë hulumtim shtjellohen të metat dhe përparësitë e sistemit juridik në Kosovë në lidhje me shpërblimin e dëmit jomaterial - aspekti legjislativ dhe praktik.

2. Rëndësia dhe arsyeshmëria e temës

Sa i përket arsyeshmërisë së temës, tema si objekt hulumtimi do të ketë shpërblimin e dëmit jomaterial në përgjithësi në Republikën e Kosovës, përfshirë aspektin komparativ (vendet e rajonit, vendet e BE-së, vendet e tipit anglosakson). Ky hulumtim ka për qëllim që t'i plotësojë njohuritë shkencore nga lëmia së drejtës së detyrimeve, lidhur me shpërblimin e dëmit jomaterial. Hulumtimi do të japë përgjigje në pyetjen: Se si dhe në çfarë mënyre arrihet shpërblimi i dëmit jomaterial? Rezultatet

e hulumtimit mund të paraqesin bazë fillestare për hulumtimet e ardhshme më komplekse nga kjo fushë.

3. Zbatueshmëria në praktikë, lidhshmëria me komunitetin

Sa i përket zbatueshmërisë dhe efekteve të këtij punimi në praktikë, me anë të këtij punimi do të mund t'i vëmë në pah dallimet, ngjashmëritë dhe përputhjet të cilat i ka legjislacioni ynë i brendshëm në Kosovë, në sistem të krahasimit me juridiksionet e disa shteteve të tjera, apo edhe përputhshmërinë që ekziston edhe në mes akteve ndërkombëtare dhe akteve tona të brendshme në kontekst të shpërblimit të dëmit jomaterial.

Sa i përket lidhshmërisë me komunitetin, kjo tezë e doktoraturës kontribuon në zgjidhjen e problemeve me rastin e krijimit të detyrimit lidhur me shpërblimin e dëmit jomaterial.

Gjithashtu, shpresoj se ky punim do të shërbejë si literaturë edhe për gjeneratat e tjera, studentët, gjyqtarët, avokatët, punonjësit e tjerë në sistemin e drejtësisë.

4. Hipotezat

- Ky punim ka për objekt studimi shpërblimin e dëmit jomaterial, sa i përket formave të tij të paraqitjes, pastaj, procedura e kompensimit të dëmit jomaterial dhe kriteret në bazë të të cilave vlerësohet natyra dhe shkalla e dëmit të shkaktuar për efekt të kompensimit të tij;
- Zhvillimi historik i shpërblimit të dëmit jomaterial nga e drejta e lashtë romake e deri në të drejtën e sotme bashkëkohore;

- Analizimi i kësaj teme duke mos mbetur vetëm në rrafshin teorik, mirëpo duke iu referuar edhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore, me qëllim që jo vetëm të identifikimit të problematikave aktuale, mirëpo edhe mundësisë që me ndryshimet ligjore, këto vështirësi të identifikuara të trajtohen dhe lehtësohen për zbatim në praktikë;
- Rregullativa ligjore për shpërblimin e dëmit jomaterial në Republikën e Kosovës, shtetet e rajonit, në shtetet e të drejtës kontinentale dhe në sistemin anglosakson;
- Disertacioni trajton dallimet esenciale në mes të legjislacionit nacional, vendeve të rajonit dhe shteteve të BE-së si dhe vendeve anglosaksone;
- Realizimi i së drejtës për shpërblimin e dëmit jomaterial në Republikës e Kosovë, pranë gjykatës kompetente;
- Qëllimi dhe rëndësia e realizimit të së drejtës për shpërblimin e dëmit jomaterial në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, vendet e rajonit, vendet e BE-së dhe sistemit anglosakson;
- Identifikimin e të metave të sistemit aktual, dhe përcaktimin e masave adekuatë me qëllim të evitimit të këtyre të metave;
- Përcaktimin e mekanizmave konkretë juridikë për krijimin e një sistemi efikas gjatë përcaktimit të dëmshpërblimit, në veçanti në lidhje me vlerësimin dhe krijimin e një institucioni profesional për vlerësim, në raste kur kemi qëndrime të ndryshme të vlerësuesve të autorizuar;
- Në aspektin procedural do të trajtoj aspektin komparativ, duke identifikuar anët pozitive dhe negative, mbi bazën e të cilave do të sjell rekomandime.

5.1. Nënhipoteza e parë e veçantë

- Shpërblimi i dëmit jomaterial (moral) në Republikën e Kosovës.

5.2. Nënhipoteza e dytë e veçantë

- Nga harmonizimi i dispozitave të cilat e rregullojnë shpërblimin e dëmit jomaterial, varet edhe realizimi i kësaj të drejte në praktikë.

5.3. Nënhipoteza e tretë e veçantë

- LMD, si garantues i shpërblimit të dëmit jomaterial.

5.4. Nënhipoteza e katërt e veçantë

- Praktika bashkëkohore rajonale dhe ndërkombëtare e shpërblimit të dëmit jomaterial.

5.5. Pyetjet kërkimore bazë për këtë punim

Ky punim synon të japë përgjigje të plota dhe të sakta, në mënyrë profesionale, ligjore dhe praktike për pyetjet e mëposhtme:

- a) Çfarë është shkaktimi i dëmit si burim i detyrimeve?
- b) Cilat janë karakteristikat e shkaktimit të dëmit?
- c) Çka nënkupton shpërblimi i dëmit jomaterial?
- d) Cilat janë mënyrat (format) e shpërblimit të dëmit jomaterial?
- e) Si realizohet shpërblimi i dëmit jomaterial në Republikën e Kosovës?
- f) Cilat janë të metat dhe përparësitë e sistemit juridik në Kosovë në lidhje me

shpërblimin e dëmit jomaterial - aspekti legjislativ dhe praktik?

- g) Si realizohet shpërblimi i dëmit jomaterial në vendet e rajonit, siç janë: Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Shqipërisë, Serbia, Mali i Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë?
- h) Si realizohet shpërblimi i dëmit jomaterial në vendet e Unionit Evropian, siç janë: Gjermania, Franca, Italia, Austria ?
- i) Si realizohet shpërblimi i dëmit jomaterial në vendet e tipit anglosakson, siç janë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Anglia?

6. Metodatat e hulumtimit

Trajtimi i kësaj çështjeje me një qasje serioze dhe të gjithanshme, patjetër që imponon aplikimin e një metodologjie për punë dhe përfundim të suksesshëm të punimit.

Gjatë punimit të doktoraturës do të përdor metodat që si të tilla janë të njohura në shkencën e drejtësisë, metoda të kësaj natyre janë: Metoda juridike – historike, metoda e analizës dhe sintezës, metoda juridike-komparative, metoda statistikore, metoda e hulumtimit dhe trajtimit të rasteve individuale dhe metoda të tjera.

Me anë të metodës *juridiko-historike* do të trajtojmë historikun e shpërblimit të dëmit në përgjithësi, si dhe shpërblimin e dëmit jomaterial në veçanti. Si lindi e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit jomaterial në periudha të ndryshme kohore.

Metoda e analizës dhe sintezës do të përdoret gjerësisht si në analizën e legjislacionit tonë për shpërblimin e dëmit jomaterial, duke pasur si qëllim nxjerrjen në pah të problemeve që ekzistojnë, mangësitë në legjislacion si dhe kundërshtitë e dispozitave ligjore. *Metoda përshkruese* është një mjet i domosdoshëm për sqarimin e termave dhe koncepteve të ndryshme në aspektin ligjor dhe në atë praktik.

Me anë të metodës juridiko – komparative, do t'i konstatojmë dallimet dhe ngjashmëritë që ekzistojnë në mes sistemeve juridike të drejtësisë civile të cilat garantojnë të drejtën për shpërblimin e dëmit jomaterial. Me anë të kësaj metode do

të analizojmë legjislacionin që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit jomaterial në Kosovë, në raport me vendet e rajonit siç është Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Shqipërisë, Serbia, Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia, Bosnjë dhe Hercegovina, ku ekzistojnë pika të përbashkëta dhe dallime midis këtyre sistemeve juridike.

Me anë të metodës juridiko-statistikore, në përgjithësi mund të analizojmë disa nga rastet në të cilat janë bërë hulumtime se sa është respektuar e drejta për shpërblimin e dëmit jomaterial në Republikën e Kosovës dhe në vendet e rajonit në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut, Serbi, Mali i Zi, Kroaci, Slloveni dhe Bosnjë e Hercegovinë.

Metoda e hulumtimit dhe trajtimit të rasteve individuale do të na ndihmojë në trajtimin e praktikave të zhvilluara pranë gjykatave të rregullta por edhe të Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ, e të cilat raste kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit jomaterial. Do të trajtohen disa nga rastet gjyqësore të prezantuara me aktgjykime dhe vendime gjyqësore përkatëse.

Hulumtimi do të bëhet në Universitetin e Evropës Juglindore, në gjykatat me shtrirje territoriale në Kosovë, në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe në hapësira të tjera të rëndësishme për të përfunduar dhe hulumtuar në mënyrë cilësore temën e përcaktuar të doktoratës.

7. Struktura e disertacionit të doktoratës

Punimi ka një strukturë të përgjithshme e përbërë nga tri pjesë dhe tetë kapituj.

Pjesa e parë ka tre kapituj. Në tre kapitujt e kësaj pjese do të shtjellohen çështjet që kanë të bëjnë me shkaktimin e dëmit si burim i detyrimeve në përgjithësi në Kosovë, zhvillimin historik të tij në aspektin komparativ. Gjithashtu në këtë pjesë do të trajtohen dallimet midis përgjegjësisë deliktore dhe përgjegjësisë penale, dallimet midis përgjegjësisë deliktore dhe përgjegjësisë kontraktore. Pastaj në këtë pjesë do të vazhdohet me trajtimin e shpërblimit të dëmit – kuptimi, qëllimi i shpërblimit të dëmit,

dëmi material, kthimi në gjendjen e mëparshme (*restitutio in integrum*), shpërblimi në të holla, shpërblimi në të holla i dëmit në formë të rentës, caktimi i lartësisë së shpërblimit të dëmit në të holla, rastet e veçanta tëshpërblimit të dëmit material. Po ashtu në këtë pjesë do të trajtohet shpërblimi i dëmit jomaterial në Republikën e Kosovës në përgjithësi, si realizohet shpërblimi i dëmit jomaterial në kontestin e veçantë civil para gjykatës kompetente. Pastaj do të shqyrtohen format e veçanta të shpërblimit të dëmit jomaterial, siç janë: shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të cenimit të së drejtës së personalitetit të njeriut, shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të cenimit të identitetit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta, shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të cenimit të nderit dhe autoritetit. Në kapitujt e tjerë do të vazhdohet me trajtimin e formave të tjera të shpërblimit të dëmit jomaterial, ashtu siç përshkruhet në kapitujt e mëposhtëm.

*Pjesa e dytë*ka tre kapituj. Në këta kapituj të kësaj pjese do të trajtohet shpërblimi i dëmit jomaterial në aspektin komparativ në vendet e rajonit si Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë. Po ashtu në këtë pjesë trajtohet shpërblimi i dëmit jomaterial në vendet e Unionit Evropian, si Gjermani, Francë, Itali dhe Austri. Gjithashtu në këtë pjesë do të analizohet shpërblimi i dëmit jomaterial në vendet e tipit anglosakson siç janë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia.

Pjesa e tretë ka dy kapituj. Në këta dy kapituj do të shtjellohen të metat dhe përparësitë e sistemit juridik në Kosovë në lidhje me shpërblimin e dëmit jomaterial në aspektin legjislativ dhe praktik.

PJESA E PARË

KAPITULLI I

1. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME MBI SHKAKTIMIN E DËMIT SI BURIM I DETYRIMEVE

1.1. ZHVILLIMI HISTORIK I SHKAKTIMIT TË DËMIT

Si burim i krijimit të marrëdhënieve të detyrimeve për subjektin përgjegjës, shkaktimi i dëmit, krijon përgjegjësi për shpërblimin e tij meqë ai lind përgjegjësinë civile-juridike, që krijon obligim të shpërblimit të dëmit ku, përgjegjësia juridike-civile ka si mision mbrojtjen e subjektit dhe pasurisë së tij nga pasojat e veprimeve të dëmshme dhe kundërligjore të personave që janë përgjegjës (Hetemi, M., 2002, 261).

Normat mbi shpërblimin e dëmit kanë ekzistuar që në kohërat e hershme (Bardhi, A., 2016, 15). Sipas Olldashit, “e drejta e lashtë romake nuk kishte ndonjë dallim ndërmjet veprave penale dhe atyre civile – delikteve, ku e drejta romake e ka njohur termin delikt që tregonte çdo veprim kundërligjor të palës që sanksionohej me ligj dhe vetëm sipas sanksionit që i përkiste palës bëhej ndarja në delikte publike dhe delikte private andaj, romakët shprehjen delikt e përdornin edhe si negacion të shprehjes licere, që do të thotë diçka e lejuar andaj, deliktet, si burim i lindjes së marrëdhënies

detyrimore, për shkak të veprimeve të njëanshme të njerëzve, ndaheshin në publike dhe private” (Olldashi, E., 2013, 34). Gjithashtu aty theksohet fakti se: “të gjitha ligjet romake për kompensim të përbashkët të dëmit janë marrë nga ligjet antike greke ku, vetëm deliktet private paraqesin burim të detyrimeve, pasi për deliktet publike apo veprat penale (crimina), sanksioni (poena) jepej qoftë nga personi i dëmtuar, anëtarët e familjes ose shteti” (Olldashi, E., 2013, 34).

Në këtë drejtim, Mamuti, thekson se: “edhe ligjet e vjetra greke e trajtonin shkaktimin e dëmit dhe kompensimin e tij, veçanërisht çështjen e kompensimit të përbashkët ku me anë të ligjit Lex Rhodia e iactus, janë caktuar rregullat si dhe në çfarë mënyre paguhet dëmi, p.sh., te anija që është me interes të përbashkët të të gjithë pjesëmarrësve të transportit me anije, në rast të nevojës apo rrezikut për jetë, kanë qenë të detyruar të flijojnë mallin, kurse kompensimi i dëmit do të ndahej ndërmjet pjesëmarrësve që udhëtonin me anije” (Mamuti, A., 2013, 18-19).

E drejta e detyrimeve si degë e së drejtës civile, e ka bërë ndarjen nga të ashtuquajturat Ligjet e talionit, pasi që sot kur shkaktohet dëmi civil apo në rast të mospërbushjes së kontratës, personi që shkakton dëm kurrsesi nuk mund t’i nënshtrohet ndëshkimit fizik apo privimit të lirisë ku ajo se detyrimi për shpërblimin e dëmit nuk ka për qëllim hakmarrjen, shihet edhe nga konventat dhe paktet ndërkombëtare me çrast, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, në nenin 11, ka paraparë që: “askush nuk mund të burgoset për të vetmen arsye se nuk është në gjendje të shlyejë një detyrim që rrjedh nga kontrata” (PNDCP, 1976, neni 11). Në harmoni me aktet ndërkombëtare që ndalojnë shkaktimin e dëmit personit tjetër, LMD i Kosovës, në nenin 9, parasheh që: “secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t’i shkaktojë dëm tjetrit” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 9).

1.2. LLOJET E PËRGJEGJËSISË CIVILE – JURIDIKE

Në teorinë juridike, përgjegjësia juridike civile, sa i përket shkaktimit të dëmit, ndahet në: 1) përgjegjësinë deliktore (jashtëkontraktore) dhe 2) përgjegjësinë kontraktuese.

1) Përgjegjësia deliktore nënkupton veprimin antijuridik me anë të të cilit shkaktohet dëm dhe krijon obligim që ky dëm të kompensohet. Përgjegjësia deliktore civile ka të bëjë me cenimin e të drejtave absolute dhe interesit juridik ndaj të gjithëve.

2) Përgjegjësia kontraktore paraqet atë lloj përgjegjësie në rastin kur njëra palë kontraktuese nuk e përmbush obligimin të cilin e ka marrë përsipër me rastin e nënshkrimit të kontratës. Për shembull, nëse shitësi nuk i dorëzon sendin blerësit, e ky nuk e përmbush detyrimin e tij kontraktor, pastaj në rastin kur huamarrësi nuk e kthen borxhin e marrë, qiramarrësi e dëmton sendin të cilin e ka marrë me qira. Në të gjitha këto raste përgjigjen për dëmshpërblim për shkak të detyrimit të marrë që më parë në bazë të kontratës së lidhur (Hetemi, M., 2002, 262).

Përgjegjësia deliktore (jashtëkontraktore) dhe përgjegjësia kontraktuese, kanë të përbashkët, detyrën e dëmshpërblimit (Dauti, N., 2004, 148). Mirëpo në këto dy lloje të përgjegjësisë civile - juridike, kanë edhe dallime, e të cilat pasqyrohen si në vijim:

- Me rastin e përgjegjësisë deliktore- jashtëkontraktore, ku detyrimi i kompensimit krijohet dhe kërkesa arrin në momentin kur dëmi është shkaktuar. Ky është detyrim primar i dëmtuesit. Detyrimi për kompensimin e dëmit të përgjegjësia kontraktuese është i natyrës sekondare dhe krijohet atëherë kur nuk përmbushet ose përmbushet në mënyrë jo të plotë detyrimi;
- Kur kemi të bëjmë me përgjegjësinë deliktore -jashtëkontraktore përgjigjen edhe persona të cilët nuk posedojnë aftësi për të vepruar nën kushtet e caktuara, p.sh. personat e mitur mbi 14 vjet, nëse janë të aftë për të gjykuar. Ndërsa kontratat mund t'i lidhin sipas rregullës vetëm personat e aftë për të vepruar dhe vetëm ata përgjigjen për dëme;
- Te përgjegjësia deliktore- jashtëkontraktore nuk është i lejuar kufizimi me marrëveshje, kurse përjashtimi i përgjegjësisë konsiderohet se është në kundërshtim me rendin publik, në qoftë se që më parë për në të ardhmen

kufizojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit, i cili është kryer me ndonjë veprim kundërligjor të ndonjë personi. Në lëmin e përgjegjësisë kontraktuese është i lejuar kontraktimi i klauzolave mbi përjashtimin apo kufizimin e dëmit, por sipas rregullës vetëm për pakujdesi e jo edhe për veprim me paramendim ose pakujdesi të rëndë;

- Parashkrimi të përgjegjësisë deliktore-jashtëkontraktore arrin për tre vjet si afat subjektiv, e që llogaritet nga dita e marrjes në dijeni për dëmin dhe shkaktuesin e tij respektivisht për pesë vjet si afat objektiv, që nga momenti kur dëmi është shkaktuar. Parashkrimi të përgjegjësisë kontraktuese rrjedhë që nga momenti i arritjes së kërkesës për plotësim, e parashkrimi i të drejtës bëhet gjatë kohës për të cilën është paraparë për atë detyrim (d.m.th. një apo tre vjet).

Sipas Hetemit, përgjegjësia deliktore mund të jetë: përgjegjësi subjektive dhe përgjegjësi objektive; përgjegjësia subjektive është përgjegjësi sipas fajit, kurse përgjegjësia objektive është përgjegjësi pa faj (këtu nuk merret si kriter faji, por vetëm dëmi i shkaktuar), që veçanërisht shprehet te përgjegjësia për sendet e rrezikshme dhe ushtrimin e veprimtarive të rrezikshme, por, përveç këtyre dy llojeve të përgjegjësisë deliktore, ekziston edhe përgjegjësia e disa subjekteve të caktuara për përgjegjësinë e personit tjetër për dëmin që i është shkaktuar personave të tjerë ku, duhet theksuar se krahas përgjegjësisë civile - juridike, ekzistojnë edhe përgjegjësia penale - juridike dhe administrative-juridike ku, këto dy lloje të përgjegjësisë dallojnë nga përgjegjësia civile juridike për faktin se përderisa përgjegjësia civile-juridike përkujdeset për dëmshpërblimin, përgjegjësia penale-juridike dhe administrative-juridike kanë për qëllim ndëshkimin e shkaktuesit të dëmit apo kryesin e deliktit (Hetemi, M., 2002, 262-263).

1.3. SHKAQET E SHKAKTIMIT TË DËMIT JOMATERIAL

Ndër shkaqet më të shpeshta të shkaktimit të dëmit jomaterial janë: sjelljet e njerëzve, sendet e rrezikshme, fyerjet, shpifjet dhe cenimi i dinjitetit.

1.3.1.SHKAKTIMI I DËMIT JOMATERIAL ME SJELLJEN (VEPRIMIN E NJERËZVE)

Sipas Dautit, “me sjelljen e njerëzve në raste të caktuara mund të shkaktohet dëm, këta njerëz mund të jenë persona fizik dhe juridik dhe, dëmi mund të shkaktohet me veprim apo mosveprim, me veprim aktiv mund të shkaktohet dëmi, kur subjekti ndërmerr veprime të caktuara, ndërsa me veprim pasiv dëmi shkaktohet kur subjekti i caktuar nuk ndërmerr veprim të caktuar” (Dauti, N., 2004, 146).

LMD i Kosovës, lidhur me përgjegjësinë e të miturit në nenin 142, parasheh që, “i mituri deri në moshën shtatë vjeç nuk përgjigjet për dëmin të cilin e shkakton, i mituri prej moshës shtatë (7) vjeçare, deri në moshën katërmëdhjetë (14) vjeçare, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç në qoftë se provohet se gjatë shkaktimit të dëmit ka qenë i aftë për të gjykuar, i mituri pasi t'i ketë mbushur katërmëdhjetë (14) vjet përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë për dëmin, ndërkaq, lidhur me paaftësinë deliktore për subjektet që kanë mungesa mentale, LMD i Kosovës, në nenin 141 para1, ka paraparë që personi i cili për shkak të sëmundjes psikike, të zhvillimit të metë mendor apo të shkaqeve të tjera nuk është i aftë të gjykojë, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç nëse provohet që dëmin e ka shkaktuar në kohën kur ka qenë i aftë për të gjykuar”(LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 141-142).

Sipas Jasharit, “aftësi deliktore kanë edhe personat juridik, që nënkupton atë se ato përgjigjen për dëmin që ua shkaktojnë subjekteve të tjera, sepse ato në qarkullimin juridik veprojnë në emër dhe në llogari të personave juridik me ç'rast, personat juridik mund të jenë paditës dhe të paditur, para gjykatës, arbitrazhit dhe gjykatës, të fitojnë pasuri dhe të drejta të tjera reale, të lidhin kontratë dhe punë të tjera juridike” (Jashari, A., 2012, 61).

1.3.2 SHKAKTIMI I DËMIT JOMATERIAL NGA SENDET E RREZIKSHME OSE VEPRIMTARITË E RREZIKSHME

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose veprimtaritë e rrezikshme është përgjegjësi pa faj ose përgjegjësi objektive. Faji te kjo përgjegjësi mbetet anonim gjegjësisht fingohe për shkak të një interesi legjitim të së drejtës dhe marrëdhënieve që ajo rregullon. Ky lloj i shkaktimit të dëmit gjithnjë e më tepër e rrethon njeriun dhe pasurinë e tij me rrezik permanent për shkaktimin e dëmit që mund të jetë material dhe jomaterial. Kështu dëmi mund të shkaktohet dëmi nga helmet, eksplozimi i gazrave, energjia elektrike etj.

Me rastin e shkaktimit të dëmit, nga përgjegjësia objektive, viktimës shpesh i shkaktohet dëm jomaterial (moral) dhe, këtë çështje e rregullon LMD i Kosovës, nenet 182 deri 189. Dëmi jomaterial, të cilin e pëson viktimja, mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë. Shpërblimi i dëmit jomaterial mund t'i gjykohe edhe të afërmit të viktimës. Në shpërblimin e dëmit jomaterial ka të drejtë bashkëshorti, fëmijët, prindërit. Nën kushte të caktuara kanë të drejtë edhe vëllezërit dhe motrat, bashkëshorti ilegjitim ose jashtëmartesor, adaptuesit ose të adaptuarit. Shpërblimi i dëmit jomaterial është zakonisht në të holla. Ky shpërblim i drejtë në të holla i dëmit në shumicën e rasteve në këtë lëmë edhe realizohet. Ky shpërblim i drejtë në të holla i dëmit jomaterial është satisfaksion, sepse ky shpërblim i dëmit moral ka për qëllim zbutjen e çrregullimit psikik që ka pësuar viktimja.

1.4. SHKAKTIMI I DËMIT JOMATERIAL NGA NGJARJET NATYRORE

Dëmi jomaterial mund të shkaktohet nga ngjarja e fuqisë madhore, e cila sipas rrjedhës së rëndomtë dhe tradicionale duhet të jetë ngjarje e jashtme, ngjarje e paparaparë, ngjarje e jashtëzakonshme, ngjarje e paevitueshme dhe ngjarje e pashmangshme.

Ngjarja e fuqisë madhore është ngjarje e jashtme, ngjarje jashtë kontrollit të palëve. Kjo veçori e fuqisë madhore nënkupton se ngjarja në marrëdhënien deliktore është jashtë sendit të rrezikshëm ose jashtë veprimtarisë së rrezikshme, kurse në marrëdhënien kontraktore ngjarja e fuqisë madhore është jashtë lëndës së kontratës. Këto veti të fuqisë madhore sanksionohen në nenin 158 para 1, të LMD-së së Republikës së Kosovës, ku parashihet se “zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet” dhe neni 898 para 1, që parasheh se “udhëtari në çdo moment mund të heqë dorë nga kontrata, plotësisht ose pjesërisht”; neni 899 para 1, i cili parasheh që “organizatori i udhëtimit mund të heqë dorë nga kontrata, plotësisht ose pjesërisht, pa detyrimin e shpërblimit të dëmit, në qoftë se përpara ose gjatë kohës së zbatimit të kontratës lindin rrethana të jashtëzakonshme, që nuk kanë mundur të parashikohen dhe as të shmangen ose të mënjanohen, e që po të ekzistonin në kohën e lidhjes së kontratës, do të përbënin shkak të bazuar për organizatorin e udhëtimit që të mos e lidh kontratën” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 158 par. 1, neni 898 par.1 dhe neni 899 par.1).

Ngjarja duhet të jetë e paparaparë, është një prej kushteve për ekzistimin e fuqisë madhore –vis maior. Ngjarja e paparaparë është ngjarje që në kuadër të mundësive normale të njeriut nuk mund të parashihet se do të shkaktohet. Me njeriun me mundësi normale nënkuptohet njeriu që ka dije të caktuar dhe pajime të caktuara të cilat mund t’i ndihmojnë që eventualisht t’i parasheh ngjarjet e caktuara. Kjo ngjarje parimisht është dhe duhet të jetë jashtë mundësive normale të njeriut që të parasheh se do të shkaktohet.

Gjithashtu element tjetër i fuqisë madhore është se ajo duhet të jetë e jashtëzakonshme. Kjo ngjarje ka domethënie dhe veti të forcës jonormale, të forcës më të fortë nga forca e njeriut, gjegjësisht që nuk mund të përballohet nga njeriu. Kështu ndodh kur orteku godet me gjithë forcën e vet grupin e caktuar të njerëzve, kur dheu rrëshqet me gjithë forcën e vet në ndonjë vendbanim të caktuar, kur shkaktohen valët në det ose në oqean, në liqen, kur uragani, tajfuni me forcën e vet shkatërron çdo gjë

që ka përpara. Këto ngjarje janë zakonisht ngjarje që nuk janë rrjedhim i fajit të njeriut por janë jashtë këtyre rrjedhave. Element tjetër i fuqisë madhore, është se ngjarja e shkaktuar duhet të jetë e paevitueshme.

Ngjarja është e paevitueshme, atëherë kur njeriu me mundësitë normale që i posedon, nuk mund ta evitojë. Kur pronari konsideron se ngjarja ka qenë e paevitueshme, atëherë kjo rrethanë krijon mundësinë që ai të thirret në fuqinë madhore. Ky element i fuqisë madhore si i tillë është fakt relevant për lirimin nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar dhe, ky konstatim vlen si për përgjegjësinë deliktore ashtu edhe për përgjegjësinë kontraktore.

Element tjetër i fuqisë madhore është atëherë kur ngjarja duhet të jetë e pashmangshme. Ky element është i pavarur, sepse ekziston me veçoritë e veta ngase mjafton që të zbatohen rregullat e fuqisë madhore. Kështu ngjarja është e pashmangshme dhe njeriu nuk mund ta shmangë shkaktimin e saj. Pra, njeriu me mjetet që ka në disponim nuk mund të shmangë shkaktimin e ngjarjes së caktuar.

Duhet theksuar faktin se në rastin e shkaktimit të dëmit jomaterial nga fuqia madhore, shkaktuesi i dëmit lirohet nga përgjegjësia, ngase fuqia madhore është ngjarje jashtë sendit, ngjarje e jashtëzakonshme, ngjarje e paparaparë, ngjarje e paevitueshme dhe ngjarje e pashmangshme.

1.5. SHKAKTIMI I DËMIT JOMATERIAL NGA VEPRIMET E NJERËZVE – AKTET TERRORISTE, DEMONSTRATAT PUBLIKE DHE MANIFESTIMET PUBLIKE

Me veprimet e njerëzve mund të shkaktohet dëm material dhe jomaterial. Që të krijohet kjo përgjegjësi, duhet të plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative, si: duhet të shkaktohet dëmi material ose jomaterial, duhet dëmi të jetë i shkaktuar me akt terrorist ose nga demonstrata publike ose manifestimi publik, duhet të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit të ndërmarr dhe pasojave të shkaktuara dhe veprimi antijuridik. Këto kushte duhet në mënyrë komulative të plotësohen sepse pa plotësimin

e tyre nuk mund të bisedohet për krijimin e kësaj përgjegjësie të komplikuar dhe të përbërë.

1.6. SHKAKTIMI I DËMIT JOMATERIAL (MORAL) NGA FYERJET, SHPIFJET DHE CENIMI I DINJITETIT

Ky lloj i shkaktimit të dëmit jomaterial ekziston kur kemi të bëjmë me shpifje, fyerje dhe cenim të dinjitetit dhe, kjo çështje rregullohet me Ligjin civil kundër shpifjes dhe fyerjes i Kosovës, i cili me shpifje nënkupton: “publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e di ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër” (LCKSHF, Nr. 02/L-65, 2008). Ndërsa, me fyerje ky ligj nënkupton: “deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese” (LCKSHF, Nr. 02/L-65, 2008).

Sipas Sallabanda: “në vendet e Evropës Perëndimore, një vend të veçantë zë edhe mbrojtja e reputacionit të personit dhe e integritetit të tij moral, ashtu që cenimi i këtyre vlerave i jep të drejtë personit të dëmtuar të kërkojë shpërblimin e dëmit jomaterial” (Sallabanda, A., 1962, 285-286). Ndërkaq, Antiç thekson se: “në rastin e shpifjes, përdorimi i gjuhës fyese ndaj personit të dëmtuar i shkakton atij shqetësime dhe vuajtje, që varësisht nga intensiteti, përcaktojnë edhe lartësinë e kompensimit dhe, lidhur me shpërblimin e dëmit, kaqëndrime për dhe kundër kompensimit të tij ku, sipas një pikëpamje, është e pamundur që personi të kompensohet në natyrë, dhe se kompensimi me para do të hapte rrugë për spekulim me të mirat personale, por, megjithatë, teoria juridike pas shekullit të XIX-të, në praktikë pranoi qëndrimin se edhe dëmi moral mund shpërblehet në të holla, për shkak se paditësi nuk kërkon që me vullnetin e tij paraprak t’i humbasë të mirat personale për t’i shndërruar në para, por bëhet viktimë në kundërshtim me vullnetin të tij, dhe për shkak të vuajtjeve psikike të shkaktuara lind detyrimi për zhdëmtim” (Antiç, O., 2011, 521).

1.7. KUSHTET E PËRGJEGJËSISË PËR DËMIN E SHKAKTUAR

Sipas Dautit, “në mënyrë që të ekzistojë përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar, duhet të plotësohen këto kushte: a) shkaktimi i dëmit, b) dëmi të jetë i shkaktuar me veprimin e kundërligjshëm, c) faji i dëmtuesit, d) të ekzistojë aftësia deliktore, dhe, e) të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit; në rastin e përgjegjësisë objektive, faji nuk merret parasysh, kurse në përgjegjësinë për të tjerët, ka raste kur faji supozohet dhe ka karakter absolut ose kur faji nuk merret fare parasysh” (Dauti, N., 2004, 151).

1.7.1. SHKAKTIMI I DËMIT

Sipas Dautit, shkaktimi i dëmit paraqet një ndër kushtet e përgjithshme dhe më të rëndësishme të përgjegjësisë deliktore civile (Dauti, N; 2004, 151). LMD i Kosovës, në nenin 137, parasheh nocionin e dëmtisi: “zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengim i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jomaterial)” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 137). Formulim të ngjashëm të përkufizimit të dëmit, haset edhe në Ligjin për marrëdhënie të detyrimeve të RMV, ku sipas këtij ligji: “dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm real) dhe pengim i rritjes së saj (fitim i munguar), si dhe shkaktimi i ndonjë dhimbjeje fizike apo shpirtërore apo frikë (dëm jomaterial)” (LMDRMV, Nr.18, 2001, neni 142).

Sipas Sallabanda, nga këto përkufizime vërehen dy kuptime për dëmin: kuptimi ekonomik dhe kuptimi juridik (Sallabanda, A., 1962, 302). Ndërsa sipas Hetemit, me vetë faktin e shkaktimit të dëmit krijohet marrëdhënia detyimore e cila më parë nuk ekzistonte dhe, me shkaktimin e dëmit cenohet pasuria, e njëkohësisht dispozitat ligjore që parashohin detyrimin që askush askujt mos t’i shkaktojë dëm, se po u

shkaktua, ai duhet të kompensohet (Hetemi, M., 2002, 261).Ndërkaq, sipas Georgiev, humbja mund të qëndrojë, gjithashtu, edhe në mosrealizimin nga ana e të dëmtuarit të një interesi pasuror, të cilin do të mund ta realizonte sikur të mos ishte kryer veprimi i kundërligjshëm nga shkaktuesi i dëmit, dhe kjo paraqet fitimin e munguar (Georgiev, P., 1985, 42).

1.7.2. LLOJET E DËMIT

Ekzistojnë dy lloje të dëmit:dëmi material dhe dëmi jomaterial ku, me dëm material cenohet pasuria e të dëmtuarit, kurse dëmi jomaterial (moral) është ai dëm me të cilin cenohen të mirat dhe vlerat personale të të dëmtuarit (Dauti, N; 2004, 152).

1.7.2.1. DËMI MATERIAL (I PASURISË)

Sipas Dautit, “dëmi material është cenimi i vlerave materiale të ndonjë subjekti; Dëmi material në sende mund të manifestohet ose duke mos e bërë të mundshme ose duke e vështirësuar përdorimin dhe shfrytëzimin e sendit, duke shkaktuar në këtë mënyrë humbje në pasurinë e subjektit të dëmtuar, dëmi material ekziston edhe në rastin e cenimit të integritetit fizik të ndonjë njeriu, lëndimi trupor, dëmtimi i shëndetit që ka shkaktuar shpenzime për shërim, humbjen e të ardhurave personale të të dëmtuarit, ose edhe kur shkaktohet vdekja e një njeriu me fajin e dikujt”(Dauti, N., 2004, 152).

Sipas Dautit, dëmi material, shprehet në disa lloje, siç janë: a) dëmi i vërtetë (*damnum emergens*), b) fitimi i munguar (*lucrum cessans*), c) dëmi abstrakt, d) dëmi konkret, e) dëmi i drejtpërdrejtë dhe f) dëmi i tërthortë (Dauti, N., 2004, 152).

“Dëmi i vërtetë (damnum emergens) – LMD i Kosovës, në nenin 137 thekson se, dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt; b) Fitimi i munguar (lucrum cessans) –

pengim i rritjes së pasurisë, LMD i Kosovës, neni 137 përcakton që fitimi i munguar është kur pengohet rritja e pasurisë së të dëmtuarit; c) *Dëmi konkret* – vërtetohet dhe llogaritet sipas rregullave konkrete, të cilat ekzistojnë në rastin konkret të dëmit të shkaktuar, ky lloj dëmi material ekziston kur të dëmtuarit i kompensohen shpenzimet për riparimin e sendit të dëmtuar; d) *Dëmi abstrakt* – është lloj i dëmit material që caktohet në mënyrë abstrakte, duke mos marrë parasysh dëmin konkret, duke u caktuar në shumë paushalle ose me përqindje, ky lloj dëmi material më shumë gjen shprehje në kontratat e detyrimit dhe marrëdhëniet tregtare; e) *Dëmi i drejtpërdrejtë* – është dëm në të cilin është cenuar ndonjë vlerë juridike e të dëmtuarit, p.sh.: në dëmtimin e shëndetit dëmi i drejtpërdrejtëpërfshin: shpenzimet e mjekimit, shërbimet e ndryshme lidhur me shërimin, kurse nëse dëmi u është shkaktuar sendeve të të dëmtuarit si dëm i drejtpërdrejtë, konsiderohen shpenzimet lidhur me riparimin e sendit të dëmtuar; f) *Dëm i tërthortë* – ky lloj dëmi material është kur paraqitet fitimi i humbur nga shkatërrimi i sendit, ndërkaq, në dëmtimin e shëndetit ky lloj dëmi do të jetë me humbjen e të ardhurave personale që janë pasojë e dëmtimit të shëndetit”(Dauti, N., 2004, 153).

1.7.2.2. DËMI JOMATERIAL (MORAL)

Sipas Dautit, “dëmi jomaterial (moral), i cenon të mirat personale të të dëmtuarit siç janë: dinjiteti, autoriteti, prishja e qetësisë personale dhe familjare, cenimi i lirisë, shkaktimi i dhembjes fizike, psikike, frikës, cenimi i nderit, lirisë personale dhe lirisë së mendimit”(Dauti, N., 2004, 153). Dëmi jomaterial “shkaktohet pavarësisht nga dëmi material por më së shpeshti paraqitet bashkë me dëmin material, p.sh.: lëndimi trupor, dhembja fizike dhe shëmtimi” (Dauti, N., 2004, 153).

Ndërkaq, sipas Givord, “për dallim nga dëmi material që vjen si rezultat i dëmtimit të të mirave materiale, dëmi jomaterial rrjedh nga cenimi i të drejtave jomateriale, siç janë: cenimi i lirisë, privatësisë, nderit, shkaktimi i dhimbjeve fizike,

psikike apo të frikës, përkatësisht nga cenimi i të mirave personale të njeriut që i garanton rendi juridik” (Givord, F., 1938, 14).

KAPITULLI II

1. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME MBI SHPËRBLIMIN E DËMIT

1.1. KUPTIMI I SHPËRBLIMIT TË DËMIT

Sipas Dautit, “detyrimi për shpërblimin e dëmit krijohet në çastin kur shkaktohet dëmi material ose jomaterial gjë që nënkupton detyrën juridike të dëmtuesit që t’a zhdëmtojë materialisht dhe moralisht subjektin e dëmtuar dhe, ky detyrim i dëmtuesit krijohet në mbështetje të rregullave objektive që detyrojnë dëmtuesin për ta shpërblyer dëmin e shkaktuar ku qëllimi i shpërblimit të dëmit është që t’i mënjanojë pasojat e dëmshme të dëmit të shkaktuar dhe, parimisht ka për qëllim të krijojë gjendjen që ka ekzistuar tek i dëmtuari para shkakimit të dëmit ku shpërblimi i dëmit nuk nënkupton pasurimin e të dëmtuarit, as që dëmtuesi pas shpërblimit të dëmit të bie në gjendje të vështirë materiale andaj, fakti që dëmi i shkaktuar duhet të

shpërblehet ndikon te pjesëmarrësit që në marrëdhëniet e detyrimeve të sillen në mënyrë të disiplinuar” (Dauti, N., 2004, 189).

Shpërblimi i dëmit paraqet bazën e detyrimit nga shkaktimi i dëmit një personi të caktuar me çrast, në të drejtën penale dhe administrative për shkaktim të dëmit mund të ndëshkohet individi me privimin nga liria, ndërkaq, sipas Hetemit “qëllimi i përgjegjësisë juridike civile nuk është dënimi, por riparimi i dëmit të shkaktuar, çka do të thotë se si synim i të drejtës moderne është jo përgjegjësia, por mënjanimi i veprimeve dhe pasojave të dëmshme ku, riparimi i dëmit konsiston në çështjen që dëmtuesi duhet të bëjë riparimin e dëmit me anë të shpërblimit, që të krijojë atë gjendje e cila ekzistonte para kryerjes së veprimit të dëmshëm” (Hetemi, M., 2002, 281).

LMD i Kosovës nuk jep një përkufizim të hollësishëm të dëmit jomaterial, gjegjësisht vetëm ju referohet formave konkrete të këtij dëmi, ndërsa nevoja për kompensimin e tij mund të nxirret nga dispozitat e përgjithshme, siç është dispozita ligjore -neni 137 i këtij ligji, i cili parasheh se, “dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jomaterial)” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 137). Sipas Millosheviq, “dëmi jomaterial mund të krijohet edhe veçmas nga dëmi material, por që në shumicën e rasteve paraqitet së bashku me të njëjtin” (Millosheviq, L; 1972, 150); dhe si një kategori e gjerë dhe gjithëpërfshirëse, në kuadër të të njëjtit përfshihen: “çdo lloj dëmi tëpësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi tëdrejtpërdrejtë ekonomik në treg” (Vendimi nr. 12, 14.09.2007 i Kolegjit të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë). LMD i Kosovës parasheh disa lloje të dëmeve jomateriale që mund të kompensohen, “duke vendosur si kriter dallues jo vetëm formën, por edhe mënyrën e shpërblimit të tij, ashtu që për një lloj të dëmit jomaterial, siç është në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit, ka paraparë mundësinë e arritjes së qëllimit edhe në mungesë të shpërblimit, ndërsa që për forma të tjera të dëmit të cilat do trajtohen në vazhdim, shpërblimin me të holla e ka paraparë si formën

e vetme të shpërblimit, nisur edhe nga natyra e dëmit për të cilin kërkohet kompensim” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 182).

1.2. SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL

Dëmi material është cenim i vlerave materiale të ndonjërit prej subjekteve të së drejtës (person fizik ose person juridik) dhe, në rastet kur një send dëmtohet pjesërisht ose plotësisht, apo kur i shkaktohet lëndimi trupor deri edhe vdekja e dikujt, atëherë themi se është shkaktuar dëm material andaj, në praktikën juridike sipas Dautit, “njihen dy mënyra me të cilat mund të realizohet dëmshpërblimi, dhe atë: dëmshpërblimi në natyrë dhe dëmshpërblimi me para” (Dauti, N., 2004, 189-190).

- a) LMD i Kosovës, sa i përket dëmshpërblimit në natyrë, në nenin 169 para1, ka paraparë që “personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi dhe, kur kemi të bëjmë me dëmtimin e shëndetit, kthimi në gjendjen e mëparshme bëhet me përmirësimin e shëndetit të të dëmtuarit ose aftësimin e tij për punën që e ka kryer më parë ndërkaq, në praktikë ka raste kur shpërblimi në natyrë nuk mund të realizohet dhe, rasti i tillë është kur sendi i dëmtuar nuk mund të riparohet e as të zëvendësohet”(LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 169 para 1).
- b) LMD i Kosovës - dëmshpërblimin e dëmit me para e ka paraparë në nenin 169 para2, 3 dhe 4, “në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla; kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit; gjykata do t’i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e

kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 169 para 2, 3 dhe 4).

Sipas Dautit, “në praktikën gjyqësore më tepër zbatohet kjo mënyrë e dëmshpërblimit meqë është më e përshtatshme dhe në disa raste shërben si e vetmja mënyrë e dëmshpërblimit, shpërblimi për dëmin e shkaktuar material realizohet në kontestin e veçantë civil para gjykatës kompetente” (Dauti, N., 2004, 191).

1.3. REALIZIMI I SHPËRBLIMIT TË DËMIT MATERIAL

Sipas Hetemit, “gjykata kompetente në kontestin e veçantë civil vendos për shpërblimin e dëmit material, ku lartësia e shpërblimit përcaktohet në suaza të lartësisë së dëmit, sepse edhe qëllimi i shpërblimit është që të krijohet gjendja e mëparshme e cila ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit, kështu që shpërblimi i dëmit nuk duhet të jetë as më i lartë as më i ulët se që është dëmi dhe, nëse shpërblimi i dëmit e kalon lartësinë e dëmit, kjo do të ishte në kundërshtim me shpërblimin dhe do të thotë pasurim i të dëmtuarit për atë shumë e cila e kalon lartësinë e dëmit andaj, një pasurim i tillë nuk do të ishte i arsyeshëm, sepse shpërblimi i dëmit nuk ka për qëllim pasurimin e dëmtuesit por zhdëmtimin e tij, ndërkaq, në anën tjetër, nëse shpërblimi i dëmit do të ishte më i vogël se shuma e dëmit, atëherë dëmi nuk do të mund në masë të mjaftueshme dhe të duhur të mënjanohet dhe të përmirësojë gjendjen e shkaktuar nga

dëmi, por edhe dëmtuesi në këtë mënyrë krahas veprimit të tij të dëmshëm do të ishte i favorizuar gjë që është e papranueshme për të drejtën” (Hetemi, M., 2002, 282).

Sipas LPK, së Kosovës, kompetenca në kontestet për shpërblimin e dëmit është paraparë në nenin 47 para1, 2 dhe 3, “për gjykim në kontestet lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për dëmin, përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit me çrast, në qoftë se dëmi është shkaktuar për shkak të vdekjes apo të lëndimit të rëndë trupor, kompetente është, përpos gjykatës nga para1 i këtij neni, edhe gjykata në territorin e së cilës paditësi e ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e vet, dhe dispozitat ligjore të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni do të aplikohen edhe në kontestet sipas padive civile kundër shoqërive të sigurimit për shpërblimin e dëmit personave të tretë në bazë të dispozitave mbi përgjegjësinë direkte të tyre, kurse dispozita e para 1 të këtij neni edhe në kontestet lidhur me kërkesat e regresit në bazë të shpërblimit të dëmit kundër debitorëve të regresit” (LPK i Kosovës, Nr. 03/L-006, 2008, neni 47 para 1, 2 dhe 3).

1.4. KRITERET PËR ÇAKTIMIN E LARTËSISË SË SHPËRBLIMIT ME PARA TË DËMIT MATERIAL

Sipas Dautit, “kriteret më të rëndësishme që i merr parasysh gjykata me rastin e çaktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit material janë: lartësia e dëmit, shkalla e fajit, gjendja materiale e dëmtuesit dhe e të dëmtuarit”(Dauti, N., 2004, 192).

a) Sipas Dautit, “Vëllimi i dëmit – lartësia e dëmit caktohet duke pasur parasysh kriterin objektiv dhe subjektiv ku, sa i përket kriterit objektiv merret parasysh vlera objektive e sendit të dëmtuar, të asgjësuar, kurse për kriterin subjektiv vlerësimi i dëmit merret sipas vlerës së posaçme, individuale (vlerë e sendit të të dëmtuarit ndaj të cilit i dëmtuari ka pasur dashuri të veçantë, p.sh., ora e dhuruar për kujtim), shpërblimi i dëmit material për vlerën afeksionale të sendit të dëmtuar, i caktohet të

dëmtuarit në rast se dëmi është shkaktuar me vepër penale me paramendim; b) Shkalla e fajit - është rrethanë e dytë me rëndësi në shpërblimin e dëmit, me çrast, kur dëmi material shkaktohet me paramendim dhe nga pakujdesia e rëndë, shpërblimi i dëmit përfshin dëmin e vërtetë dhe fitimin e munguar; c) Gjendja materiale e dëmtuesit dhe e të dëmtuarit - është një kriter tjetër me rëndësi, i cili merret parasysh me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit me para të dëmit material, por, duhet theksuar se këtu gjykata duhet të ketë parasysh edhe gjendjen materiale të të dëmtuarit, sjellja e të dëmtuarit, lidhur me faktin se a është shkaktuar dëmi nga dashja apo nga pakujdesia e rëndë, si dhe fajin e të dëmtuarit, sa ka kontribuar ai në shkaktimin e dëmit, subjekti që ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, me çrastnuk meriton që t'i zvogëlohet shuma e shpërblimit të dëmit”(Dauti, N., 2004, 192-193).

1.5. RASTET E VEÇANTA TË SHPËRBLIMIT TË DËMIT MATERIAL

Po ashtu, sipas Dautit, “në literaturën juridike - civile janë të njohura edhe disa raste të veçanta të shpërblimit të dëmit material, siç janë: shpërblimi i dëmit material për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit, shpërblimi i dëmit material për shkak të shkaktimit të vdekjes, shpërblimi i dëmit material të shkaktuar me cenimin e dinjitetit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta dhe shpërblimi i dëmit material kur dëmin e shkaktojnë më shumë subjekte, andaj, këto raste do të trajtohen në vijim, secila veç e veç” (Dauti, N., 2004, 193-194).

1.5.1. SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL PËR SHKAK TË LËNDIMIT TRUPOR DHE DËMTIMIT TË SHËNDETIT

Sipas Dautit, “me lëndim trupor dhe dëmtim të shëndetit kuptohet “çrregullimi i integritetit trupor ose psikik të një subjekti që ka për pasojë dëmin material”.Ky shpërblimpërfshin shpenzimet e shërimit dhe të rehabilitimit për të dëmtuarin dhe, këto shpenzime përfshijnë: shpenzimet mjekësore, shpenzimet të transportit, shpenzimet të kujdesit, shpenzimet për mjete të ndryshme që i shërbejnë të dëmtuarit” (Dauti, N., 2004, 194).

LMD i Kosovës, në nenin 179 e rregullon këtë formë të shpërblimit të dëmit material, ashtu që ky nen përcakton që, “kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin, ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit; në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t’i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 179).

Në nenin e lartëcekur, para1, LMD i Kosovës, ka paraparë shpërblimin e dëmit material për lëndim trupor ose për dëmtimin e shëndetit, përfshirëkëtu edhe “fitimin e humbur për shkak të aftësisë së përkohshme punuese, ku ky nen, para2, parasheh këtë formë të shpërblimit, kur shkaktohet paaftësia e përhershme punuese e të dëmtuarit, i cili në këtë rast humb aftësinë punuese dhe fitimin e të ardhurave dhe, shpërblimi në këtë rast caktohet në formë të rentës jetësore, që jepet përpara, paraprakisht për çdo muaj ndërkaq, në raste të veçanta i dëmtuari ka mundësi të kërkojë që t’i paguhet renta në një shumë të përbashkët, p.sh.: kur i dëmtuari ka nevojë për para, për aftësimin e tij për ndonjë veprimtari punuese tjetër me çrast, neni 181 para1 i LMD-së së Kosovës, ka paraparë të drejtën për shpërblimin e dëmit material në formë të rentës në të holla për shkak të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit, si një e drejtë personale e lidhur ngushtë me personalitetin e të dëmtuarit, e cila nuk mund të bartet, e as të trashëgohet” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 179 para 2 dhe neni 181).

1.5.2. SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL PËR SHKAK TË SHKAKTIMIT TË VDEKJES

Sipas Radišić, “shkaktimi i vdekjes ndaj personit në rrethana të caktuara mund të jetë shkak i shpërblimit të dëmit material; pas vdekjes së personit të lënduar, të drejtë për shpërblimin e dëmit material kanë anëtarët e familjes së të vdekurit dhe, dëmshpërblimi në këtë rast përfshin shpenzimet e varrimit ku bëjnë pjesë: blerja e arkivolit, vendit të varrimit, shpenzimet për bartje deri në vendvarrim, shpenzimet për veshje të zezë të anëtarëve të afërm të familjes dhe shpenzimet e ushqimit” (Radišić, V., 1979, 259). Këtë formë të shpërblimit të dëmit material, LMD i Kosovës e ka paraparë në nenin 177 para1; ku përcaktohet që, “kush shkakton vdekjen e ndokujt, ka për detyrë që t’i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij, por, gjithashtu përveç shpenzimeve të zakonshme të varrimit, shkaktuesi i dëmit është i detyruar të paguajë edhe personat të cilët i ka mbajtur i vdekuri; kjo shumë paguhet në formë të rentës mujore, çdo muaj përpara dhe, kjo mënyrë e shpërblimit të dëmit është paraparë në nenin 178 para1 dhe 2, ku përcaktohet që, personi, të cilin e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi, të cilit i është shkaktuar vdekja, ka të drejtë të shpërblimit të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose e ndihmës; ky dëm shpërblehet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetej gjallë; Kohëzgjatja e kësaj pagese vazhdon aq sa presupozohet se do të jetonte i vdekuri, po të mos i shkatohej vdekja dhe, gjithashtu kjo e drejtë është personale dhe nuk mund të bartet te personat e tjerë” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 177-178).

1.5.3. SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL PËR SHKAK TË CENIMIT TË DINJITETIT DHE PËRHAPJES SË FAKTEVE TË PAVËRTETA

Sipas Dautit, “cenimi i dinjitetit të ndonjë subjekti ekziston kur për personalitetin e tij, përhapen fakte të pavërteta mbi të kaluarën, mbi aftësinë profesionale, diturinë, për aftësitë e personit të tretë për të cilat dëmtuesi është i vetëdijshëm se janë të pavërteta, me çrast personit të dëmtuar i shkaktohet dëm material dhe ka të drejtë në shpërblimin e dëmit ku, ky dëm material shprehet në humbjen e të ardhurave personale në rast të humbjes së punës ose nëse personi i dëmtuar është penguar në përparimin në vendin e punës, në humbjen e klientëve ose të pacientëve, nëse përhapen fakte të pavërteta mbi aftësinë profesionale të mjekut të caktuar ku, faktet e pavërteta mund të përhapen edhe ndaj ndërmarrjes ekonomike për të cilën gjë ajo humb në afarizëm dhe, ky rast i dëmit paraqitet në konkurrencën jolojale ku, cenimi i dinjitetit mund të bëhet me shkrim, gojarisht, me gjeeste, publikisht ose vetëm para të dëmtuarit” (Dauti, N., 2004, 195-196).

1.5.4. SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL TË SHKAKTUAR NGA ANA E MË SHUMË SUBJEKTEVE

Po ashtu sipas Dautit “ka raste në praktikën juridike civile, kur shumë subjekte marrin pjesë në shkaktimin e dëmit si shkaktues të drejtpërdrejtë të dëmit, ose si nxitës apo ndihmës të dëmtuesit” (Dauti, N., 2004, 194-196). Ndërsa sipas Gjata, “këta persona përgjigjen solidarisht për dëmin e shkaktuar, pra, përgjigjen solidarisht nëse dëmin e kanë shkaktuar së bashku, edhe atëherë kur dëmtuesit kanë punuar pavarësisht njëri nga tjetri, me kusht që nuk mund të përcaktohen pjesët e tyre në dëmin e shkaktuar” (Gjata, R., 2010, 278); “Po ashtu në mënyrë solidare përgjigjenedhe personat të cilët në mes vete janë të lidhur, me kusht që nuk mund të konstatohet se cili nga ata e shkaktoi dëmin, ndërsa për dëmin të cilin e përjetoi personi i tretë, e i cili është si pasojë e kryerjes së punëve në paluajtshmëri (p.sh. në ndërtesë), përgjigjen solidarisht investuesi dhe kryerësi i punëve” (Gjata, R., 2010, 278).

1.6. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL

Ndërkaq sipas Dautit, “shpërblimi i dëmit jomaterial është mënyrë e kompensimit të subjektit të dëmtuar, për shkak të cenimit të të mirave personale, kur cenohet e drejta në jetë, integriteti trupor, shëndeti, nderi, kur përhapen fakte të pavërteta për të dëmtuarin, cenimi i këtyre të mirave shkakton humbjen e nderit, autoritetit, dhembje fizike, vuajtje psikike dhe frikë”(Dauti, N., 2004, 196).

Numri më i madh i sistemeve juridike parashohin që shpërblimi i dëmit jomaterial që ka pësuar njeriu nga dëmi i shkaktuar, gjithmonë duhet gjykuar me para. Megjithatë, kur flasim për dëmin jomaterial, në përgjithësi një numër i konsiderueshëm i sistemeve juridike, kompensimin me para e parashohin si përjashtim, pasi sipas tyre ky lloj kompensimi na çon deri në komercializim të personalitetit të njeriut dhe manipulim me të mirat personale të njeriut, pamundësinë e kompensimit të drejtë. Në këtë mënyrë shpërblimi i dëmit jomaterial na paraqitet si satisfaksion për të dëmtuarin.

Lidhur me shpërblimin e dëmit jomaterial, LMD i Kosovës në nenin 182, ka paraparë që, “në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit, gjykata mund të urdhërojë shpalljen e aktgjykimit, përkatësisht të përmirësimit me shpenzim të dëmtuesit, ose të urdhërojë që dëmtuesi ta tërheqë deklaratën me të cilën është bërë shkelja, ose diç tjetër me të cilën gjë mund të realizohet qëllimi që arrihet me shpërblim” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 182).Pra, ky nen parashikon mënyrën e kompensimit të dëmit jomaterial, nëse shkelet e drejta e personalitetit, përmes shpërndarjes së fakteve të rreme ndaj një personi fizik ose juridik, pra, duke dëmtuar nderin dhe prestigjin e tyre, gjë që përveç dëmeve materiale, “shkakton edhe dëmin jomaterial, i cili mund të kompensohet siç rregullohet me këtë dispozitë. Kompensimi i këtij lloji dëmi jomaterial mund të bëhet në ca mënyra:

1. Nëpërmjet një urdhri gjyqësor, bëhet aktgjykimi i formës së prerë penale, duke mbajtur atë personi përgjegjës dhe fajtor si dhe dënimi për veprën penale, duke shkelur të drejtat e personalitetit;

2. Nëpërmjet publikimit të aktgjykimit civil, në pajtim me nenin 183 të LMD-së, ku është i detyruar të kompensojë dëmin jomaterial në formë monetare;

3. Nëpërmjet publikimit të korrigjimit publik, me të cilin pretendimet për cenimin e të drejtave të personalitetit mohohen dhe korrigjohen, të gjitha në kurriz të dëmtuesit;

4. Nëpërmjet një urdhri gjyqësor, dëmtuesi tërheq deklaratën, me të cilën u shkelën të drejtat e personalitetit, ose ndërmerret diç tjetër, kështu që varet mbi rrethanat e çështjes konkrete, falje publike ose përmes pendimit publik, pra që të jetë në gjendje ta lë mënjane shkeljen e së drejtës së personalitetit” (Dauti, A; Vol 13, No. 3/2017, 112-113).

1.7. SHPËRBLIMI NË TË HOLLA I DËMIT JOMATERIAL

Kompensimi për dëmin jomaterial është mënyra e kompensimit të palës së dëmtuar, kur cenohen të mirat personale. Sipas Dautit, kur kemi të bëjmë me shkelje të dinjitetit, prestigjit ose lirisë së ndonjë personi, kompensimi do të jetë kthimi i situatës së mëparshme (Dauti, A., Vol 13, No. 3/2017, 112-113), dhe kjo do të bëhet duke revokuar shkeljen e shkaktuar nga tërheqja e deklaratës ose nga deklarata e përmirësimit të deklaratës nga dëmtuesi. Kur lind mosmarrëveshje për shkak të shkeljes së dinjitetit ose prestigjit, gjykata mund të urdhërojë shqiptimin e gjykit në kurriz të kundërvajtësit. Qëllimi i kompensimit të drejtë monetar është të mundësojë që pala e dëmtuar të ketë një përvojë të këndshme, kënaqësi me të cilën ai mund të vinte ekuilibrin psikik (Dauti, A., Vol 13, No. 3/2017, 112-113).

Lidhur me atë se a i njihet e drejta e të dëmtuarit në shpërblimin e dëmit jomaterial (moral), në teorinë juridike civile, ekzistojnë dy mendime. Mendimi i parë kundër, cek disa argumente, siç janë: interesat jomateriale (dhembjet fizike dhe psikike) nuk mundën të shprehen dhe të maten me të holla, kështu që është e pamundur të përcaktohet lartësia e vetë dënimit dhe kompensimit adekuat. Gjithashtu, sipas këtij mendimi ndonjëherë është vështirë dhe shumë problematike të vërtetohet se dëmi ekziston, p.sh., se mos ka ardhur deri te dhembjet psikike, të cilat sipas rregullës varen nga ndjeshmëria (sensibiliteti) personal. Tutje ky mendim thekson se është jomorale të kërkojnë dhe të pranohen kompensime në të holla për cenimin e të mirave personale, siç janë: ndershmëria, liria, etj., të cilat nuk e kanë si pasojë dëmin pasuror dhe material. Sipas këtij mendimi në këtë rast kemi të bëjmë me tregtimin e të mirave morale, që është e papranueshme nga pikëpamja e normave shoqërore. Po ashtu, sipas këtij mendimi, në rast të cenimit të të mirave personale, ato janë të mbrojtura në mënyrë efikase me rregullat e të drejtës kushtetuese, penale dhe administrative.

Kurse përfaqësuesit e mendimit të dytë nuk pajtohen me argumentet e cekura, ata pohojnë se lartësia e shpërblimit të dëmit jomaterial, në të gjitha situatat nuk duhet të bëhet vetëm sipas kriterëve ekonomike, por edhe sipas drejtësisë. Madje ata pohojnë se nuk është e pamoralshme, por në harmoni me norma shoqërore të kërkojnë shpërblimi për dëmin e shkaktuar, me rastin e cenimit të të mirave jomateriale, me rëndësi për vlerat shoqërore, respektivisht kundër dëshirës së të dëmtuarit, në veçanti në situatë kur është “morale” të kompensohet edhe dëmi më i vogël pasuror ose vleror. Sipas këtij mendimi, në çdo rast të mirat personale në një shoqëri kanë dhe duhet të kenë vlerë më të madhe se sa të mirat materiale, andaj është e arsyeshme dhe e domosdoshme edhe mbrojtja me anë të sanksioneve civile–juridike.

Duhet theksuar faktin se në të drejtën bashkëkohore edhe në Kosovë, por edhe në sistemet krahasuese, gjithnjë e më shumë po aprovohet mendimi i dytë për domosdoshmërinë e shpërblimit të dëmit jomaterial (moral).

Neni 183 para1 i LMD-së së Kosovës parasheh që, “gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material dhe, po ashtu para2 i të njëjtit nen, e obligon gjykatën që, me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë se me të, të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 183 para 1).

1.8. KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR EKZISTENCËN E DËMIT JOMATERIAL

Në çdo rast, qoftë në kushtet e vërtetimit të dëmit material qoftë të dëmit jomaterial, është e domosdoshme ekzistimi i elementeve të përgjithshme, siç janë: veprimi i paligjshëm, dëmi i shkaktuar si rrjedhojë e tij, pastaj që ky veprim të jetë kryer me faj dhe të ekzistojë lidhje shkakësore në mes veprimit dhe dëmit të shkaktuar, “e që ekzistenca e këtyre kushteve të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, del nga dispozita ligjore ku përcaktohet se, kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë atë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 136).

Dëmi mund të jetë rrjedhojë e veprimit apo mosveprimit, e që cenimi i interesave apo të drejtave është pasojë e veprimit të dëmtuesit, gjegjësisht dëmi i shkaktuar personit tjetër, i cili duhet ta provojë lidhjen kauzale në mes tyre, pasi që ekzistenca e dëmit apo veprimit dëmtues në vetvete, nuk paraqet bazë për dëmshpërblim, pasi që mungesa e identifikimit të veprimit apo mosveprimit dëmtues, do të thotë që mungon personi nga i cili do të kërkohet dëmshpërblimi, kështu që mungesa e vërtetimit të pasojës konkrete e bën të pabazë kërkesën për dëmshpërblim.

1.9. DISA NGA FORMAT E SHPËRBLIMIT TË DËMIT JOMATERIAL

1.9.1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL PËR SHKAK TË SHKAKTIMIT TË FRIKËS

Sipas Dautit, “frika paraqet elementin subjektiv të palës së dëmtuar dhe është ndjenjë e shqetësimit të thellë, një përjetim psikik i brendshëm, i pakëndshëm i të dëmtuarit, shkaktuar me veprim deliktor të dëmtuesit, në fatkeqësi të trafikut, në lëndime që shkaktohen në vendin e punës ose që kanë të bëjnë me punën” (Dauti, N., 2004, 197). Po ashtu Dauti, tutje thekson se “frika si e tillë mund të jetë parësore, dytësore, e drejtpërdrejtë, e tërthortë, frika për jetë dhe frika gjatë shërimit, me çrast, në mënyrë që të realizohet kërkesa për shpërblimin e dëmit jomaterial për shkak të frikës duhet të plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte në vijim: a) subjekti i dëmtuar të ketë pësuar frikë; b) frika të jetë e intensitetit të lartë; c) frika të ketë kohëzgjatje të caktuar - frika t’i shkaktojë pasoja të dëmtuarit dhe d) i dëmtuari t’ia paraqesë kërkesën gjykatës kompetente për realizimin e shpërblimit të dëmit të tillë” (Dauti, N., 2004, 197).

Sipas Mamutit, “me rastin e caktimit të shkallës së intensitetit dhe kohëzgjatjes së frikës, eksperti gjyqësor duhet të marrë për bazë moshën e personit, gjendjen shëndetësore, gjininë e personit, vendin dhe kohën e shkaktimit të dëmit etj. Kjo për faktin, pasi që te fëmijët, te gjinia femërore apo te personat me gjendje më të dobët shëndetësore, frika mund të jetë e një intensiteti më të lartë, e cila si e tillë edhe mund të shkaktojë pasoja më të mëdha; të gjitha këto rrethana të paraqitura në raportin e ekspertit gjyqësor, i merr për bazë gjykatësi me rastin e vlerësimit të lirë, të formuar sipas bindjes së tij të brendshme me rastin e shpalljes së vendimit” (Mamuti, A., 2013, 168).

1.9.2. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL PËR SHKAK TË LËNDIMIT TRUPOR

Gjithashtu sipas Mamutit, “shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të lëndimit trupor, vjen në shprehje kur personit që dëmtohet i shkaktohen thyerje të ekstremiteteve, thyerje të brinjëve, dëmtim apo thyerje të boshtit të kurrizit, fraktura të kokës apo plagë të tjera në trup, ashtu që tek i dëmtuari paraqiten dhimbje fizike dhe vuajtje psikike (Mamuti, A., 2013, 165).

Gjithashtu, në mënyrë kumulative, edhe këtu duhet të plotësohen këto kushte në vijim: duhet të shkaktohet dëmtimi trupor, dëmtimi trupor të shkaktojë dhembje fizike ose vuajtje psikike, të ekzistojë lidhja kauzale midis lëndimit trupor dhe vuajtjeve të shkaktuara fizike si dhe psikike të të dëmtuarit dhe të ekzistojë subjekti përgjegjës. Përcaktimin për kompensimin e këtij dëmi e bën gjykata, duke u bazuar në vlerësimin e ekspertit gjyqësor, pasi këtu është shumë e rëndësishme që të konstatohet intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike dhe vuajtjeve psikike të personit (Mamuti, A., 2013, 165-166).

1.9.3. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL PËR SHKAK TË VUAJTJES PSIKIKE

Kjo është një ndër format për shpërblimin e dëmit jomaterial. Vuajtja psikike paraqitet si shqetësim i thellë, respektivisht përjetim i brendshëm i pakëndshëm që ndodh nën ndikimin e një rreziku të jashtëm, me ç’rast tek personi shkaktohen çrregullime emocionale dhe psikike (Dauti, N., 2004, 199).

LMD i Kosovës, në nenin 183 para1 dhe2, parasheh që, “për dhembjet e pësura fizike, për dhembjet e pësura shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material; me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i

shërben ky shpërblim, por edhe për atë, që me të, të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 183 para 1 dhe 2).

1.9.4. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL PËR SHKAK TË SHËMTIMIT

Sipas Dautit, shëmtimi, “paraqet prishjen e pamjes së jashtme, të formës së trupit të njeriut ose të ndonjë pjese të tij, përkatësisht, prishjen e pamjes së jashtme të ndonjë funksioni trupor”(Dauti, N., 2004, 200). Në praktikë rastet e shkaktimit të shëmtimit vijnë në shprehje gjatë dëmtimeve të shkaktuara, gjatë lëndimeve në komunikacion, me ç’rast personave të dëmtuar u shkaktohen deformime në fytyrë apo në kokë si rezultat i vragëve të krijuara, deformim me rastin e lëndimit apo këputjes së dorës apo këmbës apo dhe të pjesëve të tjera të trupit, ku pas momentit të deformimit, shkaktohet humbje e bukurisë për personin në fjalë dhe paraqitet çekuilibrim psikik, krijohet një ndjenjë e inferioritetit në raport me anëtarët e tjerë të shoqërisë dhe, gjithë kjo situatë, reflektohet me gjendje depresive, me çka shpeshherë, kemi dhe stagnim të të dëmtuarit në profesion apo dhe në jetën e përditshme, dhe “për realizimin e këtij shpërblimi të dëmit duhet të shkaktohet shëmtimi, deformimi trupor i subjektit të dëmtuar dhe shëmtimi të shkaktojë vuajtje shpirtërore me intensitet dhe kohëzgjatje të caktuar dhe, e drejta për shpërblimin e dëmit jomaterial nga shëmtimi është personale dhe nuk u kalon trashëgimtarëve të të dëmtuarit” (Dauti, N., 2004, 200).

1.9.5. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL PËR SHKAK TË SHKAKTIMIT TË VDEKJES

Sipas Mamutit, “kjo formë e shpërblimit të dëmit jomaterial, ndodh pasi vdekja paraqet një fakt relevant për të kërkuar realizimin e shpërblimit të dëmit jomaterial ku, shumica e legjislacioneve dhe praktikave gjyqësore, e njohin këtë lloj të dëmit jomaterial” (Mamuti, A., 2013, 166).

LMD i Kosovës, parasheh rrethin e anëtarëve të ngushtë të familjes që kanë të drejtë në realizimin e shpërblimit të dëmit jomaterial, në rastin e vdekjes ose invaliditetit të rëndë të anëtarit të familjes, kështu që neni 184 para 1-4, parashohin që, “në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t’u caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore; ky shpërblim mund t’u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme; ndërkaq, në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, gjykata mund t’u caktojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblim të drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore dhe, ky shpërblim nga para 1-3të këtij neni, mund t’i caktohet edhe bashkëshortit jashtëmartesor në qoftë se ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 184 para 1, 2, 3 dhe 4).

Duhet theksuar, se këtë formë të shpërblimit të dëmit jomaterial, e parasheh edhe Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, në nenin 643 ku përcaktohet që, “shpenzimet për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, të bashkëshortes dhe prindërve të paaftë për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit, plotësisht ose pjesërisht, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit; b) shpenzimet e duhura për varrimin e të vdekurit, në masën që ato i përgjigjen rrethanave personale e familjare të të vdekurit; personi që ka shkaktuar dëmin mund të kundrejtojë të njëjtat mjete mbrojtëse që do t’i kundrejtonte të vdekurit; gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, mund të vendosë që shpërblimi të jepet në natyrë, ose në para, njëherësh ose me këste” (KCSH, Ligji nr. 7850, 29.7.1994, neni 643).

Sipas Alishanit, “për t’u realizuar kjo e drejtë, duhet të plotësohen këto kushte në vijim: të jetë shkaktuar vdekja e të afërmit, vdekja të shkaktojë vuajtje tek të afërmit e tij, të ekzistojë lidhja kauzale midis vdekjes së shkaktuar dhe vuajtjes psikike të

shkaktuar, vdekja të jetë shkaktuar me veprim të kundërligjshëm si dhe duhet t'i paraqitet kërkesë gjykatës për shpërblim të dëmit jomaterial" (Alishani, A.,1989, 560).

1.10. PARAQITJA E PADISË

Në parim, të gjitha të drejtat dhe interesat mbrohen, ku padia për shpërblimin e dëmit jomaterial mund të ngrihet prej cilitdo që pretendon shkaktimin e këtij lloji dëmi, me çrast, me padi specifikohet dëmi që pretendon se i është shkaktuar me veprimet e të paditurit dhe shumën e kompensimit që kërkon nga i njëjti, si rrjedhojë e veprimit dëmtues, meqenëse ligjvënësi ka përcaktuar shpërblimin në të holla si formën e vetme të kompensimit dhe, "vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me cenimin e së drejtës së personalitetit, gjykata mund të urdhërojë shpalljen e aktgjykimit ose të urdhërojë që dëmtuesi ta tërheqë deklaratën me të cilën është bërë shkelja, ose diç tjetër me të cilën gjë mund të realizohet qëllimi që arrihet me shpërblim"(LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 182).Duke pasur parasysh edhe vetë natyrën e rasteve të kësaj kategorie, ligjvënësi ka paraparë kompetencën në kontestet për shpërblimin e dëmit, kështu që, Ligji për procedurën kontestimore i Kosovës, në nenin 47 para 1-3, parasheh që, "për gjykim në kontestet lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për dëmin, përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit; në qoftë se dëmi është shkaktuar për shkak të vdekjes apo të lëndimit të rëndë trupor, kompetente është, përpos gjykatës nga para1 i këtij neni, edhe gjykata në territorin e së cilës paditësi e ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e vet; dhe, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, do të zbatohen edhe në kontestet sipas padive civile kundër shoqërive të sigurimit për shpërblimin e dëmit personave të tretë në bazë të dispozitave mbi përgjegjësinë direkte të tyre, kurse dispozita e para 1 të këtij neni edhe në kontestet lidhur me kërkesat e regresit në bazë të shpërblimit të dëmit kundër debitorëve të regresit"(LPK i Kosovës, Nr. 03/L-006, 2008, neni 47 para 1, 2 dhe 3).Nga analiza ekëtyre dispozitave ligjore, rezulton që, në

rastet kur pala e dëmtuar pranon kompensimin e ofruar nga shoqëritë e sigurimit apo fondet e posaçme për shpërblim, e njëjta nuk ka të drejtë që përmes padisë të kërkojë kompensim shtesë për dëmin e shkaktuar, mirëpo ka situata përjashtuese që lidhen me padijen e palëve mbi pasojat e pranimi të shumave të tilla të kompensimit andaj, në këtë drejtim, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut-GJEDNJ, vëren se pamundësia e palëve që përmes mjetit juridik, në këtë rast të padisë, të kërkojnë kompensimin shtesë, përbën shkelje të nenit 6 para 1 të KEDNJ, duke arsyetuar se rrethanat në të cilat kanë vepruar viktimat, ishte e arsyeshme të besonin se ata kishin të drejtë të fillonin ose të vazhdonin me përdorimin e mjeteve juridike edhe pas pranimi të ofertës për kompensim, por që nuk ishin mjaftueshëm të sqaruar lidhur me pasojat e shkaktuara nga marrja e mjeteve në dispozicion (Cannarsa, M., 2014, 11-12).

1.11. PARASHKRIMI I PADISË PËR SHPËRBLIM TË DËMIT

Parashkrimi si një institut i së drejtës luan një rol të rëndësishëm në ngritjen e sigurisë juridike ndërmjet subjekteve të së drejtës dhe, kjo siguri juridike konsiston si në qëndrueshmërinë e rendit juridik, por edhe të asaj që subjektet e së drejtës të jenë të kujdesshëm që të drejtat e tyre t'i realizojnë me kohë.

Në këtë drejtim, LMD i Kosovës, e rregullon çështjen e parashkrimit-kërkesën për shpërblimin e dëmit, në nenin 357 para 1-4, ku përcaktohet që, “kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin; në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit; kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me cenimin e detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e atij detyrimi dhe, kërkesat e kompensimit të dëmit të krijuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur parashkruhen pesëmbëdhjetë (15) vite pasi personi i mitur të ketë arritur moshën e pjekurisë” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 357 para 1, 2, 3 dhe 4).

1.12. BARRA E PROVËS

Në procesin gjyqësor, paditësi sipas ligjit, padisë ia bashkëngjit të gjitha provat, përmes të cilave pretendon të vërtetojë pretendimet e tij, gjegjësisht në rastin konkret, dëmet e shkaktuara nga i padituri, qoftë në natyrën e tyre e po ashtu edhe në lartësinë e intensitetin që ato kanë. Në këtë drejtim pala paditëse, duhet që përmes provave të paraqitura apo atyre të propozuara, që administrohen, duhet të vërtetojë se dëmi vërtet ka ndodhur, si rrjedhojë e veprimit dëmtues të të paditurit. Në këtë drejtim është e rëndësishme të përmendim faktin kur dëmi shkaktohet me vepër penale, dhe kur ka një vendim meritator në procedurë penale, dhe shpërblimi i dëmit kërkohet në procedurë civile, atëherë ekzistenca e dëmit dhe shkaktuesi i saj, merret si i vërtetuar dhe se në procedurë civile, duhet vetëm të caktohet lartësia e dëmit, e që në këtë rast, paditësi, me rastin e paraqitjes së padisë, të njëjtës ia bashkëngjit edhe vendimin e plotfuqishëm të gjykatës përkatëse të marrë në procedurë penale. Mirëpo përveç kësaj, palës paditëse i bien barra e kontestimit (*onus contestatio*), pala paditëse deklarohet lidhur me pretendimet e palës kundërshtare, pasi që në një situatë tjetër, këto fakte mund të konsiderohen prej gjykatës të pakontestueshme (Hoxhaj, I., nr.26, 2018).

1.13. ANGAZHIMI I EKSPERTIT

Thuajse në të gjitha sistemet evropiane, janë raportet mjekësore që shërbejnë si bazë për vlerësimin e dëmit të shkaktuar (Harton, W.V. Rogers., Vol1/2009, 5). Ligji i procedurës kontestimore i Kosovës, ka paraparë se “sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale, të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes” (LPK i Kosovës, Nr. 03/L-006, 2008, neni 356). Roli i ekspertit në procese gjyqësore të kësaj natyre gjegjësisht në rastet kur procedura civile zhvillohet për paditë për kompensim, dëmi është shumë i rëndësishëm, meqenëse janë pikërisht ekspertët ata që përcaktojnë natyrën dhe shkallën e dëmit. Duhet cekur se

ekspertët e rindërtimit të aksidenteve, të cilët i përdorin parimet e inxhinierisë për të përshkruar si ka ndodhur aksidenti si dhe për të përcaktuar shkakun më të mundshëm të aksidentit; ata do të marrin në konsideratë faktorë të tillë si kushtet e rrugëve, peshën dhe madhësinë e automjeteve, dëmet e pandërprera dhe raportet e marra nga zbatimi i ligjit për të nxjerrë përfundimet e tyre; ekspertët mjekësorë të cilët konstatojnë shkakun dhe shtrirjen e lëndimeve, shkakun më të mundshëm të dhimbjes dhe gjendjes së tanishme, si dhe nevojën për kujdes mjekësor të ardhshëm; shumica e përfundimeve të tyre mund të bazohen në një rishikim të të dhënave tuaja mjekësore (Neni 356 i LPK), ekspertët financiarë konstatojnë humbjet financiare duke cilësuar gjëra të tilla si humbja e kapacitetit fitues, shpenzimet e ardhshme mjekësore dhe dëmtimet e përhershme; ekspertët e shëndetit mendor, të cilët konstatojnë dëmtimin - vuajtjet emocionale ose psikologjike për shkak të dëmit të shkaktuar, mënyrën se si kjo do të ndikojë në jetën tuaj. Mendimin e ekspertit ose ekspertëve, gjykata e vlerëson si çdo provë tjetër, kur nuk e bind mendimi i tyre, ajo duhet të arsyetojë mospranimin në vendimin përfundimtar, mirëpo po ashtu, mund të angazhojë ekspert tjetër.

1.14. KRITERET PËR ÇAKTIMIN E DËMIT JOMATERIAL

Sa është e qartë se asnjë çmim nuk mund të kompensojë një dhimbje, që asnjë sasi e parave nuk mund të rivendosë funksionin e humbur, po aq është e paqartë ekzistenca e kriterëve apo parimeve teorike konsistente, në vlerësimin e dëmeve të kësaj natyre. Ligjvënësi në Kosovë është mjaftuar duke e kushtëzuar çaktimin e shpërblimit nga rrethanat e rastit, veçanërisht intensiteti dhe kohëzgjatja e tyre e dhembjes së shkaktuar. Neni 183 para 2 i LMD-së së Kosovës, parasheh që, “me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, që me të, të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 183 para 2). Andaj, në këtë drejtim është e rëndësishme të

ceket se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, ka miratuar një Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga autopërgjegjësia, e cila ka paraparë disa kriterë në bazë të cilave edhe janë përcaktuar shuma të caktuara për shpërblim, ashtu që në rastin e kompensimit për dhembjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, si kriter ka marrë llojin e lëndimeve, pjesën e trupit që u është ekspozuar lëndimeve, mosha e të lënduarit dhe nga përqindja e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga autopërgjegjësia, dt.15.09.2016, neni 31); të kompensimit për dhimbje trupore, është marrë natyra e pasojave, nëse janë të përhershme apo të përkohshme, në rastin kur janë të përhershme, nëse zvogëlimi i aktivitetit jetësor është nën 30% apo mbi 30% (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga autopërgjegjësia, dt.15.09.2016, neni 32); në rastin e frikës është marrë intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga autopërgjegjësia, dt.15.09.2016, neni 33); lidhur me dhembje shpirtërore për shkak të shëmtimit, si kriter është marrë shkalla e shëmtimit e lartë, e mesme, e ulët, gjinia dhe mosha e të lënduarit (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga autopërgjegjësia, dt.15.09.2016, neni 34); ndërkaq, që në rastin e kompensimit për dhembje shpirtërore për shkak të vdekjes ose invaliditetit tepër të rëndë të personit të afërm (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga autopërgjegjësia, dt.15.09.2016, neni 33); si kriter i vlerësimit për vlerat e kompensimit është marrë afërsia me personin e vdekur apo të cilit i është shkaktuar individualiteti tepër i rëndë (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga autopërgjegjësia, dt.15.09.2016, neni 33). Edhe pse në pamje të parë duket se në kuadër të këtyre kriterëve arrihet të përmbledhet në tërësi një vlerësim i drejtë i dëmit të shkaktuar, në një shqyrtim më konkret, duket qartë se këto kriterë si të tilla, janë sipërfaqësore dhe nuk reflektojnë drejtë gjithë

pasojën e veprimit të dëmshëm; anipse një Rregullore e tillë me tabela përcjellëse nuk e obligon gjykatën me rastin e vendosjes në konteste të kësaj natyre, nga praktika gjyqësore hetohet një korrespondim në caktimin e shumave që janë relativisht ekuivalente me ato të ofruara nga kompanitë e sigurimeve dhe, përtej intensitetit dhe kohëzgjatjes, që janë objektivisht përafërsisht të kuantifikueshme, që nisur nga natyra e lëndimit mund të përcaktohet edhe kohëzgjatja dhe intensiteti i saj, janë rrethanat e posaçme që duhet të fitojnë një peshë thelbësore në përcaktimin e shpërblimit; duke qenë se vetë ngjarjet përjetohen në mënyrë të ndryshme e që janë pikërisht rrethanat e lartpërmendura, që janë përcaktuese në këtë drejtim, duke qenë se karakteristikat individuale të viktimës mund të rrisin ose të ulin shkallën e vuajtjes (Erdelevsky, A.M; 2004, 103). Nëse i referohemi dëmit estetik, duhet të ekzistojë pasoja konkrete në jetën e personit të dëmtuar, e që kjo varet nga mosha, profesioni, angazhimi i tij, statusi familjar dhe elemente të tjera që përcaktojnë peshën specifike të dëmit të shkaktuar, duke qenë se për një person të angazhuar në fushën e modelimit, edhe nëse i shkaktohet një dëm krejt minimal, do ishte thelbësore duke qenë se do tëprivohej nga angazhimi i tij kryesor dhe ndoshta i vetëm, në raport me një person tjetër, që nisur nga profesioni që ka dhe angazhimi i tij, një dëmtim i asaj natyre dhe në atë shkallë do ishte krejt i parëndësishëm, pastaj, qenia i ri për më tepër i pamartuar, apo i angazhuar në ndonjë sport, ku pamja ka rëndësinë e vetë, pësimi i çfarëdo shëmtimi edhe në shkallën më të ulët, rezulton më pasojë shumë të lartë. Andaj kompensimi nuk duhet të lidhet me shkallën e shëmtimit, por rezultatin e saj, gjegjësisht pasoja konkrete që një ngjarje e tillë ka shkaktuar në jetën e personit që e ka pësuar atë (Lars, N; 2009, 452-460). Ligjvënësi nuk e ka përcaktuar si rrethanë të veçantë që duhet marrë parasysh gjendjen financiare apo mundësitë ekonomike të shkaktuesit të dëmit (European Group on Tort Law, Principles of European Tort y, Art. 10:401).

KAPITULLI III

1. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME MBI SHPËRBLIMIN E DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

1.1. VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM

Shpërblimi i dëmit në përgjithësi dhe i atij jomaterial në veçanti, gëzon mbrojtje juridike në Republikën e Kosovës, ku LMD i Kosovës, shpërblimin e dëmit si atë material ashtu edhe atë jomaterial e rregullon me nenet 169 deri 193, ku neni 169 para1, “përcakton se, personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 169 para 1).

Sipas LMD së Kosovës, “cenimi i të drejtave të personalitetit të njeriut paraqet arsye dhe shkak për dëmshpërblim gjë që, shihet nga dispozita e nenit 139, me të cilën përcaktohet mbrojtja e personalitetit edhe në fushën e të drejtave civile të garantuara me Kushtetutë” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 139). Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, “me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përpos të drejtave dhe lirive të tjera themelore, në Kapitullin II, është garantuar dinjiteti i njeriut (neni 23), e drejta e integritetit personal (neni 26), e drejta e lirisë dhe e sigurisë (neni 29), e drejta e lirisë së lëvizjes (neni 35), e drejta e privatësisë (neni 36) si dhe shumë liri dhe të drejta të tjera nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të parashikuara nga neni 22 i Kushtetutës, me çrast, të gjitha këto liri dhe të drejta, në rast të cenimit të tyre, mund të realizohen drejtpërdrejt në bazë të Kushtetutës, andaj, këto liri dhe të drejta të garantuara me Kushtetutë janë të mbrojtura edhe me këtë ligj, ashtu që çdokush ka të drejtë të kërkojë nga gjykata ose nga një organ tjetër kompetent të urdhërojë pushimin e veprimit me të cilin shkelet integriteti i personalitetit të njeriut, të jetës personale e familjare dhe të drejta të tjera të personalitetit të tij” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 164).

Qëllimi kyç i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes para shkaktimit të dëmit, dhe nëse kjo gjë nuk është e mundur e që zakonisht është e pamundur të bëhet

rikthimi i plotë i gjendjes së mëparshme, atëherë personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblim në të holla” (<https://ad.rks-gov.net>).

Sipas autorëve Galev dhe Anastasovska, “detyrimi që të kompensohet dëmi i shkaktuar paraqitet në pajtim me rregullat e të drejtës objektive dhe në parim nuk varet nga vullneti i personit përgjegjës, por as nga vullneti i personit të dëmtuar, me përjashtim, dëmtuesi dhe i dëmtuari mund tëmerren vesh se për dëmtuesin nuk do të ketë obligim që dëmin e shkaktuar ta kompensojë ose ai obligim nuk do të kryhet (p.sh. falja e borxhit)” (Galev, G. J; Anastasovska, D; 2012, 744).Ndërkaq sipas Zimmermann, “bazueshmëria e shpërblimit të dëmit jomaterial ka qenë e njohur që në kohëte lashta, duke filluar që nga e drejta romake, ku i dëmtuari përveç shpërblimit të dëmit material, i lihej e drejta të realizonte edhe të drejtën e kompensimit, atë të dëmit jomaterial mbi bazën e një vlerësimi të lirë të të gjitha provave nga ana e gjykatës, duke marrë për bazë të gjitha rrethanat, provat, dhe pretendimet e rastit, dhe një e drejtë e tillë realizohej përmes përdorimit të padisë (actio iniuriarum), që aplikohej jo vetëm në rastet e shkeljeve të dinjitetit dhe reputacionit të individit, por edhe me rastin e cenimit apo dëmtimit të integritetit fizik, sa herë që personi që ishte shkaktar i sjelljes së dëmit sillej në mënyrë të gabuar dhe me faj” (Zimmermann, R., 1996, 1050-1052).

1.2. LARTËSIA E KOMPENSIMIT TË DËMIT JOMATERIAL

Mënyrat e ndryshme të shkakimit të dëmit jomaterial rezultojnë edhe me mënyra dhe forma të ndryshme të kompensimit të tij.Lartësia e kompensimit duhet të përcaktohet duke pasur parasysh që në njërin anë lartësia e shpërblimeve të mos e shtrembërojë efikasitetin dhe efektivitetin e kostos të sistemeve të sigurimit ose të mirëqenies, dhe nga ana tjetër të synohet kompensimi i plotë i dëmit të shkaktuar. Sigurisht që harmonizimi i këtyre dy parimeve, mbi të cilat duhet të strukturohet i gjithë ky proces, për shkak “të natyrës subjektive të tij, nuk mund të përllogaritet me grafikone dhe tabela tëdestinuara vetëm për këtë qëllim, apo kritere që referojnë në kushte abstrakte, si intensiteti apo kohëzgjatja, por gjykata, duke u mbështetur në

parimin e dhënies së drejtësisë sipas bindjes se saj të lirë, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësi, duke u mbështetur edhe në kriteret eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose në mungesë të tyre, në kriteret dhe elemente vlerësimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja përkatëse jashtëgjyqësore, të caktojë nivelin dhe natyrën e dëmshpërblimit në përputhje me dëmin e shkaktuar” (Zimmermann, R., 1996, 1050-1052).

Organizata Botërore e Shëndetësisë, në raportin e saj gjense “për çdo vit, në botë, nga pasojat e aksidenteve, vetëm në trafikun rrugor humbin jetën rreth 1.000.000 njerëz, ndërsa pësojnë lëndime trupore rreth 15 milion njerëz; pra, mesatarisht, për çdo ditë, në botë në aksidente humbin jetën 820 njerëz, ndërsa pësojnë lëndime trupore 50 mijë të tjerë dhe, sot në botë janë më shumë se 30 milion njerëz invalidë nga pasojat e aksidenteve në trafikun rrugor” (OBSh, <http://www.who.int/en/>, mars 2015). Sipas statistikave në Kosovë, “gjatë vitit 2000, kanë ndodhur 8714 aksidente trafiku, shumica prej tyre në rajonin e Prishtinës, Pejës, Gjilanit, Prizrenit dhe Mitrovicës; prej këtyre aksidenteve, 137 kanë qenë fatale, duke shkaktuar vdekjen e 169 personave, ndërsa janë lënduar 1593 persona ku, policia e UNMIK-ut gjatë këtij viti ka regjistruar me mijëra raste të shkeljeve të rregullave në trafik”(Policia e UNMIK-ut – është Polici e Kombeve të Bashkuara e cila ka qenë e vendosur në Kosovë pas luftës si pjesë e administrimit ndërkombëtar të Kosovës).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës “ka aprovuar Rregulloren mbi Procedurat e trajtimit të kërkesave për Kompensimin e dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm nga auto-përgjegjësia më 27 dhjetor 2012” (Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës miratoi këtë Rregullore më 27 dhjetor 2012). Kjo Rregullore “ka për qëllim të promovojë trajtimin e drejtë dhe të barabartë të policëmbajtësve dhe të dëmtuarve nga siguruesit; përmes kësaj Rregullore përcaktohen procedurat për pranimin, regjistrimin, trajtimin, pagesën dhe kontrollin e kërkesave për dëmshpërblim që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia” (Rregullore mbi

Procedurat e trajtimit të kërkesave për Kompensimin e dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm nga auto-përgjegjësia, miratuar nga Bordi i BQK-së, më 27 dhjetor 2012).

1.3. RREGULLIMI LIGJOR I SHKAKTIMIT TË DËMIT NGA AUTOMJETET NË KOSOVË

Në një punim të doktoratës së autores Muharremi, potencohet që: “zhvillimi i transportit publik ka një rëndësi të madhe për jetën dhe për zhvillimin ekonomik të një vendi, meqë ky zhvillim i llojeve të ndryshme të trafikut publik ka lehtësuar qarkullimin e njerëzve, e mbi të gjitha transportimin e mallrave dhe të njerëzve nga një vend në vendin tjetër ku, jeta bashkëkohore as që mund të imagjinohet pa llojet e ndryshme të trafikut publik siç janë: transporti ajror, rrugor, ujor dhe hekurudhor ku përfshihen mjetet motorike të llojeve të ndryshme” (Muharremi, M., 2018, 81). Po sipas autores në fjalë “ky trafik publik ka nevojë për një zhvillim të sigurtë meqë njerëzimi në kohën e sotme është duke e paguar një çmim të madh me viktima në njerëz, me rrezikimin e shëndetit, ngase mjetet motorike përveç se janë ndotës të mjedisit jetësor të njeriut, ato janë edhe shkaktarët e aksidenteve me dëme të mëdha ekonomike, lëndime trupore e madje edhe humbjen e jetës së pjesëmarrëseve në trafikun publik; aksidentet në trafik ndodhin në të shumtën e rasteve meqë ka pjesëmarrës të ndryshëm, madje edhe pjesëmarrës të pandërgjegjshëm, që i ngasin automjetet me shpejtësi të madhe dhe jashtë rregullave të caktuara, apo duke mos iu përshtatur as kushteve të rrugës dhe gjendjes së tyre, si dhe duke mos i respektuar shenjat që e rregullojnë komunikacionin; aksidentet shfaqen edhe për arsye të përdorimit të mjeteve motorike që kanë pesha të ndryshme (kamionët-maunet) dhe që shpesh janë në gjendje jo të rregullt teknike, nga tejkalimi dhe rritja e shpejtësisë, nga infrastruktura jo e mirë rrugore, nga gjendja jo e përshtatshme teknike e rrugëve ekzistuese e veçanërisht kur sinjalizimi është me të meta dhe i vjetëruar apo mungon fare, apo nga mos përshtatja e shpejtësisë me kushtet atmosferike, mos respektimi i dispozitave lidhur me përparësinë në udhëkryq, sjellja kundër dispozitave me rastin e përdorimit të dritave në komunikacion, mos mbajtja e distancës së përcaktuar midis automjeteve, nga mosmirëmbajtja e mirë e rrugëve, gjë që veçanërisht gjatë muajve të dimrit ndikon në

shkaktimin e aksidenteve, aksidente që po shkaktojnë dëme të konsiderueshme materiale, por gjithashtu shkaktojnë edhe lëndime trupore të shkallëve të ndryshme në njerëzit, ku si pasojë, disa po mbesin invalidë për tërë jetën e po ashtu shkaktohen edhe aksidente me fatalitet, pra me humbje të jetës së njerëzve“ (Muharremi, M., 2018, 81).

Në këtë drejtim, sipas Muharremi “Kosova ka miratuar një sërë ligjesh që në mënyrë specifike e rregullojnë komunikacionin, ku një pjesë e konsiderueshme e ligjeve që ndërlidhen me komunikacionin dhe sigurinë në komunikacion janë miratuar nën autoritetin e Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK); ku Ligji mbi Rrugët është draftuar dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2003, ndërsa ai për Transportin Rrugor ka hyrë në fuqi në vitin 2004 ndërkaj, ligji i cili hollësisht e rregullon sigurinë në komunikacion, ai mbi Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, është përpiluar dhe miratuar në Kuvend në vitin 2007, po ashtu në kohën e Administratës së UNMIK-ut, ku këta ligje, të draftuara dhe miratuara si rregullore të UNMIK-ut, janë në fuqi edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, dhe në këtë drejtim edhe Ligji i Policisë, që po ashtu prek komponentën e sigurisë, është miratuar me amendamente në vitin 2012, ndërkaj, nga ana tjetër, edhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Rregullorja për Shërbimet Komunale, si dhe aktet e tjera nënligjore të komunave të Kosovës, janë të një rëndësie të konsiderueshme në kompletimin e bazës ligjore dhe juridike në këtë lëmi; mirëpo, megjithëse të rëndësisë së madhe, këto ligje kanë të metat e tyre dhe në shumë aspekte dështojnë të qartësojnë mjaftueshëm kompetencat e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre gjë që ka ndikuar që në raste të caktuara të krijohet paqartësi në kompetencat e institucioneve, duke dëmtuar qytetarët dhe sigurinë e komunikacionit andaj, kur bëhet fjalë për kornizën ligjore, Republika e Kosovës e ka të rregulluar ligjin përkatës për sigurinë në komunikacionin rrugor pra, Ligji i sigurisë për komunikacion nr 02/L-70, i miratuar në vitin 2008, që paraqet një nxitje drejt ofrimit të sigurisë dhe avancimit të gjendjes në komunikacion”(Muharremi, M., 2018, 81).

Në një rast praktik, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin PP/II.nr.6355/2015, datë 01.03.2017, “ka vendosur të dënojë të pandehurin KG, për veprën penale Rrezikim i trafikut publik, parashikuar nga neni 378 para 6 lidhur me para

1 të KPRK-së, me gjobë në shumë prej 200.00 € (dyqind euro), pasi rezultoi se më datë 5 tetor 2015, rreth orës 23:36h, në Prishtinë, në rrugën Bulevardi i Dëshmorëve, i pandehuri KG, përderisa ishte duke drejtuar automjetin e tipit VW Golf 1J, ngjyrë hiri, ka shkelur Ligjin mbi trafikun rrugor, duke rrezikuar jetën e njeriut dhe të pasurisë në atë mënyrë, që nga pakujdesia ka vepruar në kundërshtim me nenin 1261 të LSKRS, ngase nuk e ka mbajtur distancën e nevojshme të sigurisë kur lëvizë pas mjetit tjetër, në mënyrë që mos të rrezikojë sigurinë e komunikacionit, ashtu që me pjesën e parë ballore e godet në pjesën mbrapa automjetin VW Passat, ngjyrë hiri, të cilën e drejtonte i dëmtuari AQ, i cili nga inercioni i goditjes ku i fundit e godet me pjesën e parë ballore në pjesën mbrapa automjetin Mercedes, ngjyrë e zezë të cilën e drejtonte i dëmtuari DB, i cili në atë moment ishte ndalur para tij, me ç'rast si pasojë shkaktohen dëme materiale në automjete, ndërkaq sipas ekspertizës mjeko-ligjore, i dëmtuari dhe pasagjeri QQ, pësojnë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet; Gjykata shqyrtoi Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa ishin të bazuar në bazë të nenit 495 të KPPK-së, gjeti se ishin plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merrej vendim për urdhër ndëshkimor si në dispozitiv; ku Gjykata vlerësoi se në rastin konkret ekzistonin provat të cilat ishin të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit, se kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej, sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo vërtetohej nga provat sa vijojnë: nga raporti i aksidentit me numër të rastit 2015-AR-2489, dt05/10/2015, raportet mjekësore në emër të të dëmtuarve, ekspertiza mjeko-ligjore e ekspertit mjeko-ligjor NH e datës 26/10/2016, ku lëndimet janë kualifikuar dëmtime të natyrës së lehtë trupore, mendim dhe konstatim i ekspertit të komunikacionit rrugor AM e datës 18/10/2016, që konstaton lëshimet e të pandehurit, si dhe prova tjera nga shkresat e lëndës, që të gjitha këto vërtetonin veprimet në kuptim të veprës penale me të cilën akuzohej i pandehuri dhe, konform KPRK-së, për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 para 6 lidhur me para 1 të KPRK-së, dënimi për këtë vepër penale është se kryerësi dënohet me dënim me gjobë apo burgim deri në një vit, ku konform, KPRK-së, për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 para 1 lidhur me para 6 të KPRK-së, dënimi për këtë vepër penale është

se kryerësi dënohet me dënim me gjobë apo burgim deri në një vit, andaj, Gjykata në përputhje me nenin 73 të KPRK-së, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoi rrethanat në matjen e dënimit, duke vlerësuar se një dënim i tillë ishte adekuat dhe i përballueshëm në raport me gjendjen ekonomike të të pandehurit dhe me këtë dënim do të arrihej qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 41 të KPRK-së dhe se i pandehuri do të përmbahej dhe do të kishte sidomos kujdes të shtuar në trafikun publik, në mënyrë që të mos rrezikohet jeta, shëndeti dhe pasuria materiale e personave në trafikun publik dhe, në mbështetje të nenit 463 të KPP-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike u udhëzua në kontestin civil-juridik” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PP/II.nr.6355/2015, datë 01.03.2017).

PJESA E DYTË

KAPITULLI IV

1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË DISA NGA VENDET E RAJONIT

1.1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Shpërblimi i dëmit jomaterial, gëzon mbrojtje juridike edhe në Republikën e Shqipërisë ku Kodi Civil i Shqipërisë, në nenin 608 lidhur me përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit, parasheh që “personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar” (KCSH, Ligji nr. 7850, 29.7.1994, neni 608).

Lidhur me shpërblimin e dëmit jomaterial në Shqipëri ekziston “Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të 13.09.2007 dhe 14.09.2007, nr 12, i cili ka përcaktuar në mënyrë të detajuar dëmin ekzistencial dhe, gjithashtu ky vendim unifikues ka përcaktuar në mënyrë më të detajuar se çka konsiderohet dëm jomaterial -moral, po ashtu e specifikon se kush ka të drejtë nga anëtarët e familjes që të kërkojë shpërblimin e dëmit jomaterial, në rast të vdekjes së familjarit të tyre dhe, po ashtu, ky vendim përcakton shumën e dëmshpërblimit për dëmin moral, dhe atë në parimin e dhënies së drejtësisë sipas bindjes së saj të brendshme” (Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë, nr. 12, të datës 13.09.2007 dhe 14.09.2007).

Sipas nenit 643 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, gjykata mund të vendosë që shpërblimi të jepet në natyrë ose në para, njëherësh ose me këste, ndërkaq, neni 647/a, i ka paraparë mënyrat dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jopasuror, ashtu që lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë civile dhe masës së dëmit jopasuror, gjykata mban parasysh edhe:

a) Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve;

b) Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve;

c) Format dhe shkallën e fajësisë;

ç) Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë;

d) Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit;

dh) Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik;

e) Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme;

ë) Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore apo kandidatë për zgjedhje;

f) Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar;

g) Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi; dhe,

gj) Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit (KCSH, Ligji nr. 7850, 29.7.1994, neni 647/a).

Një humbje ose pakësim në sferën mendore, morale, në kënaqësitë në jetë, në marrëdhëniet shoqërore, në jetën seksuale etj., e shpërblyeshme nga Kodi Civil i Shqipërisë, që vjen si pasojë e dëmtimeve në shëndet apo në personalitet e dinjitet qoftë kur pretendohet për vete qoftë kur e pretendon për të afërmit e gjallë apo të vdekur (Metalla, A., Nr.2/2012, datë 23.05.2012, 37-38).

1.2. PRETENDIMI I DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në nenin 625, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, ka paraparë që “personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

- a) Ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
- b) Është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
- c) Është cenuar e drejta e emrit;
- ç) Është cenuar respektimi i jetës private; dhe

d) Është cenuar kujtimi i një të vdekuri; ku në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij, deri në shkallë të dytë, mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror” (KCSH, Ligji nr. 7850, 29.7.1994, neni 625).

Prandaj, “Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: Dëmi moral (*pretium doloris* ose *pecunia doloris*) është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë (*non iureperturbatio*) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm” (Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë, nr. 12, të datës 13.09.2007 dhe 14.09.2007).

1.3. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka rregulluar përgjegjësinë juridike civile për shpërblimin e dëmit në përgjithësi dhe dëmin jomaterial në veçanti; kështu ky ligj në nenin 9 të tij, ka paraparë ndalimin e shkaktimit të dëmit, ku potencohet që “secili është i detyruar që të përmbahet nga veprimet me të cilat tjetrit mund t’i shkaktojë dëm, ndërkaq, në nenin 142, ka bërë përkufizimin e dëmit, si zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëmi i zakonshëm) dhe duke parandaluar rritjen

e tij (përfitimin e humbur) gjithashtu duke shkaktuar dhimbje ose frikë tjetër fizike ose mendore (dëmi jo-material)” (LMDRMV, Nr.18, 2001, neni 9 dhe neni 142).

Sipas autorit Mamuti, “edhe pse Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Maqedonisë, rregullon çështjen e shkaktimit të dëmit dhe shpërblimit të tij, në nenet 141-198, prapëseprapë kjo nuk mjafton që me këto të përfshihen dhe shumë situata të tjera që ndodhin në praktikë, prandaj, çështjet e lindjes së përgjegjësisë civile nga shkaktimi i dëmit i hasim edhe nëpër dispozita të ligjeve të tjera, bazuar në konventa të ndryshme ndërkombëtare, andaj, sikurse doktrina juridike dhe praktika gjyqësore, edhe legjislacioni i RMV shumë pak i ka trajtuar rregullat e shkaktimit të dëmit jomaterial dhe shpërblimin e tij për dallim nga shumica e vendeve evropiane dhe SHBA-ve, ku mbrojtja e personalitetit, integritetit fizik dhe psikik, zë një vend të rëndësishëm në kuadër të vlerave të mbrojtura juridikisht ku, përcaktimi i përgjegjësisë jashtëkontraktore me rastin e cenimit të vlerave personale, të provuarit dhe caktimi i lartësisë së shpërblimit të dëmit moral paraqesin vështirësi për gjykatësit kur duhet të vendosin për kërkesat e palëve; edhe pse në vazhdimësi legjislacioni pozitiv, veçanërisht në fushën e shpërblimit të dëmit po plotësohet falë edhe detyrimit për harmonizim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, veçanërisht me Parimet Evropiane të së Drejtës Deliktore, prapëseprapë zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë dhe praktika gjyqësore diktojnë situata nga më të ndryshmet të shpërblimit të dëmit, që nuk mund të parashikohen paraprakisht dhe në mënyrë taksative me dispozita ligjore” (Mamuti, A.,2013, 15).

1.3.1. KRITERET PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Duke vërejtur që dispozitat e Ligjit për detyrimet, si lex-generalis në këtë rast, së pari paraqitet e domosdoshme të përcaktohen personat që kanë të drejtë të kërkojnë kompensimin e dëmit jomaterial, dhe më pas të vazhdohet me kriteret e parashikuara

nga ligjvënësi për përcaktimin e shumës së tij me çrast, personat të cilët kanë të drejtë në shpërblimin e dëmit jomaterial sipas të drejtës në RMV janë:

- Personat fizikë që kanë pësuar shkelje të të drejtave personale;
- Personat juridikë që kanë pësuar shkelje të të drejtave personale;
- Bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit e një personi, në rast të vdekjes së tij ose të dëmtimit të rëndë;
- Aftësisë së kufizuar;
- Vëllezër dhe motra, gjyshër, nipër e mbesa dhe partneri jashtëmartesor nëse në mesin e tyre dhe personi i dëmtuar / i ndjerë kishte një bashkësi më të përhershme jetësore; dhe
- Prindër, në rast të një fëmije të konceptuar dhe të palindur (Radevska, M; 2012, 4).

Megjithëse, nuk është thënë qartë që kriteret i referohen përcaktimit të lartësisë me një kompensim monetar të justifikueshëm, megjithatë, konsiderohet që provizioni ka një natyrë të përgjithshme dhe përmban kritere unike për përcaktimin e meritave të një kërkesë për dëm jopasuror dhe kritere për përcaktimin e masës së kompensimit për dëmin jopasuror.

Nga dispozita ligjore është zgjedhur lista e kriterëve të mëposhtme:

1. Forca dhe kohëzgjatja e dëmtimit që shkaktoi dhimbjen fizike, dhimbje mendore dhe frikë;
2. Qëllimi për të cilin është shërbyer kompensimi;
3. Kompensimi nuk është në kundërshtim me aspiratat që nuk janë në përputhje me natyrën dhe qëllimin shoqëror (Radevska, M., 2012, 5).

1.4. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E MALIT TË ZI

LMD i Republikës së Malit të Zi, përmban dispozita ligjore me të cilat e rregullon çështjen e shpërblimit të dëmit jomaterial; kështu neni 206 i këtij ligji ka paraparë publikimin e aktgjykimit në rast të shkeljes së një të drejte personale si në vijim: “Në rast të shkeljes së një të drejte personale, gjykata mund të urdhërojë që në kurriz të torturuesit, dënimi ose korrigjimi të bëhet publik, ose mund të urdhërojë që torturuesi ta kthejë deklaratën duke shkaktuar shkeljen ose urdhëron diçka tjetër që mund të arrinte qëllimin, përndryshe të arrihet përmes kompensimit” (LMD i Republikës së Malit të Zi, Nr.47/2008, datë 07.08.2008, neni 206).

Për dhimbjet fizike të pësuar, për dhimbjet mendore të pësuar nga zvogëlimi i jetës aktive, për t’u zhgënjyer, për reputacionin e fyer, nderin, lirinë ose të drejtat e personit, për vdekjen e një personi të afërt, si dhe nga frika e pësuar, siguron një bazë përkatëse të saj – shpërblim të dëmit jomaterial të drejtë në mënyrë të pavarur nga kompensimi i dëmit material, edhe nëse kjo e fundit nuk është dhënë. Për shkelje të reputacionit dhe të drejtave personale të një personi juridik, gjykata, nëse është e tillë, vlerësojnë që pesha e shkeljes dhe rrethanat e çështjes ofrojnë arsyetim, dhënie ndaj personit të tillë juridik dëmshpërblim të drejtë financiar (LMD i Republikës së Malit të Zi, Nr.47/2008, datë 07.08.2008, neni 207).

Sipas nenit 208 të LMD i Malit të Zi, “në rast të vdekjes së një personi, gjykata mund t’u japë anëtarëve të afërm të familjes së tij (bashkëshortit, fëmijës dhe prindërve) shpërblim të barabartë për ankthin e tyre mendor; në rast të një paaftësie veçanërisht të rëndë të një personi, gjykata mund t’i japë atij, bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve një dëmshpërblim të barabartë financiar për ankthin e tyre mendor; zhdëmtimi i përcaktuar në paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni mund t’i jepet gjithashtu një bashkëshorti/e jashtëmartesor, nëse një njësi e përhershme shtëpiake do të kishte ekzistuar në mes të bashkëshortit jashtëmartesor dhe të ndjerit, ose personit të

dëmtuar; e drejta për një kompensim të drejtë monetar gjithashtu u takon prindërve në rast të humbjes së fëmijës i konceptuar por i palindur” (LMD i Republikës së Malit të Zi, Nr.47/2008, datë 07.08.2008, neni 208).

1.5. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E SERBISË

Dëmi jomaterial definohet në Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve të këtij shteti. Në këtë ligj është parashikuar që kompensimi monetar dhe jomonetar për dëmet jopasurore që duhen dhënë në rast të cenimit të të drejtave të personalitetit. Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve posaçërisht thekson cenimin e të drejtave të personalitetit në nenin 199 dhe 200, e që i referohet jo vetëm dhimbjes fizike, dhimbjes shpirtërore si dhe frikës, por ky term paraqet një kategori të hapur nën të cilën mund të klasifikohen aspektet e tjera të kompensimit të dëmit material, që i mundëson çdo personi të cilit i është cenuar personaliteti për të kërkuar dëmshpërblim monetar ose jomonetar (Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Serbisë, "Gazeta Zyrtare e RSFJ", Nr. 29/78, 39/85, 45/89 - vendimi i USJ dhe 57/89, "Gazeta Zyrtare e RFJ", nr. 31/93, "Gazeta Zyrtare e SCG", nr. 1/2003 - Karta Kushtetuese dhe "Gazeta Zyrtare e RS", nr. 18/2020, neni 199-200).

Neni 199 i Ligjit për detyrimet, përcakton se “në rast të cenimit të të drejtave të personalitetit, gjykata mund të urdhërojë personin që e ka shkaktuar dëmin të publikojë aktgjykimin”, korrigjimin ose ndryshe taurdhërojë tërheqjen e deklaratës e cila ka shkaktuar cenimin me shpenzime të dëmtuesit, ose çdo gjë tjetër që mund të arrijë qëllimin i cili realizohet me dëmshpërblim, ky nen lë hapësirë që gjykata të marrë një vendim që do të kënaqë më së miri palën e dëmtuar në secilin rast, sepse objektivi i kompensimit jomaterial është saktësisht rivendosja e ekuilibrit psikik të personit të dëmtuar, duke pasur parasysh se secili individ specifik dhe unik nuk mund të përgjithësohet, mënyra jomonetare e kompensimit për dëmin jomaterial e që realisht e mundëson ky nen. Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve, krahas dëmshpërblimit

jomonetar, për dëmin jomaterial parasheh edhe dëmshpërblimin monetar i cili caktohet si kompensim i drejtë monetar.

Dëmshpërblimi monetar i dëmit jomaterial nuk ka si qëllim reparacionin e asaj që e ka humbur i dëmtuari, por që i dëmtuari për shumën e gjykuar të parave të mundë të sigurojë atë kënaqësi e cila në mënyrën më t'i mirë mundëson që të rivendosë ekuilibrin e rënduar psikik (Bećirvović- A, M; Ahmatović-L, A; Viti 7 Issue 13, 2018, 4).

Dallimi thelbësor midis dëmshpërblimit monetar dhe jomonetar të dëmit jomaterial është në mënyrën e të provuarit, sepse i dëmtuari në rastin kur kërkon formën jomonetare të dëmshpërblimit të dëmit, është i obliguar të dëshmojë cenimin e ndonjë të drejte të personalitetit, ndërsa kur kërkon formën monetare të shpërblimit të dëmit, i dëmtuari është i obliguar të dëshmojë cenimin e të mirës personale, por edhe të dëshmojë pasojën e cila ka rezultuar nga ai cenim. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Serbisë, në mënyrë taksative rregullon format e dëmit jomaterial për të cilat mund të gjykohej kompensimi monetar (Bećirvović- A, M; Ahmatović-L, A; Viti 7 Issue 13, 2018, 4).

1.5.1. DISA NGA FORMAT E SHPËRBLIMIT TË DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E SERBISË

Dëmi jomaterial është definuar si shkaktim tjetrit i dhimbjes fizike, psikike apo frikës. Në teori dëmi jomaterial, jopasuror, moral apo ideal paraqet dëmin në të mirat personale dhe jopasurore të njeriut ku tek disa persona të caktuar shkakton shqetësime psikike. Kriteri për dallimin e dëmit material dhe jomaterial qëndron në aspektin e të mirës pasurore dhe jopasurore. Përkundër kësaj vlere e të mirave jopasurore nuk mund të shprehet në para, sepse vlere e tyre është e lidhur për personin të cilit i përket e mira, gjersa për personat e tjerë ajo nuk ka kurrfarë vlere, as përdoruese as qarkulluese.

Të dëmtuarit mund t'i jepet kompensim monetar për dëmin jopasuror vetëm në kushtet e përcaktuara me ligj. Sipas Ligjit për Detyrimet (neni 200),(Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Republikës së Serbisë, neni 200), dëmi jopasuror mund të kërkohej në rastet në vijim:

- **Për dhimbje fizike**

Për ndjenjat e pakëndshme subjektive që vijnë nga stimuj të dëmshëm për nerva specifike, përfundimi në mjekësi përdoret termi dhimbje, dhe termi fizik është pjesë e përcaktimit ligjor, me qëllim të diferencimit nga dhimbjet shpirtërore. Një person që ka vuajtur dhimbje fizike mund të kërkojë kompensim, ku me ekspertizë vërtetohet intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve nga e cila do të varet edhe lartësia e dëmshpërblimit. Kur është fjala mbi intensitetin e dhimbjeve e cila e arsyeton kompensimin, sipas rregullës dhimbjet duhet të jenë të forta dhe të tejzgjatur, e krahas këtij kushti shqyrtohen edhe detaje të tjera të lidhura për çdo rast konkret.

- **Shpërblimi për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor**

Nën këtë bazë konsiderohen të gjitha kufizimet në aspektin e zvogëlimit të aktivitetit jetësor të cilat i dëmtuari i ka realizuar apo në rrethana normale do t'i realizonte në të ardhmen. Në lartësinë e dëmshpërblimit ndikon edhe mosha e të dëmtuarit, intensiteti si dhe kohëzgjatja e dhimbjeve shpirtërore. Ekzistojnë edhe raste kur gjendja e të dëmtuarit përkeqësohet pas marrjes së aktgjykimit, që ka për pasojë shtimin e zvogëlimit të aktivitetit jetësor të tij, atëherë aktgjykimi mund të ndryshohet sepse bëhet fjalë për dëmin e ri.

- **Shpërblimi për shkak të shëmtimit**

Kjo formë e shpërblimit i takon secilit person, sepse për shkak të gjendjes së fytyrës përjeton vuajtje psikike, ashtu që lartësia e dëmit varet nga shkalla e shëmtimit dhe vendi ku gjendet dëmtimi, por nën këtë bazë kërkohej kompensim edhe për humbje të ndonjë pjese të trupit. Një formë më e rëndë e shëmtimit, nënkupton

ndryshime në fytyrë të cilat shkaktojnë neveri të rrethi ose keqardhje, pra vërejtja, shtrirja dhe lokalizimi i dëmtimit janë parametra thelbësorë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit monetar.

- **Shpërblimi për shkak të cenimit i reputacionit, nderit dhe dinjitetit**

Dëmtimi i reputacionit dhe i nderit nënkupton tërësinë e elementeve objektive dhe subjektive, të cilat duhet të vlerësohen në çdo situatë konkrete. Nderi është tërësia e virtyteve njerëzore dhe mendimi që një individ ka për veten e tij, ndërsa reputacioni është një kategori objektive, e cila nënkupton qëndrimin dhe mendimin që ka rrethi për personalitetin e ndonjë individi. Pra, për t'iu pranuar personit të dëmtuar e drejta në satisfaksion monetar për shkak të llojit të sipërtheksuar të dëmit jomaterial, nevojitet ekzistimi i lidhjes shkak-pasojë në mes të ngjarjes me të cilën është shkaktuar dëmi dhe lindja e dëmit jomaterial, si dhe bindja e gjykatës që të gjykojë satisfaksionin monetar në favor të të dëmtuarit.

- **Shpërblimi për shkak të cenimit të lirisë ose të drejtave të personalitetit**

Këtu përfshihen të gjitha pasojat e dëmit që vijnë nga një privim i pajustificuar i lirisë dhe kanë të bëjnë me personalitetin e palës së dëmtuar. Gjykata i merr parasysh të gjitha pasojat subjektive dhe objektive me rastin e matjes së dëmit, siç është reputacioni i hershëm i palës së dëmtuar dhe më vonë pasojat e privimit të lirisë që kanë të bëjnë me sjelljen e mjedisit ndaj tij. Faktorët që merren ende në konsideratë janë natyra, pesha dhe kohëzgjatja e dhimbjes psikike që janë si rezultat i privimit. Edhe kjo formë e dëmit jomaterial rregullohet me nenin 200 të LMD-së, i cili përcakton saktësisht dhe taksativisht se në cilat raste mund të kërkohej kompensim për dëmin jomaterial, dhe mes rasteve të tjera përmend gjithashtu cenimin e lirisë e që përbën bazë për satisfaksion për personin i cili është i privuar padrejtësisht nga liria.

- **Shpërblimi për shkak të vdekjes së një personi të afërt**

Kjo është një bazë tjetër themelore për kompensimin e dëmit jomaterial. Siedhe tek format e tjera edhe në këtë rast lartësia e kompensimit varet nga intensiteti i dhimbjeve të cilat i përjeton i dëmtuari. Rrethana të tjera që janë jashtëzakonisht të

rëndësishme tek kjo formë e kompensimit, janë shkalla e farefisnisë midis personit të dëmtuar dhe personit të vdekur, por edhe lidhjeve emocionale të personave të cekur. Veçanërisht raste të vështira janë fëmijët që humbasin prindërit, sepse me këtë rast ata humbin dashurinë dhe kujdesin nga prindërit e tyre.

- **Shpërblimi për shkak të shkakimit të frikës**

Frika është një çrregullim emocional që lë pasoja psikike tek i dëmtuari, siç është prishja e ekuilibrit mendor dhe trauma. Dhimbja është kryesisht një ndjenjë trupore, gjersa frika është një ndjenjë psikike e natyrës reaktive. Për këtë shkak dhimbjet fizike dhe frika mund, por as nuk do të thotë të ekzistojnë njëkohësisht. Frika paraqitet si primare dhe sekondare. Primare është një ndjenjë ngacmuese që ekziston pak para, gjatë, për kohë të shkurtër pas situatave të rrezikshme ekzistuese, e ndahet në të lehtë, të mesme, të fortë dhe shumë të fortë. Sekondare është një gjendje e mëvonshme emocionale, pas një kalimi të rrezikut ekzistencial dhe më së shpeshti ekziston tek lëndimet e rënda, tek trajtimi dhe shërimi i gjatë dhe rehabilitimi.

1.5.2. DISA RASTE TË SHPËRBLIMIT TË DËMIT JOMATERIAL NGA PRAKTIKA GJYQËSORE NË SERBI

Realizimi i së drejtës për kompensim financiar për dëmin jomaterial, e cila garantohet përmes Ligjit për Detyrimet të Serbisë, përfaqëson arritjen e një shoqërie moderne, demokratike, sepse me këtë mbrohen ndjenjat intime të individit, e drejta e tij që lirshëm të lëvizë, të mendojë, të jetojë jetën si person i dinjitetshëm. Gjykata me rastin e dhënies së verdiktit do të duhej të marrë parasysh të mirën e cila është dëmtuar si dhe qëllimin për të cilin ekziston kompensimi. Për t'u rivendosur balanca psikike tek personi i dëmtuar e cila është rënduar, do t'i gjykohej kompensimi monetar.

Për të realizuar të drejtën e tij për kompensim për dëmin jopasuror, pala e dëmtuar duhet të fillojë një procedurë në gjykatën kompetente. Kompensimi i dëmit jomaterial paraqet satisfaksion për dëmin e pësuar, ashtu që tek i dëmtuari të rivendoset ekuilibri psikik dhe emocional, i cili ka ekzistuar para ndodhjes së dëmit.

Nderi definohet si kategori subjektive si dhe si mendim të cilin e ka individi për veten, si pjesëtar i një rrethi të caktuar apo grupit shoqëror, vlerën e të cilës e ka pranuar, kurse reputacioni paraqet mendimin të cilin e ka rrethi, opinionin publik mbi personalitetin dhe i cili është kategori objektive.

1.6. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË FEDERATËN E BOSNJË E HERCEGOVINË DHE NË REPUBLIKËN SERBE

Ngjashëm si shtetet e tjera të rajonit të përmendura në këtë kapitull, edhe Bosnjë dhe Hercegovina ka rregulluar çështjen e shpërblimit të dëmit jomaterial në kuadër Ligjit për marrëdhëniet e Detyrimeve, ku ky ligj në nenin 200, parasheh që, “për dhimbjet fizike të pësura, për dhimbjet shpirtërore të pësura për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, dëmtimin e reputacionit, nderin, lirinë ose të drejtën e personalitetit, vdekjen e një personi të afërt si dhe për frikën, gjykata nëse konstaton rrethanat e rastit, dhe veçanërisht intensitetin e dhimbjes dhe frikës dhe kohëzgjatjen e tyre e arsyeton atë, duke dhënë kompensim të drejtë financiar, pavarësisht nga dëmshpërblimi i dëmit material dhe në mungesë të tij; me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për dëmshpërblim për dëmin jomaterial, si dhe lartësinë e tij, gjykata merr parasysh rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimin për të cilën shërben ai dëmshpërblim, por gjithashtu edhe për atë që nuk favorizon aspiratat që nuk janë në përputhje me natyrën dhe qëllimin shoqëror”(Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve i Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Republikës Serbe, "Gazeta Zyrtare e RSF", Nr. 29/78, 39/85, 45/89 dhe 57/89), "Gazeta Zyrtare e R BiH", Nr. 2/92, 13/93 dhe 13/94, ("Gazeta Zyrtare RS", Nr. 17/93 dhe 3/96, neni 200).

1.7. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË KROACI

LMD i Republikës së Kroacisë, e ka pranuar konceptin objektiv të dëmit jopasuror (në vend të termit dëm jomaterial përdoret termi dëm jopasuror) ku, neni 19 numëron, për shembull, të drejtat themelore të personalitetit dhe neni 1046 jep një koncept të

përgjithshëm të dëmit, ku e përcakton dëmin jopasuror si shkelje të të drejtave të personalitetit dhe, të gjitha ndryshimet në këtë fushë janë pasojë e ndryshimit të konceptit të dëmit ku, krahas të drejtave të personalitetit të personave fizik përmenden edhe të drejtat e personalitetit të personave juridikë ku, personat fizikë dhe juridikë janë të barabartë në të drejtën e riparimit të dëmshpërblimit jomonetar dhe në të holla për dëmin jopasuror dhe, dhimbja e pësuar fizike, dhimbja mendore dhe frika janë vetëm një masë e ashpërsisë së cenimit të të drejtave të personalitetit dhe merren parasysh, krahas rrethanave të tjera vendimtare, gjatë përcaktimit të masës së kompensimit të drejtë monetar (neni 1100) andaj, dëmi jopasuror, si dëm i njohur ligjërisht, mund të ndodhë edhe kur nuk ka dhimbje dhe/ose frikë ndërkaq, konform dispozitave të nenit 1101, në rast vdekjeje ose paaftësie veçanërisht të rëndë të një personi, anëtarët e familjes së ngushtë (bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit) kanë të drejtën e kompensimit të drejtë në të holla për dëmin jopasuror, dhe një kompensim i tillë mund t'u jepet gjithashtu vëllezërve e motrave, gjyshërve, nipërve dhe një partneri të zakonshëm, nëse ka pasur një bashkësi më të përhershme të jetës midis tyre dhe personit të vdekur ose të dëmtuar por, e drejta për kompensim të drejtë monetar u jepet edhe prindërve në rast të humbjes së një fëmije të ngjizur dhe të palindur (Për më tepër shih në: I. Crnić, Pravo fizičke osobe na popravljanje neimovinske štete, Naknada štete u primjeni novog Zakona o obveznim odnosima, Zagreb 2005, 5-49; P. Klarić, Naknada neimovinske štete, Zakon o obveznim odnosima, Zagreb 2005, 27-49; P. Klarić, Odgovornost za neimovinsku štetu, Zbornik radova sa XVIII susreta pravnika, Opatija 2005, 174-195; A. Radolović, Pravo osobnosti u Novom zakonu o obveznim odnosima, Zbornik Pravnog fakulteta Sveučilišta u Rijeci, vol. 27, br. 1/06, 129-168; D. Strinović, J. Škavić i D. Zečević, Pristup vještačenju naknade za neimovinsku štetu prema ZOO/05, Zagreb 2009; S. Petrić, Neimovinska šteta u Zakonu o obveznim odnosima Republike Hrvatska, Pravna riječ, br. 28/11, 169-191).

1.8. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË SLLOVENI

Sipas nenit 132 të Kodit të Detyrimeve në Slloveni, dëmi është zvogëlimi i pasurisë (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i rritjes së saj (përfitimi i humbur), si dhe shkaktimi i dhimbjes ose i frikës fizike ose psikologjike ndaj të tjerëve dhe si dëmtim i reputacionit të personit juridik (dëm jomaterial), ku dispozitat për kompensimin e dëmeve jomateriale gjenden në nenet 178-185 ku shumica e këtyre dispozitave janë identike me dispozitat përkatëse të vendeve të tjera të rajonit, me atë që, vetëm nenet 180 dhe 183 kanë sjellë disa ndryshime, ku neni 180 e zgjeron rrethin e personave që kanë të drejtën e kompensimit në të holla për dëmin jomaterial për shkak të paaftësisë veçanërisht të rëndë të një të afërmi dhe përcakton se kjo e drejtë u takon edhe vëllezërve, motrave dhe partnerit të tij, nëse ka një bashkësi më të përhershme të jetës mes tyre dhe personit, ku risia është se i është vendosur e drejta për kompensim të drejtë monetar personit juridik për shkak të cenimit të reputacionit të biznesit (neni 183), dhe se titulli i nenit është ndryshuar me emërtimin e ri si cenim i dinjitetit (neni 181) ku, personi juridik ka të drejtën e kompensimit financiar për dëmtimin e reputacionit ose emrit të mirë, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material, nëse gjykata vlerëson se rrethanat e çështjes e justifikojnë atë, pra, mbrojtja juridike e reputacionit të një personi juridik ofrohet me mbrojtje më të fortë dhe më të plotë se cenimi i nderit dhe reputacionit të një personi fizik (Mihajlović, N., br. 10/07, 51-59).

KAPITULLI V

1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË DISA NGA VENDET E UNIONIT EUROPIAN

1.1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN FEDERALE TË GJERMANISË

Kodit Civil Gjerman (B.G.B. –Bürgerliches Gesetzbuch), i miratuar më 18 gusht të vitit 1896, ka hyrë në fuqi më 1 janar 1900, rregullon çështjen e shpërblimit të dëmit jomaterial në Republikën Federale të Gjermanisë (Kodi Civil i Republikës Federale të Gjermanisë, i miratuar më 18 gusht të vitit 1896 dhe që ka hyrë në fuqi në 1 janar 1900).

Kodi Civil Gjerman, në nenin 253, lidhur me shpërblimin e dëmit jomaterial ka paraparë se kompensimi mund të bëhet vetëm në para dhe kjo mund të kërkohej në raste të caktuara. Gjithashtu me rastin e dëmtimit të trupit, shëndetit, lirisë ose vetëvendosjes seksuale, kompensimi do të kërkohej në të holla. Ky nen specifikon se shpërblimi i dëmit jomaterial mund të kërkohej pavarësisht dëmit material. Kodi Civil Gjerman njeh të drejtën për shpërblimin e dëmit në përgjithësi dhe atij jomaterial në veçanti. Ky kod në nenin 253 parasheh që pala e dëmtuar mund të kërkojë kompensim të drejtë monetar për dëmin jopasuror.

Kompensimi për dëmtimin trupor të pësuar jepet në një shumë të vetme. Gjykatat nuk lejohen të caktojnë shuma për pjesë të ndryshme të dhimbjes, për qëllime ose kohë të ndryshme. Vetëm në raste të jashtëzakonshme (për shembull në rast dëmtimesh të rënda të përhershme, nëse është i nevojshëm trajtim shtesë mjekësor,

etj., gjykatat mund të japin një tarifë shtesë mujore. Në rastet e traumave mendore, kompensimi mund të kërkohej me kusht që reagimet psikike të jenë dëmtuar. Palët në dëmtimin e pësuar rezultojnë në një sëmundje mendore të diagnostikuar mjekësish dhe nuk krijojnë reagim dukshëm të pajustificuar në një aksident (Pscheidl, D; Nr.4/2006, 16). Nëse trauma mendore nuk është rezultat i një dëmtimi trupor, vetë i dëmtuari mund të kërkojë kompensim, por vetëm në rrethana shumë specifike:

- Pala e dëmtuar vuan nga një sëmundje mendore e diagnostikuar mjekësore që tejkalon ato normale, reaksione në situata të ngjashme (për shembull jo pagjumësi e mjaftueshme e butë);

- shoku mendor;

- duhet të ketë një lidhje personale shumë të ngushtë midis të mbijetuarit e shokut dhe palëve të dëmtuara drejtpërdrejt (zakonisht fëmijët, prindërit dhe bashkëshortët) mund të kërkojnë kompensim.

Legjislatura gjermane është nga të parat e cila e njeh shpërblimin e dëmit, edhe pse ajo ka qenë e pranuar në formë shumë të kufizuar. Kodi Civil Gjerman i vitit 1900 e ka lejuar shpërblimin e dëmit jomaterial pa kufizim në rastet e shpërblimit në natyrë. E drejta e personalitetit nuk është paraparë me dispozitat e KCGJ, në mënyrë të përgjithshme, përveç se në par. 12 që e ka pranuar të drejtën në emër, si formë të posaçme të personalitetit. Të drejtat e tjera të personalitetit janë të mbrojtura me nenin 823, i cili parasheh: kush qëllimisht apo nga pakujdesia, në mënyrë të kundërligjshme ia cenon jetën, trupin, shëndetin, lirinë, pronën apo të drejtën e tjetrit, atëherë obligohet që tjetrit t'ia shpërblejë dëmin e shkaktuar (Blagojević, T.B; 1970, 853). Me ligje të veçanta është paraparë mundësia e shpërblimit të dëmit, si p.sh. me nenin 97, par. 2 të Ligjit mbi të drejtat e autorit, nenit 29, par. 2 të Ligjit mbi energjinë nukleare etj (Petrović, Z; Dožić, N; 2011, 454-470).

Me ndryshimet e KCGJ-së të cilat hynë në fuqi më 2002, u bë reforma e të drejtës së shpërblimit. Qëllimet kryesore të reformës ishin: që ligji t'i përshtatet nevojave aktuale, që të avancohet mbrojtja e të dëmtuarve, posaçërisht në rast të

lëndimit trupor, të avancohet pozita e fëmijëve në rast të fatkëqijve të komunikacionit, të tejkalohet zbrazëtira në përgjegjësi e cila ka ekzistuar në mes të përgjegjësisë për fatkeqësi të komunikacionit dhe përgjegjësisë për prodhime farmaceutike dhe e drejta gjermane për shpërblim të vihet në standarde Evropiane. Po ashtu, është mundësuar shpërblimi i drejtë i dëmit jomaterial të realizohet edhe sipas rregullave të përgjegjësisë kontraktuese, rregullave të përgjegjësisë parakontraktuese dhe jashtëkontraktuese për dëmin. Sot i dëmtuari nuk ka nevojë gjithëherë të dëshmojë fajin e dëmtuesit (Petrović, Z; Dožić, N; 2011, 454-470).

Pra, Kodi Civil Gjerman nuk e përcakton konceptin e dëmit jomaterial meqë konform këtij kodi, dëmi jomaterial është dëmi që nuk është pasuror ose material (pra jepet një përkufizim negativ) dhe, në parim, ai nuk njeh të drejtën e kompensimit në të holla për këtë dëm, por e njeh atë vetëm përjashtimisht, në rastet e parashikuara në ligj dhe, e drejta gjermane e dëmshpërblimit është kryesisht e drejtë gjyqësore pra e drejtë e precedentëve ku kompensimi përcaktohet sipas parimit të drejtësisë (Billigkeit) dhe, gjatë përcaktimit të masës së kompensimit të drejtë, merren parasysh madhësia, forca dhe kohëzgjatja e dhimbjes, vuajtjes dhe lëndimit, si dhe të gjitha rrethanat e rastit konkret; gjë që, para së gjithash, kjo i referohet shkallës së fajit të autorit dhe sjelljes së tij pas lëndimit të viktimës, gjendjes financiare të palëve, gjinisë, moshës, ndjeshmërisë ndaj dhimbjes e të ngjashme; mirëpo, në jurisprudencën gjermane, ekziston një rregull që përveç rasteve të përcaktuara në ligj, kompensimi i drejtë monetar i këtij dëmi është i mundur edhe në rastet e shkeljeve më të rënda të të drejtave të përgjithshme personale gjë që, e zgjeroi ndjeshëm fushën e zbatimit të rregullit për kompensimin në të holla të dëmit jomaterial dhe, gjykatat vlerësojnë dëmet për të gjitha dëmet jomateriale rast pas rasti dhe kanë lirinë për të përcaktuar shumën e kompensimit ku është interesante se sipas legjislacionit gjerman nuk është e mundur të kërkohet kompensim për dëmet jomateriale për shkak të vdekjes ose lëndimit të rëndë të një të afërmi (Petrović, Z., Dožić, N., 2011, 454-470).

1.2. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË FRANCË

Kodit Civil Francez (Kodi i Napoleonit), i cili ka hyrë në fuqi më 21 mars 1804, e rregullon shpërblimin e dëmit jomaterial në Francë ku, neni 1382 parasheh që, “çdo veprim i çfarëdoshëm i personit me të cilin i shkaktohet dëm tjetrit, e bën të lidhur atë që ta riparojë dëmin pavarësisht fajit të tij”, kurse neni 1383 thotë që “çdonjëri është përgjegjës për dëmin që ka shkaktuar, jo vetëm me veprimet e tij, por edhe nga pakujdesia e tij apo pamaturia e tij andaj, doktrina franceze e ndikuar nga ajo romake bën dallimin ndërmjet deliktit dhe kuazi-deliktit, pasi sa herë që dëmi shkaktohet për fajin e autorit kemi të bëjmë me delikt, ndërsa kur dëmi ka ardhur pa fajin e personit kemi të bëjmë me kuazidelikt” (Kodit Civil Francez (Kodi i Napoleonit), i cili ka hyrë në fuqi më 21 mars 1804, nenet 1382-1383).

Dëmi është përcaktuar tradicionalisht në të drejtën civile franceze si sulm ndaj një interesi patrimonial ose ekstras-patrimonial të një personi të quajtur viktimë. Lëndimi është sinonim i "dëmtimit" në përdorimin e zakonshëm. Këto janë pasojat juridike të dëmtimit të pësuar nga një person fizik ose juridik në integritetin e tij fizik, në pronën e tij, në ndjenjat e tij, për nder të tij(https://wikimonde.com/article/Pr%C3%A9judice_en_droit_civil_fran%C3%A7ais).

Dëmi është fakti që lind në të drejtën e viktimës për kompensim. Kështu, nëse dëmi korrespondon me një fakt material, dëmi korrespondon me pasojën e tij që përfshin të drejtën e dëmshpërblimit dhe kompensimit. Dëmi si sulm ndaj integritetit fizik të një personi, i cilësuar edhe si dëmtim fiziologjik ose funksional (amputimi i një gjymtyre etj.). Kompensimi më pas përcaktohet sipas shkallës së paaftësisë. Kjo i referohet pamundësisë së kryerjes së aktiviteteve të caktuara, privimit total ose të pjesshëm, të përkohshëm ose përfundimtar të kënaqësive të jetës dhe gëzimeve të ekzistencës (për shembull pamundësia për të ushtruar një sport, një aktivitet artistik, humbje shije, çrregullim i jetës seksuale) por edhe dëmtime estetike që konsistojnë në këmbënguljen e një turpi të përhershëm në viktimë (plagët, shëmtinë). Lëndimi trupor gjithashtu mund të shkaktojë dëme ekonomike (për shembull humbja e pagave që vjen si pasojë e pamundësisë për të punuar pas aksidentit, shpenzimet mjekësore, kostot e pajisjeve etj.). Ekzistojnë tre lloje të dëmtimit: dëmtimi trupor, dëmtimi material dhe

dëmi jomaterial (moral). Por për shkak se kjo paraqitje është vetëm një ndërtim ligjor i cili rezulton se është gjithnjë e më pak i përshtatur me realitetin që synon të qeverisë, autorë të caktuar mbështeten vetëm në aspektin ligjor (Par ex. Ch. Broche, La notion juridique de dommage en droit de la responsabilité civile extracontractuelle, thèse 2010, Université de Grenoble).

1.2.1. DALLIMI NDËRMJET DËMIT MATERIAL DHE JOMATERIAL SIPAS LEGJISLACIONIT FRANCEZ

Sipas ligjit francez dëmi material është një sulm ndaj trashëgimisë së viktimës. Me fjalë të tjera, ato që pas një sulmi ndaj pasurisë së një personi konsistojnë në dëmtimin e interesave të një natyre ekonomike. Dëmi material krijon të drejtën e kompensimit, vlera e së cilës vlerësohet në mënyrë sovranë nga gjykatësit gjykues sipas parimit të kompensimit të plotë të dëmit (https://wikimonde.com/article/Pr%C3%A9judice_en_droit_civil_fran%C3%A7ais).

Ndërsa, dëmi jomaterial (moral) përkufizohet përtej dëmit material si ekstracionale, ashtu që sipas të drejtës franceze edhe nëse dëmet shkaktojnë kompensim financiar të destinuar për të hyrë në trashëgiminë e viktimës, disa vetëm dëmtojnë interesat e një natyre ekstracionale, kjo është arsyeja pse ato shpesh cilësohen si dëmtime morale. Këto dëmtime morale, siç janë dëmtimi i nderit, reputacionit dhe kredisë së personit, meritojnë të riparohen, pavarësisht nëse viktima është një person fizik ose juridik. Disa paragjykime morale janë specifike për personin fizik, në fakt ky është rasti me premium doloris (çmimi i dhimbjes). Lista, e cila nuk është shteruese dhe e papërcaktuar, përfshin në veçanti:

- vuajtja fizike e duruar nga viktima e dëmtimit trupor;
- dëmtimi i afeksionit të lidhur me vuajtjet morale të shkaktuara nga vdekja e një të dashuri, apo edhe nga humbja e një kafeje;
- dëmi seksual;
- dëmtimi estetik; dhe

- në përgjithësi humbja e kënaqësisë, të cilën praktika gjyqësore e përcakton si humbje ose zvogëlim të praktikës së një veprimtarie në krahasim me praktikën e bërë para ndodhjes së aksidentit (Jacqueline, M-D; 2015, 738).

Për shembull, në vitin 2008, një organ i arbitrazhit i caktuar nga Christine Lagarde, urdhëroi një bankë publike të paguante Bernard Tapie kompensim prej 45 milion euro për "dëm moral" të shkaktuar në biznesin e tij(https://www.lemonde.fr/argent/article/2015/02/18/indemnites-pour-prejudice-moral-l-affaire-tapie-a-change-les-regles-fiscales_4578830_1657007.html).

1.3. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË ITALI

Kodi Civil Italian, i lëshuar me dekretin mbretëror n.262, dt. 16 mars 1942, ndërsa në mënyrë simbolike ka hyrë në fuqi më 21 prill 1942 (Kodi Civil Italian, nr.262, dt. 16 mars 1942, ka hyrë në fuqi më 21 prill 1942). Kodi përmban 2999 nene dhe është i ndarë në gjashtë pjesë (Aliu, A; 2013, 72-73). E drejta e detyrimeve rregullohet në pjesën e katërt të tij, ndërsa shpërblimin e dëmit jomaterial e ka paraparë në nenin 2059, i cili thotë: Dëmi jopasuror duhet të kompensohet vetëm në rastet e përcaktuara me ligj. Rregulli në fjalë duket se thotë gjithçka dhe asgjë, por ai përcakton një parim themelor, domethënë nëse nuk ka ligje që parashikojnë shprehimisht kur dëmshpërblimi ekziston, nuk është e mundur të njihet asnjë lloj freskimi për ata që vuajnë dëmtime jopasurore. Dhe ky supozim ka qenë prej kohësh udhëzuesi për shumë vendime. Arsyeja mund të gjendet në një artikull tjetër të sistemit juridik italian, neni 185 i kodit penal, ku sipas kësaj norme, çdo krim që ka shkaktuar dëme jopasurore detyron palën fajtoare dhe personat të cilët, sipas ligjeve civile, duhet të përgjigjen për faktin se ai dëm do kompensuar. Nëse nuk do të ishte kryer asnjë krim ose shkelje, asnjë lehtësim nuk do të ishte i pranueshëm, përveç dëmit monetar. Me kalimin e kohës, megjithatë, një rëndësi më e madhe i është kushtuar gjithçka që lidhet me moralin, shëndetin, dinjitetin e qenies njerëzore. Ashtu që për këtë arsye i është hapur

rruga një interpretimi që i ka dhënë të ashtuquajturën dëm moral, dëm biologjik dhe dëm ekzistencial(<https://legaldesk.it/blog/danno-non-patrimoniale-da-sapere>).

Nga ana konceptuale, dëmi jopasuror, sipas Kodit Civil Italian, mund të diferencohet në:

- a) dëmi biologjik: është dëmtim i shëndetit, ose dëmtim i përkohshëm ose i përhershëm i integritetit psiko - fizik të personit, i prekshëm nga një vlerësim mjeko- ligjor, për të verifikuar ndikimin negativ në aftësinë për të kryer aktivitete të zakonshme ditore dhe në jetë, lidhëse dinamike e të dëmtuarit (pasojat mbi aftësinë për të prodhuar të ardhura nuk janë të rëndësishme këtu). Dëmi biologjik do të përfshijë si dëmtimin fizik ashtu edhe atë mendor (mendoni për ankthin patologjik pas një traume etj.), dhe do të kompensohen pavarësisht nga efektet në gjendjen pasurore të të dëmtuarit, me kriteret e drejta likuidimi. Prandaj, në bazë të një mendimi të ekspertit mjeko- ligjor, do të jetë e nevojshme të konstatohet pavlefshmëria e përkohshme dhe e përhershme, të fitohet në para nga një sistem tabelor që synon të shmangë diskrecionin në shlyerjen e dëmit.

Në sistemin juridik Italian, bëhet dallimi ndërmjet dëmit moral subjektiv dhe dëmit ekzistencial:

- b) dëmi moral subjektiv: është vuajtja subjektive e pësuar nga i dëmtuari si rezultat i një akti të paligjshëm, që të kompensohet në ato raste të parashikuara me ligj, me likuidim mbi një bazë të barabartë.
- c) dëmi ekzistencial: kuptohet si çdo kompromis i veprimtarive realizuese të personit njerëzor. Mendoni për dëmtimin e qetësisë së familjes, apo mos kënaqjen e një mjedisi të shëndetshëm etj(<https://www.consulenzalegaleitalia.it/danno-patrimoniale-non-patrimoniale/>).

Në këtë drejtim duhet potencuar që, jurisprudenca italiane siguron mbrojtje edhe kur dëmi nuk shkaktohet nga veprime të dënueshme, duke pasur parasysh vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 1986, i cili inauguroi termin dëmi biologjik, i cili

nuk bën pjesë në grupin e dëmit pasuror apo moral dhe, ky dëm vjen si pasojë e cenimit të së drejtës për jetë dhe shëndet, dhe baza e tij është neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Italisë andaj, sa herë që një person ka dëm, ai kompensohet në formën e dëmit biologjik me atë që ky dëm është bërë forma dominuese e dëmit jomaterial me atë që, Ligji nr.57, i 3 majit 2001 në nenin 5 përcakton kriteret unike për llogaritjen e dëmit biologjik, të përkohshëm dhe të përhershëm mirëpo, duhet thënë që, megjithatë, dëmi moral mbeti si formë e veçantë e dëmit jomaterial por, vendimet e Gjykatës së Kasacionit dhe Gjykatës Kushtetuese të vitit 2003 kanë prezantuar edhe konceptin e dëmit ekzistencial “për shkelje të të drejtave personale të garantuara me Kushtetutë), por koncepti i këtij dëmi ende nuk është përcaktuar mjaftueshëm dhe tani për tani ky dëm përkon me dëmin moral dhe atë biologjik” (Ćurković, M; 2006, 43-44).

1.4. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË AUSTRI

Kodi Civil i Përgjithshëm Austriak, i cili është miratuar më dt. 01.06.1811 dhe ka hyrë në fuqi më 01.01.1812 (Kodi Civil i Përgjithshëm Austriak, i cili është miratuar më dt. 01.06.1811 dhe ka hyrë në fuqi më 01.01.1812), rregullon çështjen e shpërblimit të dëmit jomaterial).

Kompensimi për dëmin më saktë, rregullohet në Ligjin austriak të kompensimit të dëmit. Janë përcaktuar kushtet në të cilat një palë e dëmtuar kompensohet për dëmin e shkaktuar nga një tjetër. Shuma e kompensimit këtu kryesisht ka për qëllim kompensimin e palës së dëmtuar për dëmin e pësuar. Dëmtimi i afërt, megjithatë, gjithashtu ka një efekt parandalues dhe ndihmon për të shmangur dëmtimin përmes sjelljes së kujdesshme. Ligji austriak për dëmet në përgjithësi bën dallimin midis dëmit që i shkaktohet pasurisë dhe dëmit që nuk është i një natyre financiare dhe prek drejtpërdrejtë një person. Si shembull, mund të citohet një aksident trafiku, në të cilin, nga njëra anë, një makinë u dëmtua (humbja e pronës) dhe, nga ana tjetër, një person u lëndua (lëndim personal). Për më tepër, ligji austriak për dëmet bën dallimin midis

dëmit që vjen nga prishja e kontratës (p.sh. kompensimi i mos-performancës) dhe dëmi që është shkaktuar nga një krim. Në rastin e një dëmi torturues, pala e dëmtuar duhet të dëshmojë se pala e dëmtuar ishte përgjegjëse për dëmin (seksioni 1296 i Kodit Civil Austriak). Në të kundërt, në rast të shkeljes së kontratës, personi që e prishi kontratën duhet të dëshmojë se nuk është në faj, neni 1298 i Kodit Civil Austriak (Compensation - When is compensation to be paid in Austria? <https://www.anwaltfinden.at/ratgeber/schadenersatzrecht/schadenersatz/>).

1.4.1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL PËR SHKAK TË LËNDIMIT PERSONAL SIPAS LIGJIT AUSTRIAK

Në rastin e humbjes financiare, ligji austriak i torturave bën dallimin midis humbjes pozitive, në të cilën prona ekzistuese është dëmtuar dhe fitimit të humbur. Një fitim i humbur nënkupton dëmin që ka parandaluar një rritje të pasurive ose ka shkatërruar një mundësi për të fituar jetesën. Kërkesat për dëme duhet të pohohen vetëm në rast të një dëmi të qëllimshëm dhe pakujdesie të rëndë. Sidoqoftë, jo të gjitha dëmtimet mund të maten në drejtim të parave. Prandaj, përveç humbjes financiare, dëmi jomaterial merret parasysh edhe në ligjin e kompensimit të dëmit në Austri. Kjo mund, p.sh., lëndimi personal në formën e dëmtimit trupor ose dëmtimit të reputacionit përmes shpifjeve. Për më tepër, pala e dëmtuar duhet të kompensohet për çdo humbje të fitimeve që nga dëmtimi dhe për të ardhmen. Ky kompensim përfshin të gjitha disavantazhet financiare nga ulja ose humbja e të ardhurave, si dhe humbja e mundësive të dukshme të përparimit në karrierë. Edhe pakujdesia e vogël është e mjaftueshme për këtë fitim të humbur. Në rast se i dëmtuari vdes, të gjitha shpenzimet që lidhen me vdekjen duhet të rimbursohen. Përveç shpenzimeve të varrimit dhe varrit, mirëmbajtja duhet të paguhet edhe për të afërmit e tij, nëse i ndjeri është dashur të kujdeset për ta sipas ligjit (<https://www.anwaltfinden.at/ratgeber/schadenersatzrecht/schadenersatz/>).

1.5. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË ZVICËR

Sipas Kodit Civil të Zvicrës, e drejta e kompensimit të dëmit jomaterial i takon të dëmtuarit të cilit i është shkelur e drejta me veprim të kundërligjshëm, përveç rastit kur i dëmtuari ka dhënë pëlqimin (neni 28) ku, ai ka të drejtë të kërkojë ndalimin e sjelljeve të caktuara, konstatimin e një veprimi të kundërligjshëm, publikimin e aktgjykimit dhe shpërblimin e dëmit ku, ky nen shërben si një klauzolë e përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave personale të shkelura, pasi nuk kufizohet vetëm në pronën personale individuale, ndërkaq, reforma e ligjit të detyrimeve nga viti 1911 i lejoi gjyqtarit, sipas rrethanave të veçanta të çështjes, në rast vdekjeje ose lëndimi trupor, t'i jepte dëmshpërblim në të holla viktimës ose të afërmeve të viktimës (neni 47 i Kodit të Detyrimeve) ndërkaq, neni 49, para 1 i të njëjtit Kod parashikon se në rast të lëndimit të rëndë të gjendjes personale i dëmtuari mund të kërkojë kompensim monetar si shpërblim nëse nuk ka mundësi të tjera për të kompensuar dëmin dhe nëse ashpërsia e dëmtimit e justifikon atë, me çrast, gjyqtari e vlerëson kompensimin e drejtë sipas gjykimit të tij të lirë, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat ka ndodhur dëmi dhe shkallën e fajit të të dëmtuarit por, në këtë drejtim, me rishikimin e ligjit të detyrimeve të vitit 1983, në vend të shkeljes së gjendjes personale ajo atni quhet lëndim personal, dhe shkalla e fajit të palës që dëmton hiqet nga rrethi i supozimeve të përgjegjësisë për dëmin jo material (Ćurković, M., 2006, 43-44).

1.6. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË GREQI

Edhe Kodi Civil Grek e parashikon të drejtën e kompensimit të dëmit jomaterial në raste të caktuara ku, neni 932 parashikon të drejtën e dëmshpërblimit për dhimbjen fizike dhe mendore të pësuar nga kushdo, të cilit dëmi i shkaktuar nga një veprim i kundërligjshëm ose për fajin e tij i ka shkaktuar dëm shëndetit ndërkaq, në rast të vdekjes së të dëmtuarit, gjykata mund të caktojë dëmshpërblim për dhimbjen mendore të pësuar për të afërmit e tij ku, këta persona përfshijnë: bashkëshortët, fëmijët,

prindërit dhe vëllezërit e motrat (nenet 1537, 1555, 1559, 1569, 1579) dhe, kompensimi i dhimbjes fizike përcaktohet në bazë të peshës së lëndimit, ndërsa kriteret janë: mënyra dhe rrethanat e lëndimit, shkalla e fajit dhe gjendja ekonomike dhe sociale e palëve (Mrvić, N., br. 6/95, 221-222).

1.7. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË POLONI

Kodi Civil i Polonisë e njeh të drejtën për kompensim monetar për dëmin jomaterial në rastet e renditura në detaje, ku neni 445, para 1 është parashikon një kompensim të drejtë financiar në rast lëndimi trupor ose dëmtimi shëndetësor, në nenin 445, para 2 për rastin e cenimit të lirisë, përfshirë lirinë seksuale, dhe neni 446 për personat e dëmtuar në mënyrë indirekte për rastin e vdekjes së një të afërmi dhe, dispozita e përgjithshme e nenit 448 parashikon se në rast të shkeljes së interesit personal, “i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë pagesën e një shume të caktuar parash në dobi të Kryqit të Kuq Polak por, më vonë, kjo dispozitë u ndryshua në thelb, kështu që tani i dëmtuari në rast të shkeljes së interesit personal ka të drejtë të kërkojë kompensim të drejtë monetar sipas zgjedhjes së tij, qoftë për përfitimin e tij ose për një qëllim të caktuar shoqëror-humanitar” (Kodi Civil i Polonisë, nenet 445-448).

KAPITULLI VI

1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË VENDET E SISTEMIT JURIDIK ANGLOSAKSON

1.1. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË SHBA

Sikurse shumica e vendeve evropiane, po ashtu edhe SHBA-të, në legjislacionin e saj kanë paraparë rregullat e shkaktimit të dëmit jomaterial dhe shpërblimit të tij.

Ligji mbi prohibicionin (Probation Act) nga viti 1939, dispozitat mbi shpërblimin e dëmit i ka paraparë në mënyrë statutare. Në bazë të dispozitave në këtë ligj nuk ka qenë e ndaluar që të caktohet shpërblimi i dëmit me rastin e prohibicionit, mirëpo nuk ka qenë shprehimisht e parashikuar si kusht përmbushja e të cilit mund të kërkohej krahas vendimit (Menzies, K; Vass, A-A; 1989, 204-217). Burimi kryesor i të drejtës amerikane mbi shpërblimin e dëmit, e ashtquajtura Law of Tort është Common Law. Ajo është përmbledhje e disa rregullave mbi disa lloje të delikteve të cilat tërheqin përgjegjësinë për dëmin. Doktrina juridike amerikane dallon rastet e përgjegjësisë në të cilat kërkohej faji (fault liability) nga rastet në të cilat faji nuk nënkuptohet si supozim i përgjegjësisë (Strict liability). Supozimet për përgjegjësinë për pakujdesi nënkupton ekzistimin e obligimit për kujdes (duty to take care) dhe shkelja e detyrimit për kujdes,

respektivisht koncesioni që të realizohet standard juridik i posaçëm i kujdesit i cili është i paraparë me ligj. Standardi i listuar nënkupton kujdesin të cilin njeriu i arsyeshëm e tregon në situatën apo situatat e njëjta. Supozimin e përgjegjësisë e paraqet edhe dëmi si pasojë e shkeljes së standardit të kujdesit të duhur (duty of care). Veprimi me pakujdesi (negligence) si delikt ka substituar deliktet e tjera dhe ka fushë të gjerë zbatimi dhe është vështirë të ndahet nga përgjegjësia pa faj (Strict liability), si dhe aplikohet në dëmet nga tramvaji, hekurudha etj.

Përgjegjësia, pa marrë parasysh fajin, zbatohet për dëmin që kryen kafshët, përgjegjësia për veprimet e tjetrit, ndërsa praktika gjyqësore e ka zgjeruar edhe në rastet e përgjegjësisë nga veprimet e shumë sendeve, siç janë energjia elektrike, eksplozivi, zjarri, gasi, bora nga kulmi etj. Kodifikimi jozyrtar, por shumë autoritativ në SHBA nën emërtimin "*Restatement*" parasheh përgjegjësinë për aktivitete shumë të rrezikshme (Stanišić, S; 2013, 124-125).

E drejta anglosaksone e posaçërisht ajo amerikane, nuk përmban rregulla abstrakte mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, por mund të konkludohet se dëmi i tillë pranohet për cenim të nderit, për sulm në privatësi, për udhëheqje malicioze të ndonjë procesi dhe stresit emocional (Trifunović, P; 2004, 119-137). Praktika gjyqësore amerikane, njeh të drejtën për shpërblimin e dëmit jomaterial (Wagner, J-W; 1982, 117-127) për dhimbje shpirtërore, si pasojë e lëndimit trupor. Shumë shtete e pranojnë shpërblimin e dëmit për dhimbje shpirtërore edhe kur nuk ekziston lëndimi trupor. Ndërsa në disa shtete është pranuar edhe shpërblimi i dëmit jomaterial për lëndime trupore si rezultat i pakujdesisë i shkaktuar me frikë (Počuča, M; 2008, 34).

Sistemi në të cilin ekziston përgjegjësia primare dhe e drejtpërdrejtë e personit zyrtar shtetëror, respektivisht organit tjetër publik, i cili me veprimin e vet të jashtëligjshëm u shkakton dëm qytetarëve ose personave juridikë, ishte aplikuar gjatë në SHBA. Kongresi tek në vitin 1946 ka votuar Ligjin mbi përgjegjësinë deliktore (*Federal Tort Claims Act*), i cili rregullon këtë çështje (Popović, S; 1992, 1914-1925).

Pra, siç shihet, në SHBA, dëmi jomaterial nuk është vetëm dhimbja fizike dhe vuajtja mendore, por edhe llojet e tjera të dhimbjeve mendore (trauma mendore,

pakënaqësia për shkak të uljes së pritshmërive për jetën e shkaktuar nga lëndimi fizik, etj.), dëmtimi i nderit, reputacionit dhe dinjiteti i personit dhe të ngjashme, ku një nga format e dhimbjes mendore është edhe frika, me atë që, dëmi jomaterial emërtohet si humbje joekonomike (non-economic losses) ose dëm i përgjithshëm (general damages) dhe, kompensimet e dëmeve janë relativisht të ulëta dhe kryesisht përcaktohen në bazë të marrëveshjes së palëve të interesuara ku, për dhënien e dëmshpërblimit zbatohet një procedurë specifike harmonizuese, e cila drejtohet nga Instituti Amerikan për Drejtësi ku, mbledhen të dhëna nga gjykatat për çështje interesante dhe lëshohet një lloj Rideklarimi i Delikteve Ligjore, njëmbëdhjetë prej të cilave janë publikuar deri më tani dhe, ato përfshijnë disa raste karakteristike nga e drejta deliktore dhe komente lidhur me zbatimin e precedentëve dhe, qëllimi i publikimit të këtyre publikimeve është të paraqesë parimet e përgjithshme juridike të së drejtës amerikane (Mrvić, N; br.2/99, 49-51).

1.2. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË ANGLI

E drejta Angleze për shpërblimin e dëmit ka paraparë krijimin e rregullave mbi deliktin qytetar Tort of negligence. Definicionin e këtij delikti edhe gjykata angleze në precedentin Blyth v. Birmingham Waterworks Co, në vitin 1856, që thotë: “Negligence është lëshimi që të bëhet diçka që do të bënte njeriu i arsyeshëm ose të bëhet diçka që njeriu i arsyeshëm nuk do ta bënte” (Harvey, B; Marston, J; 2009, 46).

Pas kësaj e drejta e shpërblimit të dëmit ka përparuar me krijimin e rregullave të ashtuquajtura të përgjegjësisë strikte ose krahas praktikës gjyqësore. Terminologjia juridike angleze për përgjegjësinë objektive i shfrytëzon termat e përgjegjësisë së rreptë (strict liability) ose përgjegjësisë absolute (absolute liability). Në pjesën e dytë të shek. XIX në sistemin e Common Law, paraqitet përgjegjësia për delikt të pavarur-tort of nuisance. Ky delikt manifestohet në shqetësimin e veçantë të individit nga sfera personale dhe e pasurisë, ndërsa mbrojtja nga aktivitetet e dëmshme të listuara është

siguruar përmes padisë së veçantë - private nuisance. Me këtë padi është mbrojtur posedimi i paluajtshmërisë, e për t'u shpallur dikush përgjegjës për delikt-tort of private nuisance, i cili sjell gjer te përgjegjësia sipas parimit të objektivitetit. Megjithatë, praktika gjyqësore, në disa raste, është shmangur nga parimi i lartcekur duke proklamuar Tort of nuisance si dhe disa lloje specifike të shqetësimit, si kur pronari i një paluajtshmërie me vendosjen e disa pajisjeve në pronën e tij shqetëson fqinjët në shfrytëzim të qetë të paluajtshmërive të tyre (Stanišić, S; 2012, 115).

Ligdhënësi anglez, në mënyrë precize, ka bërë ndarjen e dëmit në dëm ekonomik nga joekonomik apo jomaterial, i njohur nën emërtimin dëmi i përgjithshëm. Dëmi jomaterial gjithnjë është vlerësuar në shumë unike. Në të drejtën Angleze kategoritë themelore të dëmit jomaterial janë: dhimbja e përjetuar, humbja e kënaqësisë, trauma shpirtërore dhe humbja për shkak të vdekjes. Përjetimi i dhimbjes dhe humbja e kënaqësisë paraqiten si pasojë e lëndimit personal trupor. Trauma shpirtërore mund të jetë e lidhur me lëndimin trupor dhe mund të reflektojë edhe në shpërblimin për dhimbje dhe vuajtje, si dhe humbjen e kënaqësisë, e nëse nuk është e lidhur me lëndim trupor duhet të kualifikohet si sëmurje, respektivisht si shok shpirtëror. I dëmtuari mund të marrë shpërblim edhe për traumë psikike të cilën e ka përjetuar në fatkeqësi, dhe me atë rast jeta dhe integriteti i tij kanë qenë në rrezik ose kur personi i afërt i tij ka qenë në rrezik, ka përjetuar fatkeqësi ose ka vdekur. Shuma fikse në të cilën kanë të drejtë është 12.500 euro. Kjo shumë është e caktuar me ligj dhe nuk është e nevojshme plotësimi i kurrfarë kërkesash tjera. Për sistemin anglez është karakteristikë që ka shkallë të lartë të standardizimit kur është në pyetje vlerësimi i dëmit. Qëndrimi i praktikës gjyqësore është se shpërblimi caktohet varësisht nga shkalla e lëndimit, por edhe nga specifika e secilit rast. Mjetet financiare të dëmtuarit dhe sjellja e tij nuk kanë kurrfarë ndikimi në shumën e caktuar të shpërblimit. Sa i përket shumës së shpërblimit, edhe pse duket se në Angli janë më të larta sesa në Evropë, në Angli mbizotëron qëndrimi se duhet ngritur shumat e shpërblimit, respektivisht se janë tepër të ulëta. Kështu që komisioni legjislativ në Angli i ka përkushtuar raport të tërë shpërblimit të dëmit jomaterial. Në këtë raport theksohet se

është e nevojshme të rishqyrtohen parimet dhe të verifikohen parimet që janë në fuqi, si dhe efikasiteti i shpërblimit aktual, si për dëmin material ashtu edhe dëmin jomaterial. Me këtë rast vëmendje të posaçme duhet kushtuar shpërblimit për dëmin i cili është shkaktuar me dhimbje shpirtërore, si dhe formave të tjera të shpërblimit të dëmit jomaterial (Pscheidl, D; 2006, 9-21).

Varësisht nga koha e shkaktimit të dëmit dallohet edhe afati për parashtrimin e padisë. Për dëmet që janë shkaktuar me vdekje të personit apo me lëndim trupor, afati është tri vite, e nëse ka ndodhur rasti i dëmit në sende, afati është gjashtë vite. Përjashtim bën rasti kur dëmi për të dëmtuarin paraqitet më vonë, që zakonisht ndodh tek shpërblimi i dëmit jomaterial si rezultat i lëndimit trupor ose vdekjes. Ky afat ndërpritet me deponimin e kërkesës kundër dëmtuesit me ç'rast nuk është me rëndësi se për të njëjtën çështje zhvillohet edhe procesi penal. Sipas dispozitës së par. 3, Law Reform Miscellaneous Provisions Act 1934, i dëmtuari krahas shpërblimit të dëmit si kërkesë kryesore, ka të drejtë edhe në kamatë, e cila pranohet që nga momenti i shkaktimit të dëmit gjer në shqiptimin e aktgjykimit (Počuča, M; 2008, 38).

Në Angli, më 1947, është aprovuar Crown Proceedings Act, i cili qytetarëve iu ka mundësuar që drejtpërdrejtë të deponojnë padi kundër shtetit në rast se personat zyrtarë shtetërorë iu shkaktojnë dëm. Format e përgjegjësisë personale të zyrtarëve për dëmin paraqesin element shumë të rëndësishëm, i cili siguron ligjshmëri dhe rregull në punën e administratës, sidomos në rastet e qëllimshme apo pakujdesisë së rëndë (Kavran, D; 1992, 1926-1933). Në të drejtën Angleze, respektivisht në Common Law, është paraparë edhe mundësia e shpërblimit në procedurën penale, ekskluzivisht në kuadër të vendimit gjyqësor mbi sanksionin penal (Bjelajac, Ž; Bingulac, N; 2016, 51-71). Po ashtu, viktimave të dhunës nga fondet e posaçme shteti u garanton të drejtën e shpërblimit edhe kur nuk është zënë kryerësi i veprës penale, respektivisht pavarësisht nga rrethanat se kundër tij, a është iniciuar procedura penale (Mrvić-Petrović, N; 2000, 52-83).

PJESA E TRETË

KAPITULLI VII

1. TË METAT DHE PËRPARËSITË E SISTEMIT JURIDIK NË KOSOVË NË LIDHJE ME SHPËRBLIMIN E DËMIT JOMATERIAL NË ASPEKTIN LEGJISLATIV DHE PRAKTIK

1.1. KORNIZA LIGJORE LIDHUR ME SHPËRBLIMIN E DËMIT JOMATERIAL NË KOSOVË

Sa i përket kornizës ligjore lidhur me shpërblimin e dëmit jomaterial, fillimisht duhet cekur se kjo çështje është e rregulluar me LMD e Republikës së Kosovës, ashtu që ky Ligj nga neni 182 deri 189 e rregullon çështjen e shpërblimit të dëmit jomaterial dhe realizimin e kësaj të drejte nëpërmjet mekanizmave ligjor.

Andaj, në vijim të këtij hulumtimi do të analizohen këto dispozita ligjore, me fokus në shpërblimin e dëmit jomaterial.

Neni 182- Shpallja e aktgjykimit ose ndreqja e gabimit

Sipas këtij neni “në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit, gjykata mund të urdhërojë shpalljen e aktgjykimit, përkatësisht të përmirësimit me shpenzim të dëmtuesit, ose të urdhërojë që dëmtuesi ta tërheqë deklaratën me të cilën është bërë shkelja, ose diçka tjetër me të cilën gjë mund të realizohet qëllimi që arrihet me shpërblim” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 182).

Neni 182 i LMD-së, parasheh “dëmin jomaterial të shkaktuar me cenimin e të drejtës së personalitetit, që nënkupton një lloj të veçantë të dëmit; andaj, se çfarë përfaqëson cenimi i së drejtës së personalitetit dhe si do të cenohet ai, ky ligj nuk e përcakton, pasi që fjala është për të mira personale të cilat janë të shumta dhe mënyra e cenimit mund të jetë e ndryshme dhe, përpos tjerash edhe në rastet më të shpeshta, cenimi i së drejtës së personalitetit të një personi mund të bëhet për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, integritetit trupor dhe personal, të drejtës për jetë, shëndetit, privatësisë dhe të mirave të tjera jomateriale të garantuara me ligj, të gjitha këto kur bëhet fjalë për personin fizik” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 182). Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, potencohet që, “cenimi i këtyre të drejtave zakonisht bëhet me fyerje apo me shpifje dhe, forma e shpërblimit të dëmit jomaterial për shkak të cenimit të drejtave të personalitetit bëhet me pagesën e shumës së caktuar si satisfaksion për këtë lloj të dëmit dhe, duke u nisur nga fakti se edhe riparimi i dëmit jomaterial mund të bëhet jo vetëm me pagesën e shumës së caktuar të të hollave, me këtë dispozitë ligjore tentohet të arrihet qëllimi përfundimtar i shpërblimit të dëmit të shkaktuar në këtë mënyrë dhe ky është kthimi i gjendjes së mëparshme”(Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 250). Në këtë Komenar të LMD-së, theksohet se nëse “i dëmtuari, për shkak të cenimit të së drejtës së personalitetit (nderit, prestigjit, lirisë dhe të drejtave të tjera të personalitetit), ka pësuar dhimbje shpirtërore, gjykata mund, përpos sanksionit të parashikuar nga neni 199 - LMD/1978 (sipas LMD/12 neni 183), të gjykojë edhe shpërblimin real në qoftë se, për shkak të rrethanave të rastit, vetëm në atë mënyrë mund t’i jepet të dëmtuarit një satisfaksion i plotë, në harmoni me qëllimin të cilit i shërben shpërblimi i dëmit jomaterial” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 250).

Neni 183-Shpërblimi në të holla

Sipas këtij neni të LMD-së, “për dhembjet e pësura fizike, për dhembjet e pësura shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material; me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të, të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 183).

Po ky nen, rregullon çështjen “e shpërblimit të dëmit jomaterial për dhimbjet e pësura fizike, për dhimbjet e pësura shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit dhe të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 251-252). Sipas qëndrimit juridik të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese të ish Federatës Jugosllave “dëmi jomaterial i pësuar për shkak të dhimbjeve fizike, dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktiviteteve jetësore, shëmtimit, cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekjes së të afërmit dhe frikës, nuk mund të riparohet me rivendosje të gjendjes që ka ekzistuar para se të shkaktohej dëmi, siç veprohet, si rregull, me dëmin material” (Qëndrim juridik i marrë në këshillimin me përfaqësuesit e Gjyk. Fed., Gjyk. Supr. të rep. dhe të kr. dhe Gjyk. Usht. të ish- Fed. Jug., dt. 15-16 tetor 1986). Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, “i dëmtuari, pavarësisht nëse është person fizik apo juridik, ka të drejtën e riparimit të dëmit jomaterial të shkaktuar me cenimin e integritetit moral, kur kjo është e mundur, por ka edhe të drejtën e shpërblimit të drejtë të dëmit që shfaqet në formë të dhimbjeve fizike dhe

shpirtërore si dhe me rastin e cenimit të ndjenjave të të dëmtuarit, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material, nëse ka ekzistuar, e kjo e drejtë ekziston edhe në rastet kur nuk ka dëm material” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 252).

Po sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, “në anën tjetër, edhe në rastet kur i dëmtuari për shkak të cenimit të të drejtave personale (nderit, prestigjit, lirisë ose të drejtave të tjera personale) ka përjetuar dhimbje shpirtërore, gjykata, përpos sanksionit të parashikuar nga neni 182 i këtij Ligji, mund ta gjykojë edhe shpërblimin e drejtë, në qoftë se, varësisht nga rrethanat e rastit, vetëm në këtë mënyrë mund t’i jepet të dëmtuarit një satisfaksion i plotë në kuptim të qëllimit të cilit i shërben shpërblimi i dëmit jomaterial” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 252). Po sipas këtij Komentari, “kjo do të ndodhë në rast të cenimit të integritetit trupor të të dëmtuarit apo të dëmtimit të shëndetit të tij, me të cilin rast dhe për të cilën arsye edhe shkaktohen dhimbjet fizike, dhimbjet shpirtërore dhe frika; nëse do të caktohet shpërblimi apo jo varet nga intensiteti dhe kohëzgjatja e këtyre dhimbjeve për çdo rast konkret ku, shpërblimi i dëmit jomaterial për dhimbjet fizike dhe psikike të përjetuara duhet t’i sigurojë të dëmtuarit përfitimin e të mirave dhe satisfaksioneve të tjera të cilat do t’i ndihmonin në tejkalimin e krizës fizike dhe psikike ose të frikës së përjetuar si pasojë e dëmit të shkaktuar, gjë që nënkupton se shpërblimin në të holla nuk duhet kuptuar si ekuivalent i së mirës së humbur apo të dëmtuar, por vetëm si një satisfaksion” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 252).

Në paragrafin e parë të nenit 183 “parashikohen format e mundshme të dëmit jomaterial për të cilat i dëmtuari mund të kërkojë shpërblimin e dëmit jomaterial në të holla, ku këtu parashihet edhe shpërblimi për shkak të dhimbjeve fizike, për të cilat gjykata mundet, në rast se plotësohen kushtet e parashikuara me ligj, të caktojë shpërblimin e drejtë si satisfaksion dhe, një nga të drejtat e shumta personale është edhe e drejta e personit fizik për integritetin dhe shëndetin trupor ku, përkitazi me intensitetin e dhimbjeve fizike, ato karakterizohen nga: a) intensiteti i lartë, b) i mesëm dhe c) i dobët dhe, varësisht nga shkalla e intensitetit dhe kohëzgjatja e tij, duhet caktuar edhe shuma e shpërblimit për çdo lloj të dhimbjeve të sipërpërmendura ku

shuma e shpërblimit për dhimbjet fizike të pësuar nuk varet vetëm nga shkalla e intensitetit dhe kohëzgjatja e tyre, siç janë përcaktuar me ligj (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 183 para 1). Andaj, duhet cekur se lidhur me këtë gjë, disa ligje për marrëdhëniet e detyrimeve të shteteve tjera, siç është p.sh., LMD i Serbisë, parasheh se “përveç këtyre dy elementeve me rëndësi, në caktimin e shumës së shpërblimit të dëmit duhen marrë parasysh edhe të gjitha rrethanat e tjera të rastit, veçanërisht përjetimet e ndryshme të pakëndshme dhe komplikimet e mundshme gjatë mjekimit”(Kom. ZOO I (Zakona o Obligacionim Odnosima) Beograd, 1980, 536).sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, “caktimin e shpërblimit të drejtë për dhimbjet fizike të pësuar, ligjvënësi e ka kushtëzuar, në radhë të parë, me arsyetimin e tij, veçanërisht nga intensiteti dhe kohëzgjatja e tyre dhe, cilat janë të gjitha rrethanat e tjera, varet nga çdo rast konkret andaj, në këtë mënyrë, për dhimbje fizike të parëndësishme nuk do të caktohet shpërblimi me atë që, cilat dhimbje fizike janë të parëndësishme dhe në cilat raste i dëmtuari nuk do të ketë të drejtën e shpërblimit, duke pasur parasysh intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, sipas praktikës gjyqësore, konkludohet në rast se i dëmtuari nuk ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit të lartë, ndërsa ato të intensitetit të mesëm dhe të ulët kanë zgjatur vetëm disa ditë, përjashtimisht, i dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial për dhimbjet fizike të shkaktuara me lëndim të lehtë trupor, vetëm nëse ato janë të intensitetit të lartë dhe të mesëm dhe kanë zgjatur për një kohë më të gjatë;Përpos dhimbjeve fizike, në para 1 të këtij neni janë përcaktuar një për një llojet e dhimbjeve shpirtërore, për të cilat të dëmtuarit i takon e drejta e shpërblimit të drejtë, nëse plotësohen edhe kushtet e tjera ligjore ku, zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor i të dëmtuarit përfshin të gjitha kufizimet e aktiviteteve jetësore, të cilat i ka realizuar ose të cilat, sipas rrjedhës së rregullt të gjërave, edhe në të ardhmen sigurisht do t’i realizonte” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 253).

Sipas Stanković, “kjo gjë nënkupton situatën kur, si pasojë e lëndimit, janë dëmtuar apo janë dobësuar pjesë të organizmit të njeriut, ashtu që i dëmtuari nuk mund të kryejë normalisht aktivitetin e plotë jetësor, manifestimet jetësore të

organizmit janë zvogëluar në krahasim me gjendjen para shkaktimit të lëndimit. Zvogëlimi i aktivitetit jetësor mund të shkaktohet qoftë nga lëndimi trupor, qoftë nga sëmundja psikike dhe, në këto raste i dëmtuari përjeton dhimbje shpirtërore për shkak se është bërë i paaftë për punë ose aftësia për punë i është zvogëluar, i ka humbur tërësisht ose i është zvogëluar mundësia për t'i ushtruar aktivitetet e ndryshme dhe, përveç për shkak të dhimbjeve fizike, LMD i Kosovës, i jep të drejtë të dëmtuarit që të kërkojë shpërblim për dhimbjet shpirtërore të përjetuara me rastin e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për shkak të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit ku, i dëmtuari ka të drejtë në shpërblim të drejtë, jo vetëm kur zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është i përhershëm, por edhe nëse është me karakter të përkohshëm, por që ka zgjatur për një kohë më të gjatë, nëse rrethanat e veçanta e arsyetojnë këtë gjë” (Stanković, O., 1972, 7). Sipas njëqëndrimi juridik nga këshillimi me kryetarët e Gjyk. Fed., Gjyk. supr. të rep. dhe të kr. dhe të Gjyk. Usht.: “Si rrethana të veçanta konsiderohen: shkalla e invaliditetit, intensiteti, kohëzgjatja e pasojave, mosha, profesioni i të dëmtuarit etj, që nënkupton se, si rregull, shpërblimi për këtë lloj të dëmit caktohet vetëm nëse zvogëlimi i aktivitetit jetësor është me karakter të përhershëm por, nëse i dëmtuari, nga kjo formë e shkaktimit të dëmit, nuk ka mundur ta fillojë ose e ka ndërprerë shkollimin - aftësimin profesional në ndonjë mënyrë tjetër, ai ka të drejtën e shpërblimit, përpos për dëmin material, edhe për dëmin jomaterial me atë që, ndërprerja e shkollimit, përveç se është bazë për shpërblimin e dëmit material, mund të merret parasysh edhe si bazë për shpërblimin e dëmit jomaterial për dhimbjet shpirtërore, në kuadër të shpërblimit për zvogëlimin e aktivitetit jetësor, ashtu që ai nuk përfaqëson një lloj të veçantë dhe më vete të dëmit jomaterial” (Qëndrim juridik nga këshillimi me kryetarët e Gjyk. Fed., gjyk. supr. të rep. dhe të kr. dhe të Gjyk. Usht., dt. 15 dhe 16 tetor 1986).

Po sipas këtij qëndrimi juridik “në rast shëmtimi, i dëmtuari përjeton dhimbje shpirtërore, për të cilat me nenin 183 parashikohet shpërblimi i drejtë në të holla ku, për caktimin e shkallës së shëmtimit, gjykata duhet të shfrytëzojë ndihmën e ekspertit mjekoligjor dhe, përpos faktorëve të tjerë, përcaktimi i shkallës së shëmtimit varet nga

pjesa ku është dëmtuar organizmi, përkatësisht sa është e dukshme për të tjerët dhe, në rastet kur të dëmtuarit i shkaktohet dëm jomaterial (prestigjit, nderit, autoritetit, lirisë dhe të drejtave të tjera personale), përjeton dhimbje shpirtërore, gjykata, përpos sanksionit të parashikuar nga neni 182 të LMD-së, mund t'i caktojë atij edhe shpërblimin e drejtë, në qoftë se për shkak të rrethanave të rastit, atëherë mund t'i jepet satisfaksioni i plotë e në harmoni me qëllimin të cilit i shërben shpërblimi i dëmit jomaterial, dhe në këtë drejtim, frika sipas ligjit, paraqet një formë të veçantë të dëmit jomaterial, për të cilën gjykata e cakton shpërblimin e drejtë; ajo është shprehje e gjendjes shpirtërore të personit fizik që shprehet në trajta të ndryshme, ashtu që një person mund të përjetojë frikë të madhe ndërsa një tjetër më të vogël dhe, shpërblimi në të holla mund të caktohet për frikën e cila ka qenë intensive dhe ka zgjatur më shumë kohë, por, nëse frika intensive ka zgjatur shkurt, shpërblimi mund të caktohet, nëse baraspesha psikike e të dëmtuarit ka qenë e dëmtuar për një kohë më të gjatë, me atë që, këto elemente të frikës duhen vërtetuar me ndihmën e ekspertit, ku konform mendimeve të ekspertëve lidhur me frikën e pësuar, ajo kategorizohet në frikë: primare dhe sekondare ku, frika primare ekziston në momentin e paraqitjes së rastit të dëmshëm dhe është e lidhur për të, ndërsa ajo sekondare zgjatë për shumë kohë dhe është shprehje e rastit dëmtues dhe, përkitazi me peshën e frikës së pësuar, ekspertët mjekoligjorë atë e kategorizojnë si frikë të intensitetit të lartë, të mesëm ose të dobët” (Qëndrim juridik nga këshillimi me kryetarët e Gjyk. Fed., gjyk. supr. të rep. dhe të kr. dhe të Gjyk. Usht., dt. 15 dhe 16 tetor 1986).

Sipas Revizionit të Gjykatës Supreme të Kosovës, “në para 2 të nenit 183 të LMD-së janë parashikuar arsyet dhe kushtet për caktimin e shpërblimit të dëmit jomaterial dhe shumës së tij ku me shpërblimin në të holla nuk mund të mënjanohet cenimi i ndjenjave, dhimbjeve fizike, dhimbjeve shpirtërore të çfarëdo lloji qofshin ato, prandaj shpërblimi i drejtë në të holla përfaqëson vetëm një satisfaksion për të dëmtuarin dhe, kjo formë e shpërblimit të dëmit jomaterial, nuk ka për qëllim zhdëmtimin, meqë ai është mjet me të cilin i dëmtuari, duke kënaqur nevojat të cilat nuk do të mund t'i plotësonte, ia lehtëson vetes jetën dhe, duke e bërë atë të

durueshme, lehtëson dhimbjet shpirtërore që i përjeton” (Gjykata Supreme e Kosovës, Rev. nr. 133/2008 dt. 05.11.2008). “Edhe dëmi jomaterial, edhe shpërblimi i atij dëmi për të dëmtuarin janë përjetim, por dëmi është përjetim i pakëndshëm, ndërsa shpërblimi paraqet përjetim të këndshëm” (Gjykata Supreme e Kosovës, Rev. nr. 133/2008 dt. 05.11.2010).

Sipas Revizionit të Gjykatës Supreme të Serbisë “dëmet e shkaktuara nga autopërgjegjësia, kompanitë e sigurimit zakonisht tentojnë t’i përcaktojnë shumat rreth të cilave do të silleshin lartësitë e shpërblimit për çdo lloj të dëmit jomaterial, duke hartuar tabela të ndryshme me insistimin që gjykatat t’u përmbahen shumave të përcaktuara në ato tabela ku, në caktimin e shumës së shpërblimit ndikojnë shumë faktorë dhe rrethana, të cilat duhet të vlerësohen nga gjykata për çdo rast konkret, prandaj është e pamundur që kjo të caktohet paraprakisht meqë çfarëdo tabele e kompanive të sigurimit lidhur me shumën e shpërblimit për disa lloje të ndryshme të dëmit jomaterial nuk e obligon gjykatën me rastin e vendosjes në konteste të këtilla” (Gjykata Supreme e Serbisë, Rev. 4518/94 dt. 21.09.1994).

Neni 184-Personat që kanë të drejtë shpërblimi në të holla në rast vdekjeje ose invaliditeti të rëndë

Sipas këtij neni të LMD së Kosovës, “në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t’ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore; ky shpërblim mund t’u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme; në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, gjykata mund t’u caktojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblim të drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore; shpërblimi nga para 1 dhe 3 i këtij neni mund t’i caktohet edhe bashkëshortit jashtë martesor në qoftë se ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 184).

Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, “neni 184 i LMD-së, parasheh mundësinë e shpërblimit të dëmit jomaterial në të holla për shkak të cenimit të ndjenjave në rastet kur pala e dëmtuar paraqitet i afërm i personit, vdekja e të cilit është shkaktuar me dëmtim të integritetit trupor” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 253). Po sipas këtij Komentari “me këtë dispozitë ligjore shprehimisht përcaktohen personat e afërt me të vdekurin, përkatësisht të lënduarin rëndë, të cilëve u njihet e drejta për shpërblim në të holla ku ligjvënësi paraprakisht këtë të drejtë ua cakton anëtarëve të familjes së ngushtë e pastaj ata i përcakton një për një, duke i kufizuar të bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit dhe, ekziston mundësia që kjo e drejtë t’i pranohet edhe ndonjërit anëtarë tjetër të familjes, siç është rasti i gjyshërve dhe nipave e mbesave, thjeshtit dhe njerikut apo njerkës, siç edhe veprohet në praktikën gjyqësore gjë që paraqitet nëse ndërmjet personit të dëmtuar dhe atij të vdekur apo të afërmit të lënduar rëndë ka ekzistuar një bashkësi e përhershme e jetës e cila, për nga përmbajtja dhe faktikisht, ka qenë e njëjtë me shkallën e marrëdhënieve familjare, sipas së cilës i dëmtuari me ligj gëzon të drejtën e shpërblimit mbi këtë bazë juridike, kështu që, në rast të vdekjes së bashkëshortit, bashkëshorti tjetër e ka të drejtën e shpërblimit në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore për humbjen tij” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 257-258).

Sipas Revizionit të Gjykatës Supreme të Serbisë “Fëmijët e kanë të drejtën e këtij shpërblimi, për shkak të dhimbjeve shpirtërore që përjetojnë dhe do të përjetojnë në të ardhmen për humbjen e prindërve; për t’u pranuar kjo e drejtë nuk është me rëndësi moshë e fëmijës, mirëpo me rastin e vendosjes për shumën e shpërblimit, ajo është me ndikim ndërkaq, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për humbjen e prindit, personave të moshës së re, si rregull, do të duhej pranuar një shpërblim më i lartë” (Gjykata Supreme e Serbisë, Rev. nr. 2606/99 dt. 6.10.1999). Sipas një Qëndrimi juridik “Shpërblimi për këtë lloj të dëmit i takon edhe fëmijës së lindur pas vdekjes së prindit dhe, normalisht, edhe fëmijës së sapolindur, pas vdekjes së prindit i takon shpërblimi i dëmit jomaterial për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për humbjen e të afërmit, pasi që edhe ai do të përjetojë dhimbje me zhvillimin e vetëdijes dhe me pjekurinë

shpirtërore” (Qëndrim juridik nga këshillimi i kryetarët e Gjyk. Fed., gjyk. supr. të rep. dhe të kr. dhe të Gjyk. Usht, mbajtur më 15 dhe 16 tetor 1986).

Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, “në para 2 të nenit 184 të LMD-së parashihet se e drejta për shpërblim të drejtë në të holla, për shkak të humbjes së të afërmit, u njihet edhe vëllezërve dhe motrave ku, LMD ka paraparë se në mënyrë që t’u njihet kjo e drejtë ndërmjet tyre dhe personit të vdekur duhet të ketë ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 258). Sipas Revizionit të Gjykatës Supreme të Serbisë “në mënyrë që të njihet kjo e drejtë, në momentin e vdekjes duhet të ketë ekzistuar bashkësia e jetës e përhershme dhe mbi bazën e lidhjeve emocionale, ekonomike dhe ekzistenciale ndërmjet të dëmtuarit dhe të vdekurit, prandaj edhe me shumën e caktuar, paditësi do të mundë të përjetonte një satisfaksion për dhimbjet shpirtërore të shkaktuara nga vdekja e personit të afërt, vëllait të tij” (Gjykata Supreme e Vojvodinës, Rev. nr. 176/87). Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, “me invaliditet tejet të rëndë dhe shëmtim në shkallë të lartë, duhet nënkuptuar gjendjen shëndetësore të të lënduarit, e cila çon në ndryshime të theksuara edhe në mënyrën e sjelljes dhe jetës së tij” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 258). Sipas Revizionit të Gjykatës Supreme të Kosovës, “edhe në këtë rast, me ligj janë përcaktuar personat të cilët kanë të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla, ashtu që kjo e drejtë u është njohur vetëm bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve dhe kjo vetëm në rast të invaliditetit, posaçërisht, të rëndë ose për shkak të shëmtimit në shkallë të lartë, ekzistimi i të cilave rrethana te këta ka shkaktuar vuajtje shpirtërore të veçanta” (Gjykata Supreme e Kosovës, Rev. 196 /2008 dt. 15.11.2010). Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, “në kushtet e përcaktuara ligjore, në raste të veçanta, e drejta e shpërblimit të drejtë në të holla, në rast vdekjeje, u është pranuar edhe të afërmeve të tjerë, si: vëllezërve, motrave, gjyshërve, gjysheve, nipave dhe mbesave, thjeshtit dhe njerikut/kës; andaj, konsiderohet se nuk ekzistojnë arsye e as pengesa ligjore që këtë të drejtë që mos ta kenë këta persona edhe në rast invaliditeti tejet të rëndë ose shëmtimit të lartë (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 258).

Para 4 i nenit 184 të LMD-së, nëse i referohemi edhe ligjeve tjera në marrëdhëniet e detyrimeve, sipas Crnić, parasheh se “si edhe për të afërmit e tjerë edhe për bashkëshortin jashtëmartesor, për t’u njohur e drejta në shpërblim të drejtë në të holla, duhet medoemos të ketë ekzistuar bashkësia e jetës para shkaktimit të dëmit dhe, në këto raste gjykata është e autorizuar të vendosë në bazë të njohurisë dhe përvojës që ka, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat, në bazë të logjikës, çojnë në përfundimin nëse i dëmtuari ka pësuar ose jo dhe nëse do të pësojë në të ardhmen dhimbje shpirtërore” (Cernić, I; 2012, 1510).

Neni 185- Shpërblimi në të holla në raste të veçanta (Cenimi i dinjitetit)

Sipas këtij neni të LMD-së, “e drejta e shpërblimit të dëmit në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësura i takon personit, i cili me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimit ose varësie, është shtytur në marrëdhënie të dënueshme seksuale ose në veprim të dënueshëm seksual të panatyrshëm, si dhe personi ndaj të cilit është kryer ndonjë vepër tjetër penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 185).

Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, potencohet që, “me rastin e cenimit të dinjitetit personal dhe moralit, dëmi i shkaktuar nuk mund të riparohet duke u kthyer gjendja që ka ekzistuar para shkaktimit të tij, siç mund të bëhet në rast të cenimit të integritetit personal me shpifje dhe ofendim, edhe për këtë lloj të veçantë të dëmit është parashikuar e drejta e shpërblimit të drejtë në të holla” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 260).

Po sipas këtij Komentari të LMD, potencohet që neni 185 i LMD-së i parashikon “rastet e veçanta të cenimit të dinjitetit të personit, mirëpo, dhënia e pëlqimit të personit të dëmtuar për këto veprime të dëmshme dhe ofenduese e përjashton përgjegjësinë për dëmshpërblimin për veprat ku dhuna, mashtrimi, shpërdorimi i ndonjë raporti të nënshtrimit apo varësisë, nuk janë elemente të veprës penale, pra, për tacaktuar shpërblimin e drejtë në të holla për këto raste, paraprakisht duhet të jetë kryer vepra penale kundër dinjitetit të personit dhe moralit dhe nga kjo i dëmtuari të ketë pësuar dhimbje shpirtërore në shkallë dhe kohëzgjatje të caktuar,

andaj, për të pasur të drejtën e shpërblimit duhen plotësuar këto kushte: a) të ekzistojë marrëdhënia e dënueshme seksuale ose veprimi i dënueshëm seksual i panatyrshëm apo ndonjë vepër tjetër penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit; b) që vepra të jetë kryer me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimi ose varësie dhe c) i dëmtuari të ketë pësuar nga kjo dhimbje shpirtërore në shkallë dhe kohëzgjatje të caktuar” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 260-261).

Neni 186- Shpërblimi i dëmit të ardhshëm

Sipas këtij neni “Gjykata, me kërkesën e të dëmtuarit, do të caktojë shpërblimin edhe për dëmin e ardhshëm jomaterial në qoftë se sipas rrjedhës së rregullt është e sigurtë se ai do të vazhdojë edhe në të ardhmen” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 186).

Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, potencohet që, “shpërblimi i drejtë i dëmit jomaterial në të holla ndryshon nga shpërblimi i dëmit material dhe shpërblimi për dëmtime trupore; Kur bëhet fjalë për shpërblimin e dëmit material ose shpërblimin për dëmtime trupore, ky lloj dëmshpërblimi mund të ndryshojë për nga vëllimi, ashtu që, për shkak të paraqitjes së rrethanave që nuk kanë ekzistuar në momentin e caktimit të tij, ai mund të rritet ose të zvogëlohet” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 260-261).

Sipas Crnić, “fëmija, për shkak të moshës që ka, në momentin e vdekjes së prindit, nuk mund të përjetojë dhimbje shpirtërore për shkak të vdekjes së prindit, mirëpo gjatë rritjes dhe zhvillimit atij do t’i mungojë dashuria, përkujdesja, mbrojtja, edukimi etj. nga prindi, të cilat do t’ia ofronte sikur të mos e kishte humbur jetën dhe, në këtë aspekt, me nenin 186 të LMD-së është parashikuar edhe dëmi jomaterial i ardhshëm ku konform kësaj dispozite ligjore, me kërkesë të të dëmtuarit, gjykata do ta caktojë shpërblimin edhe për dëmin e ardhshëm jomaterial dhe, për dëmin e ardhshëm bëhet fjalë në rastet kur, me rastin e vendosjes, shkakua ka ekzistuar, por pasojat e

dëmit ende nuk kanë vepruar, por është evidente se i dëmtuari do t'i përjetojë ato në të ardhmen“(Cernić, I; 2012, 1530). Sipas konkluzionit të Gjykatës Supreme, “shpërblimi i dëmit të ardhshëm jomaterial, shprehet në tri mënyra: a) dëm i ardhshëm i pavarur, b) dëm i ardhshëm në kontinuitet dhe c) dëm i ardhshëm eventual” (Konkluzioni nr. 3 nga Seanca e III e Degës Civile të Gjykata Supreme të Kr. dt. 30.03.1987).

Sipas Alishanit, “duke pasur parasysh faktin se dëmi jomaterial zakonisht caktohet me një shumë të përgjithshme të vetme, rrethanat e ndryshuara në masë të konsiderueshme mund të jenë me ndikim për ndryshimin e shumës së rentës së caktuar në emër të dëmit jomaterial, njëlloj si te mundësia e ndryshimit të shumës së rentës së caktuar në emër të shpërblimit të dëmit material” (Alishani, A., 1989, 767).

Neni 187- Shpërblimi në të holla për personin juridik

Sipas këtij neni “gjykata i jep shpërblim të drejtë në të holla personit juridik për denigrim të reputacionit ose emrit të mirë, pavarësisht dëmshpërblimit të dëmit material, në rast se gjen se rrethanat e arsyetojnë këtë gjë, qoftë edhe nëse nuk ka dëm material” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 187).

Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, potencohet që, “LMD, me dispozitë të veçantë ligjore parasheh edhe shpërblimin në të holla të dëmit jomaterial shkaktuar personit juridik dhe, nga kjo rrjedh se, përpos dëmit material, personit juridik mund t'i shkaktohet edhe dëmi jomaterial ku zakonisht ndodh që për shkak të dëmtimit të reputacionit ose emrit të mirë, t'i shkaktohet dëm material personit juridik, mirëpo pavarësisht nga dëmi material, në rast të denigrimit të reputacionit ose emrit, personit juridik i njihet edhe e drejta në shpërblimin e drejtë në të holla të dëmit jomaterial dhe, në këtë aspekt, në rastet e tilla i mbetet gjykatës të konstatojë gjendjen ekzistuese të reputacionit dhe emrit që e ka pasur personi juridik para faktit dëmtues, cili ka qenë veprimi apo mosveprimi që ka mundur të ketë ndikim në uljen e reputacionit dhe emrit të mirë dhe nëse ka ndodhur denigrimi i reputacionit ose emrit të mirë të të dëmtuarit por, duhet theksuar që, pavarësisht nëse ka apo jo

dëm material dhe nëse është shpërblyer apo jo ai, gjykata mund ta caktojë shpërblimin në të holla, varësisht nga shkalla dhe pasojat e shkaktuara për të dëmtuarin” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 262).

Neni 188- Trashëgimi dhe cedimi i kërkesës së shpërblimit të dëmit jomaterial

Sipas këtij neni “kërkesa e shpërblimit të dëmit jomaterial i kalon trashëgimtarit vetëm në qoftë se është caktuar me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim; nën kushte të njëjta kjo kërkesë mund të jetë objekt cedimi, kompensimi dhe i përmbarimit të dhunshëm” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 188).

Sipas Komentarit të LMD-së, nga Dauti, Aliu, Berisha dhe Vokshi, ky nen i LMD-së, zbatohet “në rast tëcenimit të ndjenjave personale ku në raste të tilla të drejtën e shpërblimit e ka vetëm personi ndjenjat e të cilit janë cenuar dhe konform, nenit 188 të LMD-së, si rregull, kjo e drejtë nuk bartet, pasi nuk ka bazë juridike për bartjen e saj dhe nuk trashëgohet, ngaqë është e lidhur për personin, ashtu që me vdekjen e të dëmtuarit, shuhet edhe ajo e drejtë dhe, nëse për shpërblimin e dëmit jomaterial është vendosur me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje ndërmjet të dëmtuarit dhe personit përgjegjës, shuma e caktuar për shpërblimin e dëmit kalon në pasurinë e të dëmtuarit, prandaj shpërblimi humb elementet e së drejtës personale dhe mund të bartet te tjetri me çrast, shprehja: nën kushtet e njëjta, nënkupton se vetëm një shumë e caktuar në emër të shpërblimit të drejtë për dëmin jomaterial, me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje mund të jetë objekt cedimi, objekt shpërblimi dhe përmbarimi të dhunshëm” (Dauti, N; Aliu, A; Berisha, R; Vokshi, A; 2013, 262). Sipas Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës, “duke pasur parasysh sesi shpërblimi për dëmin material, ashtu edhe shpërblimi i drejtë për dëmin jomaterial përfaqësojnë të drejta personale, prandaj e gjithë ajo që është thënë për mosbartjen e të drejtës së shpërblimit në formë të rentës për dëmin material, vlen edhe për dëmin jomaterial” (Udhëzues nr.41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës).

Neni 189- Përgjegjësia e ndarë dhe zvogëlimi i shpërblimit

Sipas këtij neni “dispozitat për përgjegjësinë e ndarë dhe për zvogëlimin e shpërblimit që vlejné për dëmin material përshtatshëmrisht zbatohen edhe për dëmin jomaterial” (LMDRK, Nr.04/L-077, 2012, neni 189). Gjykata Supreme e Kosovës, me datën 27.02.2023 ka nxjerrë “Udhëzues për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jomaterial me çrast, këto kriterë orientuese duhet të mundësojnë zbatimin uniform të neneve 183-185 të Ligjit nr 04/L-077, për Marrëdhëniet Detyrimevetë Republikës së Kosovës” (Udhëzues nr.41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës).

Një nga detyrat më sfiduese në hartimin e këtij Udhëzuesi ishte gjetja e një mënyre për të harmonizuar vendosjen e lartësisë, për shpërblimin e dëmit jomaterial, dhe atë me qëllim që gjykatat t’i trajtojnë të gjitha rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial në mënyrë unike. Në vijim është paraqitur një elaborat i përcaktimit të shumave të shpërblimit të dëmit jomaterial, për të gjitha format e dëmit jomaterial, duke caktuar kriteret orientuese, me qëllim që të sigurohet trajtim unik i këtyre rasteve, në kushtet dhe rrethanat e njëjta.

Juridiksi i Gjykatës Supreme të Kosovës, që të nxjerrë udhëzues juridik në rastet kur vërehet praktikë jo unike e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta, apo sipas datës së zbatimit dhe interpretimit të dispozitave ligjore, përcaktohet me Ligjin për gjykatat. Me nenin 27 të këtij ligji, përcaktohet se seanca e përgjithshme të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës ka atë drejtë të nxjerrë një qëndrim të parimor, mendimeve juridike dhe udhëzuesve që promovojnë zbatimin unik të ligjeve, ndërsa nevojat e adresimit të kësaj çështjeje përmes një udhëzuesi juridik ka rrjedhur si propozim dhe konkludim i kësaj gjykate, pas shqyrtimit, analizës dhe vlerësimit të vendimeve gjyqësore për çështjetë tilla si në rastin konkret, është vlerësuar e nevojshme nxjerrja e këtij udhëzuesi juridik.

Sipas përcaktimit të kriterëve orientues sipas këtij udhëzuesi, kështu bëhet praktika e gjykatave të shtetve të rajonit, si dhe element kryesor është marrë standardi i jetës në Kosovë.

Kriteret orientuese nuk përfaqësojnë një formulë që shërben automatikisht për të llogaritur njëshpërblimtëdrejtëmonetar. Në zbatimine ligjittë sipërpërmendur, duhet pasur parasysh gjithmonë të gjitha rrethanat e çështjes, ku janë veçanërisht të rëndësishme natyra dhe pasojat elëndimeve, kohëzgjatja dhe intensiteti i dhimbjes fizike, frikës, për dhimbjet e pësura shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shëmtimit, vdekjes së personit të afërt, por jo të vetmetrrethana që gjykata duhet t'i ketë parasysh me rastin e përcaktimit të masës së shpërblimit të drejtëmonetar, përformatedëmitj material. Këto kriterë zbatohen në të gjitha kontestet civile për shpërblimin e dëmitj material në të gjitha fazat e gjyqimit.

Krahas këtyre kriterëve orientuese për formën të caktuar të dëmitj material, rikujtohen edhe qëndrimet e mëparshme juridike të praktikës gjyqësore. Kjo me qëllim që të marrim parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, që gjykata duhet t'i vlerësojë me rastin e vendosjes duke iu referuar zbatimit të nenit 183 të LMD-së.

Dhimbjet fizike-janë ato të cilat paraqiten te personat e lënduar në momentin e lëndimit dhe vazhdojnë deri në ditën kur ato ndërpriten, e më së largu deri në përfundimin e mjekimit dheshërimit (Udhëzues nr. 41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës).

Kriteret të cilat shërbejnë për përcaktimin e lartësisë së shpërblimit (satisfaksioni) të dëmitj material në emërtëdhimbjeve fizike janë:

Ky lloj i lëndimeve paraqet fakt me rëndësi për caktimin e lartësisë së dëmit, pasi prej llojit të lëndimit varet edhe lartësia e shumës së gjykatës në emërtëdhimbjeve fizike. Varësisht prej llojit të lëndimit varet edhe intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve. Te lëndimet e lehta, intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve zakonisht janë më të lehta dhe më të shkurtra. Te lëndimet e rëndë intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve është më e rëndë dhe zgjat më shumë kohë; po ashtu këto lëndime janë edhe pasojat jetësore, të cilat duhet të merren për bazë, merastine vlerësimi të lartësisë së shumës së gjykuar në emër të kompensimit të kësaj kategorie shpërblyese të dëmitj material.

- **Vendi i lënduar në trupin e njeriut**, në praktikë nuk i është kushtuar vëmendje e duhur vendit të lënduar, ndonëse ka një rëndësi të veçantë me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit. Varësisht prej vendit të lënduar varen edhe pasojat në të ardhmen, si dhe vuajtjet e pësura gjatë shërimit, p.sh. lëndimet e organeve të brendshme të cilat janë jetike për funksionimin e organizmit të njeriut, paraqesin arsye për të gjykuar një shumë më të lartë sesa kur lëndohet një ekstremitet, p.sh. dora, ndonëse sipas mendimit të ekspertit mund të jenë të dyja lëndime të rënda dhe intensiteti dhe kohëzgjatja të jenë të njëjta, për faktin se dora ndonëse e ka rëndësinë e saj, ne kemi mundësinë që trajtojmë më lehtë në aspektin mjekësor, por edhe shohim gjendjen e saj, ndërsa organet e brendshme këto mundësi janë më të kufizuara dhe si rezultat shërimi është më i ndërlikuar. Poashtu vendi i lëndimit ka rëndësi kur kryhen intervenime kirurgjike apo të imobilizimit.

- **Mosha e personit të lënduar**, sipas këtij Udhëzuesi “ka rëndësi të veçantë, pasi që dhimbja paraqet edhe aspekt psikik, i cili aspekt ndryshon varësisht prej moshës. Te fëmijët shpesh edhe lëndimet e lehta shkaktojnë dhimbje, të cilat ata nuk i përballojnë lehtë, e po ashtu këto dhimbje rriten edhe me faktin se fëmijët shpesh nuk e kuptojnë edhe procesin e shërimit dhe gjendjen e tyre të lëndimit e përjetojnë më rëndë. Vështirësitë dhe situatat e palakmueshme të cilat janë përcjellë gjatë mjekimit, e veçanërisht shtrirja e gjatë në gjendje të palëvizshme, kryerja e nevojave fiziologjike në shtrat, vështirësitë gjatë marrjes së ushqimit, llojdhëni i intervenimeve kirurgjike, përdorimi i aparateve invalidor — paterica ose karroca, etj., ndikojnë në rritjen e vëllimit të dhimbjeve fizike” (Udhëzues nr.41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës).

- **Shqetësimet që ndodhin gjatë trajtimit mjekësor**, humbje të vetëdijes afatshkurtër, lloje të ndryshme të imobilizimit dhe fiksimit, incizime të shpeshta me rëntgen, shtrirje afatgjatë në shtrat, vështirësinë që sillt, numri dhe llojet e ndërhyrjeve kirurgjike, infuzionet, transfuzionet, injeksionet etj., ndikojnë në rritjen e vëllimit të dhimbjeve fizike. Andaj, gjykata duke marrë parasysh të

gjitha arsyet e lartcekura do të bëjë edhe përcaktimin e lartësisë për shpërblimin e dëmit jomaterial, për dhimbje fizike bazuar në kriteret orientuese, ashtu që për të gjitha llojet e intensitetit të dhimbjeve fizike të caktohen jeshumë të vetme, dhe është për: dhimbje fizike për lëndimet e trupit të gjykohej shumadë në 2,000.00 Euro dhe dhimbje fizike për lëndimet e trupit të gjykohej shumadë në 7,000.00 Euro.

- **Frika**- lartësia e dëmit për frikën e pësuar caktohet varësisht prej rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kohëzgjatjen dhe intensitetin e frikës së pësuar (Udhëzues nr. 41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës). Frika sipas intensitetit mund të jetë primare dhe sekondare. Frika mund të jetë e intensitetit të lartë edhe nëse ajo është afatshkurtër, respektivisht mund të jetë frikë afatgjatë, por intensitetit të ulët. Frika zakonisht përcillet dhe është ekuivalente lëndimet e marra trupore, ndonëse në rastet e frikës primare, kur është frikë për jetën (frika nga vdekja), mund të përjashtohet kjo rregull dhe frika mund të ekzistojë pavarësisht nga fakti se mungon lëndimet trupore.

Frika paraqet formë të dëmit jomaterial, të pranuar në aspektin juridik dhe se me rastin e pranimit dhe caktimit të shpërblimit është e mjaftueshme të konstatohet se frika ka qenë e evidente në momentin e aksidentit, si dhe ka vazhduar të shfaqet te personi i cili kërkon shpërblim për këtë formë të dëmit, dhe të vërtetohet fakti nëse frika ka qenë primare apo sekondare, si dhe të përcaktohet intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, dhe varësisht nga këto rrethana si dhe rrethanat e tjera, duke marrë parasysh natyrën e lëndimit, moshën e të lënduarit, nëse frika ka lënë pasojat përherëshme, të caktohet edhe shuma e shpërblimit. Natyra e lëndimit ka rëndësi, për faktin se varësisht prej natyrës së lëndimit, mund të varet edhe intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës. Disa llojet e lëndimeve shërimi i përcjell me frikën, për pasojat eventuale shëndetësore që mund të mbesin edhe pas përfundimit të shërimit. Moshë e të lënduarit apo personit që ushtron kërkesë për shpërblim të dëmit për shkak të frikës së pësuar, po ashtu është e rëndësishme, për faktin se tefëmijët, frika mund të shkaktohet më lehtë, dhe mund të jetë me pasojat më të gjata të përjetimit në mënyrë të vazhdueshme në formë të ndryshme, që mund të ndikojë edhe te zhvillimi i tij. Ndërsa

te personat e shtyrë në moshë frika mund të jetë në forma të tjera, p.sh. frika nëse do të mund të shërohet plotësisht nga lëndimet e marra.

Andaj, gjykata duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura do të bëjë edhe përcaktimin e shumës për shpërblimin e dëmit jo material, për frikë bazuar në kriteret orientuese, ashtu që për të gjitha llojet e intensitetit të frikës përjetuar, të caktojë një shumë të vetme, dhe atë për: Frikë në rastet e lëndimeve të lehta të trupit për të gjithë në 2,000.00 Euro dhe Frikë në rastet e lëndimeve të rënda të trupit për të gjithë në 7,000.00 Euro.

1.1.1. DHIMBJET SHPIRTËRORE PËR SHKAK TË ZVOGËLIMIT TË AKTIVITETIT TË PËRGJITHSHËMJETËSOR

Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është një bazë e veçantë për shpërblimin e dhimbjes shpirtërore të pësuar dhe përfshin të gjitha kufizimet në aktivitetin jetësor të personit të dëmtuar që ai tashmë ka përjetuar, ose që ai do të vazhdojë të përjetojë rregullisht në të ardhmen (Udhëzues nr.41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës). Me zvogëlim të aktivitetit jetësor, nënkuptohet gjithashtu edhe nevoja që për kryerjen e aktiviteteve të caktuara jetësore, lypsen për pjekjet e shtuara ose në kushte të veçanta.

Si rregull, kjo formë e dëmtimit është e një natyre të përhershme, por kompensimin e të holla mund të jepet edhe kur zvogëlimi i veprimtarisë jetësore është i përkohshëm, nëse është me intensitet më të madh, ose nëse e justifikojnë rrethanat e tjerat e veçanta. Në rastin kur zvogëlimi i aktivitetit jetësor është i përkohshëm, por edhe në rastet kur aktiviteti i përgjithshëm jetësor është i natyrës së përhershme, shpërblimin e të holla jepet si një shumë e vetme, pavarësisht faktit se kemitë bëjmë dëm në të ardhmen; në këtë rast emjafton konstatimi i ekspertit që pasojat janë edhe për të ardhmen, sesa dotë zgjasë gjendja, dhe nëse pasojat janë të përhershme dhe kemitë bëjmë gjendjetë papërmirësueshme. Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të këtij lloji të dëmit duhet të marrë për

bazëkriteret që merren parasysh gjatë përcaktimit të lartësisë së shpërblimit të dhimbjes shpirtërore përshkak të aktivitetit të zvogëluar jetësor, e që janë: shkalla e zvogëlimit të aktivitetit jetësor, eshpërhur në përqindje nga eksperti, mosha e të dëmtuarit, profesioni i të dëmtuarit, intensiteti dhe kohëzgjatja e pasojave, kufizimet në lidhje me aktivitetet familjare dhe shoqërore të personit të dëmtuar, kufizimet në lidhje me rekreacionin dhe sportet që praktikohen më parë, dhe të gjitha kufizimet të jetësor të të dëmtuarit.

Shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shprehur në përqindje, e përcakton eksperti i lëmit përkatës, varësisht prej natyrës së lëndimeve, duke u bazuar në kritere shkencore mbizvogëlimine të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, të cilin fakt gjykata duhet t marrë si të mirëqenë dhe ta ketë parasysh merastin e caktimit të shumës së shpërblimit.

Mosha e të dëmtuarit- ka një rëndësi të veçantë rastin e përcaktimit të lartësisë së shpërblimit të këtij lloji të dëmit, pasi varësisht prej moshës i dëmtuari kushtimisht, për një kohë të caktuar është i detyruar që t'i bartë edhe pasojat e zvogëlimit të aktivitetit jetësor, nëse është i moshës së repasojat do t'i bartë për tërë jetën e tij, andaj në këto raste është e arsyeshme që shuma e shpërblimit të dëmit të jetë më e lartë, pasi edhe pasojat i dëmtuari është i detyruar t'i bartë për një kohë më të gjatë.

Profesioni - kufizimet në ushtrimin e profesionit të të dëmtuarit, është kriter të cilin gjykata duhet t marrë parasysh merastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit, për faktin se mos ushtrimi i profesionit tshkakton dhimbje shpirtërore dhe bërë të dëmtuarin të ndjehet i pavlerë. Fakti se i dëmtuari shpërblehet për dëmin material të fitimit të humbur, nuk ndikon dhe nuk duhet të jetë pengesë për marrjen e këtij kriteri në vlerësim, pasi kemi të bëjmë me dy baza të ndryshme të shpërblimit të dëmit. Për të marrë parasysh kriterin e profesionit, duhet të jetë kusht që i dëmtuari të jetë duke e ushtruar profesionin e caktuar, apo ka qenë duke u shkolluar, duke ndjekur mësimet apo studiuar për profesionin e caktuar, me qëllim për ushtrimin e atij profesionit, me kusht që përshkak të zvogëlimit të përgjithshëm jetësor, i dëmtuari të jetë bërë i paaftë për

ushtrimin

eprofesionit përkatës plotësisht, pjesërisht, apo me kufizim në ushtrimin e profesionit.

Intensiteti dhe kohëzgjatja e pasojave - gjykata duhet me rastin e shpërblimit të dëmit të marrë parasysh edhe faktin se cili është intensiteti dhe kohëzgjatja e pasojave të cilat i ka shkaktuar te idëmtuari zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor. E rëndësishme është se nga cilat të mira është i kufizuar i dëmtuari në jetën e tij të përditshme, nëse atij i duhet përcjellja e personit të tretë, për sa kohë i nevojitet kjo përcjellje, nëse përcjellja dhe ndihma i duhet vetëm për disa aktivitete apo i nevojitet për çdo aktivitet jetësor. Nëse i dëmtuari është i detyruar të përdorë paterica për lëvizje, apo karrocë lëvizëse, dhe për sa kohë është i detyruar t'i përdorë. Në vlerësim të këtij kriteri mund të hyjë çdo veprim që ka ndikuar që i dëmtuari, si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, të jetojë më keq se para lëndimit të tij.

Kufizimet në lidhje me aktivitetet familjare dhe shoqërore të personit të dëmtuar – Aktivitetet familjare dhe shoqërore, janë aktivitete të cilat në të shumtën e rasteve njerëzit gjejnë kënaqësinë e tyre, andaj kufizimin e këto aktivitete për pjesëmarrje për shkak se i dëmtuari ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, është një nga kriteret që duhet të merret parasysh nga gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit, për këtë lloj të dëmit. Aktivitetet familjare dhe shoqërore për të gjithë njerëzit janë shumë të rëndësishme, dhe pamundësia e ushtrimit të këtyre aktiviteteve të të dëmtuarit i shkakton dhimbje shpirtërore, p.sh. pamundësia e prindit që tmbajë në krahë fëmijën e tij, paraqet kufizim të një aktiviteti i cili do të shkaktohte dhimbje të seciliprind (Udhëzues nr.41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës).

Kufizimet në lidhje me rekreacionin dhe sportet që praktikoheshin më parë,
dhe **të** **gjitha kufizimet tjera** – Gjykata merastine caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit duhet të marrë parasysh edhe kriterin nëse i dëmtuari si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka kufizim në ushtrimin e aktiviteteve të rekreacionit dhe aktiviteteve sportive, por edhe të aktiviteteve tjera

jetësore të përditshme, të cilat do të mund t'i kryente sikur të mos ishte lënduar. Te kufizimi i këtyre aktiviteteve nuk është kusht që i dëmtuari t'i ketë ushtruar këto aktivitete paralëndimit, por mjafton që në të ardhmen nuk mund t'i ushtrojë, dhe duke marrë parasysh rrethanat tjera, është e pritshme që këto aktivitete do t'i ushtronte, p.sh. për të mos i shpërndarë dotëminë und të notonte në mënyrë normale.

Andaj, duke u bazuar në këto kritere, është bërë edhe përshkallëzimi i shpërblimit të dëmit jomaterial për zvogëlimin e aktivitetit jetësor të shprehur në përqindjen e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, të përshkruarsimëposhtë:

deri 10%.....	prej 3,000.00 € deri 5,000.00 €,
deri 20%.....	prej 6,500.00 € deri 11,000.00 €,
deri në 30%.....	prej 9,900.00 € deri 16,500.00 €,
deri 40%.....	prej 13,200.00 € deri 22,000.00 €,
deri 50%.....	prej 16,500.00 € deri 27,500.00 €,
deri 60%.....	prej 19,800.00 € deri 33,000.00 €,
deri 70%.....	prej 22,200.00 € deri 38,500.00 €,
deri 80%.....	prej 26,400.00 € deri 44,000.00 €,
deri 90%.....	prej 29,700.00 € deri 49,500.00 €,
deri 100%.....	prej 33,000.00 € deri 55,000.00 € (Udhëzues nr.41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës).

1.1.2. DHIMBJESHPIRTERORE PËR SHKAKTË SHËMTIMIT

Shëmtimi është një bazë e veçantë për shpërblimin e dëmit jomaterial, për shkak të dhimbjeshpirtërore të pësuar dhe përfshin të gjitha ndryshimet në aspektin

fizik të pamjes trupore të personit të dëmtuar, si pasojë e aksidentit, e të cilat ndryshime të dëmtuarit i kanë shkaktuar dhimbje që ai tashmë i ka përjetuar, ose që ai do të vazhdojë t'i përjetojë rregullisht edhe në tëardhmen dhe, për të përcaktuar shumën e lartësisë së këtij lloji të dëmit, gjykata duhet të marrë parasysh disakritere: shkalla e shëmtimit, dukshmëria e shëmtimit, mosha e të dëmtuarit, profesioni i të dëmtuarit, manifestimi i shëmtimit etj (Udhëzues nr.41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës).

Shkalla e shëmtimit— Shkallën e shëmtimit e përcakton eksperti i lëmit përkatës, varësisht prej natyrës së lëndimeve, duke u bazuar në kritere shkencore mbi ndryshimet të cilat i ka pësuar idëmtuari, në bazë të të cilave përcaktohet nëse shëmtimi është shkallë së lartë, të mesme apo të ulët, të cilin fakti gjykata duhet të marrë në konsideratë edhe taketë parasysh merastine caktimit të lartësisë së shpërblimit.

Dukshmëria e shëmtimit - Gjykata me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit për këtë lloj të dëmit, duhet të marrë parasysh faktin nëse shëmtimi është i dukshëm dhe i ekspozuar gjatë gjithë kohës, apo është në vendet të cilat vetëm kur ekspozohen pjesë të caktuara të trupit mund të hihen, p.sh. disa pjesë të trupit ekspozohen në publik vetëm kur bëhet plazh, ndërsa fytyra ekspozohet gjatë tërë kohës dhe shëmtimet në fytyrë mund të shihen nga secili në çdo kontakt. Shëmtimi mund të mos jetë i dukshëm në shikim të parë, p.sh. për shkak të lëndimeve të mëdha në pjesën e nënës së fytyrës, të cilat mund të shihen vetëm kur i dëmtuari flet apo këndon, por jo edhe vetëm në shikim vizual.

Mosha e të dëmtuarit - Mosha e të dëmtuarit i cili ka pësuar shëmtim, ka rëndësi të veçantë merastin e caktimit të shumës së shpërblimit të këtij lloji të dëmit, kjo pasi varësisht prej moshës, idëmtuari kushtimisht për një kohë të caktuar është i detyruar që t'i bartë edhe pasojat e shëmtimit; nëse është i moshës së re, pasojat do t'i bartë për tërë jetën e tij, që rezulton se dhimbjet shpirtërore do të jenë të vazhdueshme, andaj në këto raste është e arsyeshme që lartësia e shpërblimit të dëmtit të jetë më e lartë, pasi edhe pasojat e idëmtuari është i detyruar t'i

bartëpërnjëkohëmëtëgjatë.Po ashtu nëse i dëmtuari është i moshës së re apo fëmijë, këto dhimbje shpirtërore do të jenë shumë më të larta,pasi gjendja e tij shpirtërore e ka shumë më të vështirë pranimin e realitetit të ri, pamjessë ndryshuar, për faktin se më lehtë u nënshtrohen paragjykim eve të personave të tretë dhe shumëlehtë mund të ndihen të lënduar dhe të padëshiruar, jo të pranueshëm mirë në mesin ku jetojnë.Ndonëse në praktikë nuk ka ndonjë qëndrim të prerë nëse gjinia mund të jetë kriter për vlerësim,prapëseprapë konsiderojmë që kjo në raste të caktuara, varësisht prej rrethanave, mund të merret sikriterpërpërcaktimin elartësisësëshpërblimittëkëtijllojitëdëmit.

Profesioni i të dëmtuarit- Kufizimet në ushtrimin e profesionit të të dëmtuarit, është kriter të cilin gjykataduhettamarrëparasysh merastinecaktimittëlartësisësëshpërblimittëdëmit,përfaktin se mos ushtrimi i profesionit shkakton dhimbje shpirtërore, duke e bërë të dëmtuarin të ndjehet ipavlerë.Faktiseidëmtuarishpërblehetpërdëminmaterialpërfitiminhumbur,nukndiko ndhenuk duhet të jetë pengesë për marrjen e këtij kriteri në vlerësim, pasi kemi të bëjmë me baza tëndryshme të shpërblimittë dëmit.Për të marrë parasyshkriterine profesionit,duhet të jetë kushtqëidëmtuaritëjetëdukeeushtruarprofesioninecaktuar,apokaqenëdukeushkolluar ,duke ndjekur mësimet apo studiuar për profesionin e caktuar, apo duke ndjekur kurs për aftësim për këtëprofesion, me qëllimpër ushtrimin e atij profesioni,me kusht që për shkak të shëmtimit dëmtuaritëjetëbërëipaafhtëpërushtriminekëtijprofesioniplotësisht,apopjesërisht,apom ekufizimenëushtrimin e profesionit, p.sh. një balerinë për shkak të shëmtimit - çalimit nuk mund të ushtrojëprofesionin e saj, si para dëmtimit; po ashtu edhe një futbollist, apo një prezantuese televizive, përshkak të problemeve në të folur, apo pamjes së saj, nuk mund të ushtrojë profesionin e saj, pasimundt’iduketvetjaepapranueshmenëpublik.

Manifestimii shëmtimit - Manifestimi i shëmtimit është po ashtu kriter të cilin gjykata duhet tamarrëparasysh me rastine caktimit të lartësisë së shpërblimittë këtij lloji të dëmit, kjo për faktinse mënyra sesi manifestohet shëmtimi, bën që i dëmtuari të vuajë për gjendjen e tij, p.sh. nëse kashëmtim me deformim të fytyrës, vuajtja e tij

mund të jetë shumë më e madhe se sa kur ka njëvragë në fytyrë, ndonëse të dyshëmtimet mund të hyn në shkallë në lartë të shëmtimit. Andaj duke u bazuar në këto kritere, është bërë edhe përshkallëzimi i shpërblimit të dëmit përshëmtim, të përshkruar si më poshtë:

- Shkalla e lartë

- a) I dukshëm për personat të tretë.....prej 7,000.00€ deri 10,000.00€,
- b) Jo i dukshëm për personat të tretë.....prej 4,000.00 € deri 6,000.00 €,

- Shkallë mesme

- a) I dukshëm për personat të tretë.....prej 3,000.00€ deri 4,000.00 €,
- b) Jo i dukshëm për personat të tretë.....prej 2,000.00€ deri 3,000.00€.

- Shkallë e ulët

- a) I dukshëm për personat të tretë.....prej 1,500.00€ deri 2,000.00€,
- b) Jo i dukshëm për personat të tretë.....prej 1000.00€ deri 1,500.00 € (Udhëzues nr.41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës).

1.1.3. DHIMBJET SHPIRTËRORE NË RAST VDEKJEJE TË PERSONAVE TË AFËRM

Sipas Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës, “një nga format e shpërblimit të dëmit jo material është edhe shpërblimi i dëmit në rast vdekjeje të ndonjë personi, ku gjykata mund t’ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve, si dhe bashkëshortit jashtë martesor, në qoftë se ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa evazhdueshme), shpërblim të drejtë në të hollapër dhembjen e tyre shpirtërore ku, ky shpërblim mund t’u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme; për sa i përket bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve, mjafton që të vërtetohet lidhjen

familjare me të vdekurin, në mënyrë që të kenë legjitimitetin e palës paditëse në procedurë, ndërkaq, për sa i përket vëllezërvedhe motrave të të vdekurit, përveç të vërtetuarit të faktit të lidhjes familjare me të vdekurin, duhet të provojnë dhe faktin se ndërmjet tyre redhe personi të vdekur ka

ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme dhe, çka paraqet bashkëjetesë e vazhdueshme, LMD nuk ka ndonjë përkufizim, andaj për të përkufizuar çka paraqet bashkëjetesa, duhet të marrë si referencë Ligjin mbi Familjen” (Udhëzues nr.41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës).

Kriteret të cilat duhet t’i marrë gjykata para sysh merastine caktim të lartësisë së shpërblimit për këtë lloj të dëmit jomaterial, janë: se çfarë moshe ka pasur i vdekuri në momentin e vdekjes sipasojë e aksidentit, statusi martesor, nëse i vdekuri ka lënë fëmijë të vegjël pas vete, nëse ka qenë fëmija i vetëm i prindërve, nëse ka qenë mbajtës i familjes, lidhjet emocionale me të vdekurin, mënyra sesi ka ndodhur aksidenti dhe kriteret tjerë, të cilat gjykata duhet t’i ketë në vëmendje merastine caktim të shpërblimit të dëmit, duke iu referuar për shkallëzim të dëmit si mëposhtë:

- Në rast të vdekjes së bashkëshortit.....prej 8,000.00 € deri 15,000.00 €,
- Në rast të vdekjes së bashkëshortit jashtë martesor.....prej 8,000.00 € deri 15,000.00 €,
- Në rast të vdekjes së fëmijës për prindërit.....prej 8,000.00 € deri 15,000.00 €,
- Në rast të humbjes së fetusit për prindërit.....prej 8,000.00 € deri 15,000.00 €,
- Në rast të vdekjes së prindërve.....prej 8,000.00 € deri 12,000.00 €,
- Në rast të vdekjes së vëllait ose motrës.....prej 4,000.00 € deri 8,000.00 € (Udhëzues nr.41/2023, dt. 27.02.2023, miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës).

KAPITULLI VIII

1. RASTE NGA PRAKTIKA GJYQËSORE LIDHUR ME SHPËRBLIMIN E DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Ky kapitull trajton disa raste nga praktika gjyqësore e gjykatave themelore në Republikën e Kosovës, përkitazi me shpërblimin e dëmit jomaterial me çrast, këto raste gjyqësore përmbajnë në vete forma të kompensimit të dëmit jomaterial, dëm i cili është shkaktuar, kryesisht nga aksidentet e trafikut.

IGjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin Cnr3269/14 të 06.12.2019, në çështjenjuridike“të paditësit NN nga Obiliqi, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve Siguria me seli në Prishtinë, e kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që kishte detyruar të paditurën që në emër të dëmit material dhe jo material, t’ia paguajë shumat si vijon:për dhimbje fizike, shumën prej 1.300 €;për frikën e pësuar, shumën prej 800 €;Në emër të dëmit material:për ushqim te përforcuar, shumën prej 70 €;për ndihmën dhe kujdesin e huaj, shumën prej 98;ashtu që shuma e tërësishme për të gjitha bazat arrin në shumë prej 2.268 € (dymijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë euro), me kamatë ligjore prej 8 % e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, ndërsa kishte refuzuar si të pabazuar pjesën e kërkesëpadiisë së paditësit për dëmin jo material, mbi shumën e gjykuar, dhe atë në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 700 € dhe në emër të frikës shumën prej 700 €” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3269/14, dt.06.12.2019, linku:<https://www.gjyqesori-rks.org/aktgjykimet/>).

IIIndërsa me Aktgjykimin Cnr3472/14, të 04.02.2020,“Gjykata Themelore në Prishtinë, në çështjen kontestuese të paditësit NM nga Podujeva, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve Illyria me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, e kishte aprovuar pjesërisht sitë bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që paditësit në emër të kompensimit të dëmit, t’ia paguajë shumat si vijon:Për dëmin jo material:për dhimbje fizike, shumën prej 1,200 €;për frikën e pësuar, shumën prej 1000 €;Për dëmin material:për ndihmën e personit të tretë shumën prej 100 €;për ushqimin e përforcuar

shumën prej 100 €;për shpenzimet e mjekimit shumën prej 294.23 €;ashtu që shuma e tërësishme e arrin vlerën prej 1,794.23 €, me kamatë ligjore prej 8 %, e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, ndërsa kishte refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit mbi shumat e gjykuara, dhe atë në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike shumën prej 2800€, për frikën e pësuar shumën prej 2000€, për rehabilitimin klimaterik shuma e tërësishme prej 300€, ndërsa për shpenzimet e mjekimit shumën prej 28,60€” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3472/14, dt.04.02.2020).

III Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktgjykimin Cnr829/2013, të18.11.2016,“në çështjen juridike kontestimore të paditësit AA, nga Mitrovica, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve Siguria me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit, kishte miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që kishte detyruar të paditurën që në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, t’i paguajë shumat si vijon:Në emër të dëmit jo material:Për dhimbje fizike trupore, shumën prej 900.00 euro;Për frikën e pësuar, shumën prej 700.00 euro;Në emër të dëmit material:Për ushqim të përforcuar shumën prej 210.00 euro;Për shpenzimet e mjekimit, shumën prej 41.00 euro;apo shuma e tërësishme e arrin vlerën prej 1,851.00 euro (një mijë e tetë qind e pesëdhjetë e një euro), me kamatë ligjore prej 12%; sikur paratë të jenë të depozituara në bankat e Kosovës, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 27.12.2013 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.829/2013, dt. 18.11.2016). Ndërkaq, në arsyetimin e aktgjykimit të lartëcekur, “gjykata për dhimbje fizike, ka caktuar shpërblimin për paditësin shumën prej 900 euro, duke vlerësuar si shpërblim të drejtë që i shërben qëllimit të kompensimit të dëmit, sepse paditësi, sipas mendimit të eksperteve të mjekësisë si pasojë e aksidentit, ka pësuar lëndime të lehta trupore, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë në lartësi prej 670.00 euro, gjykata e ka refuzuar, duke vlerësuar si shumë të lartë dhe jo në proporcion me dëmin e shkaktuar dhe një

shumë e tillë e tejkalon qëllimin e shpërblimit të dëmit“ (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.829/2013, dt. 18.11.2016).

IVGjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktgjykimin Cnr381/2015, të 09.03.2018,“në çështjen juridike kontestimore të paditësit BN, nga Reka, Komuna e Mitrovicës,kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit, kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që e detyron të paditurën Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit nga autopërgjegjësia, t’ia paguajë shumat e specifikuara si me poshtë:Për dhimbje fizike trupore shumë prej 4500 euro;Për frikën e pësuar shumë prej 4000 euro;Për shëmtim trupor, shumë prej 300 euro;Për zvogëlim të aktivitetit jetësor, shumë prej 18500 euro;Për ndihmën dhe përkujdesjen e personit tretë shumë prej 900 euro;Për ushqim të përforcuar shumë prej 400 euro;Për shpenzimet e gjertanishme të mjekimit shumë prej 5546 euro;Në emër të fitimit të humbur përperiudhën e kaluar prej datës 25.08.2013 e deri me datën 31.01.2017 e së bashku me kamatën e llogaritur, të paguajë shumë e përgjithshme 8283.19 euro si dhe për periudhën e ardhshme prej 01.02.2017 e tutje deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, t’ia paguajëshumënmujore nga 160 euro” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr. 381/2015 dt. 09.03.2018).

Sipas këtij Aktgjykimi “në pikën e dytë të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata kishte detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguajë shumat e gjykuara si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës civile në shumë të përgjithshme prej 1767 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm; Gjykata ka gjetur se baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për takompensuar paditësin, gjen mbështetje në dispozitat e nenit 136 dhe 159 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve”(Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr. 381/2015 dt. 09.03.2018).

VGgjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktgjykimin Cnr391/2015, të 25.06.2018,“në çështjen juridike kontestimore të paditësit VB, nga Mitrovica, kundër të

paditurës Kompania e Sigurimeve Sigal me seli në Prishtinë, lidhur me kompensim dëmi, kishte miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që kishte detyruar të paditurën, sipas përgjegjësisë së ndarë në shkallën prej 70%, që në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të shkaktuar si pasojë në aksidentin e komunikacionit të datës 19.11.2013, t'i paguajë shumat si në vijim: Në emër të dëmit jo material: Për dhimbje fizike trupore shumë prej 1000 euro; Për frikën e pësuar shumë prej 800 euro; Në emër të dëmit material: Për kompensimin e dëmit material për automjet shumë prej 3775 euro; Për kujdesin e huaj shumë prej 100 euro; Për ushqim të përforcuar shumë prej 100 euro; apo shuma e tërësishme e arrin vlerën prej 5775 euro (pesë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pese euro), me kamatë ligjore sikur parat të jenë të depozituara në bankat e Kosovës, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 22.06.2018 (data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi) e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa pjesa e kërkesëpadisë së paditëses për dëmin mbi shumë e gjykuar dhe atë: në emër të dëmit material për automjet shumë prej 5225 euro, në emër të sigurimit të pashfrytëzuar prej 8 muajve sigurim shumë prej 125 euro, në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 1000 euro, në emër të frikës së pësuar shumë prej 2200 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit punues shumë prej 1500 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 100 euro, në emër të shpenzimeve për mjekim shumë prej 500 euro, në emër të kujdesit të huaj shumë prej 100 euro, në emër të shpenzimeve për rehabilitimin klimatik shumë prej 1000 euro, ishte refuzuar si e pabazuar; Detyrohet e paditura që sipas përgjegjësisë së ndarë, paditësit t'i paguajë shumat e gjykuara si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës civile në shumë të përgjithshme prej 740 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm" (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.391/2015, dt. 25.06.2018).

VIGjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin Cnr720/2016, të 10.08.2023, "në çështjen juridike - kontestimore të paditësve BK, JK, AK, dhe AK., të cilin e

përfaqësojnë përfaqësuesit ligjor B, dhe JK., si dhe BK, të gjithë nga Komuna O, e të gjithë sipas autorizimit me shkrim i përfaqëson ID, av në Prishtinë, kundër të paditurës UOP me nr.biz, me seli në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson AGjav. në Prishtinë, Baza juridike: Kompensim dëmi material dhe jomaterial, vlera e kontestit 18,530.00 €, kishte aprovuar pjesërisht padinë e paditësve dhe kishte detyruar të paditurën t'i paguajë shumat si në vijim_____;"(Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.720/2016, datë 10.08.2023).

Me këtë aktgjykim "gjykata ka detyruar të paditurën Kompania UOP me nr.biz, me seli në Mitrovicë, që shumat e gjykuara, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për dëmin material dhe jo material në total prej 14,330.00 €, ti paguajë me kamatë ligjore prej 8%, dhe atë për dëmin material në shumë të përgjithshme prej 5,730.00€, kamata do të rrjedhë nga dita e parashtrimit të padisë 28.12.2016, kurse për dëmin jo material në shumë të përgjithshme prej 8,600.00€, kamata do të rrjedh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit datë 10.08.2023, e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm; Refuzohet pjesërisht si e pa bazuar pjesa e kërkesë padisë së paditësve përtej pjesës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi sa i përket dëmit jo material dhe atë për paditësin BK për dhimbje fizike, shumën prej 600€, për frikën e pësuar, shumën prej 700€, për paditësin JK për dhimbje fizike shumën prej 800€, për frikën e pësuar, shumën prej 500€, për paditësin AK për dhimbje fizike, shumën prej 600€, për frikën e pësuar, shumën prej 200€, dhe për paditësin AK për dhimbje fizike shumën prej 600 €, për frikën e pësuar, shumën prej 200€, apo në total shumen e përgjithshme prej 4,200.00€. pasi që shumat e kërkuara nuk janë në harmoni me dëmin e pësuar dhe praktikën gjyqësore" (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.720/2016, datë 10.08.2023).

VII Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktgjykimin Cnr1851/2015, të 05.02.2020, "në çështjen juridike të paditësve NM, NN dhe MN, të gjithë nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Siguria, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson për shkak të kompensimit të dëmit, kishte aprovuar pjesërisht kërkesë padinë e paditësve, ashtu që e detyron të paditurën që

paditësve në emër të dëmit nga autopërgjegjësia, t'iu paguajë shumat e specifikuara si më poshtë:

Paditëses NM në emër të dëmit jo material dhe material, shumën e përgjithshme prej 2,525.00 Euro, e cila shumë përfshin kompensimin si në vijim _____” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1851/2015, të 05.02.2020).

VIII Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin Cnr3340/13, të 29.01.2020, “në çështjen kontestimore të paditësit XhA, nga Prishtina, kundër të paditurës American International Group (AIG), me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të, detyrohet e paditura American International Group (AIG), me seli në Prishtinë, që parashtruesit të kërkesëpadisë, në emër të shpagimit të dëmit material dhe jo material, t’ia kompensojë dëmin të pësuar në aksidentin e datës 03.05.2006 nga automjeti Toyota me targa UN21276 dhe atë: për dhimbje fizike shumë prej 2000 €, për frikë 1000 €, për humbje të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 3.000 €, për shëmtim 1000 €, për rehabilitim fizio-terapeutik 200 €, për ushqim të përforcuar 100 €, për ndihmë dhe kujdes të huaj 100 €, për shpenzime të shërimit 200 €, në shumë të përgjithshme prej 7,600 €, të gjitha këto me kamatë prej 3,5 %, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtare, si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit me kërkesë të përmbarimit të detyrueshëm” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3340/13, dt. 29.01.2020).

Po sipas këtij aktgjykimi “Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, për shkak të parashkrimit të kërkesës së paditësit; Gjykata gjeti se në rastin konkret raporti juridiko-detyrimor nga i cili rrjedh kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmit, ka ndodhur në vitin 2006, konkretisht me aksidentin e komunikacionit të datës 03.05.2006, në mes të paditësit dhe të siguararit të paditurës; Duke u nisur nga koha e

ndodhjes së raportit juridiko-detyrimor, gjykata gjen se ligj i aplikueshëm në këtë çështje kontestimore është Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 29/78, 39/85, 45/89, Fletorja zyrtare e RFJ nr., 31/93 e dt. 18.06 1993) dhe, meqë e paditura në përgjigje në padi dhe në shqyrtimin kryesor është thirrur në parashkrim të kërkesës, gjykata fillimisht ka shqyrtuar çështjen e parashkrimit, pasi që kemi të bëjmë me një afat të natyrës materialo-juridike, për të cilin konform dispozitës së Nenit 360 par.2 të LMD-së gjykata e merr parasysh vetëm nëse pala thirret në atë - gjykata së pari e ka vlerësuar afatin e parashkrimit në këtë çështje juridike” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3340/13, dt. 29.01.2020).

IXGjykata Themelore në Prizren – Dega në Dragash, me Aktgjykimin Cnr116/2011, të 15.02.2013, “në çështjen juridike kontestimore të paditësit SS nga fsh, Komuna e Dragashit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve GE me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit material dhe jo material, kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që kishte obliguar të paditurën KS GE me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material e nga baza e autopërgjegjësisë, paditësit duhet t’i paguajë: për dhimbje fizike shumë prej 2.000,00 €, për frikën e pësuar shumë prej 1.000,00 €, për shëmtimin në shkallë të ulët shumë prej 750,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 3.000,00 €, për dëmin material dhe atë për ndihmë dhe për kujdesin e huaj shumë prej 150,00 €, si dhe në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 100,00 €, për rehabilitim fizioterapeutik klimatik shumë prej 300,00 €, dhe për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit në shumë prej 129,00 €, pra e paditura tani paditësit duhet t’i kompensojë shumë e përgjithshme prej 7.429,00 €, me kamatë ligjore siç e cakton banka për deponime, e cila kamatë do të llogaritet prej datës 29.04.2013, ndërsa tërë shumë e aprovuar të të hollave e paditura është e obliguar që paditësit t’i paguajë brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi me kërcënim të ekzekutimit; Kërkesëpadia e paditësit S. S. për tej shumës së aprovuar në lartësi prej 2.567,00 € për kompensimin e dëmit jo material dhe material refuzohet si e

pabazuar” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash, C.nr.116/2011, dt. 15.02.2013).

XGjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin Cnr2657/2015, të 01.12.2021, “në çështjen juridike të paditësit BB nga Podujeva, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve E me seli në Prishtinë, për shkak të shpërblimit të dëmit, kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe kishte obliguar të paditurën, që paditësit në emër të shpërblimit të dëmit jo material dhe material t’ia paguajë shumën prej 3,191.40 € (me fjalë: tre mijë e një qind e nëntëdhjetë e një euro e dyzet centë), së bashku me normën e kamatës vjetore, në lartësi prej 8%, e cila llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e cila shumë përfshin kompensimin për dëmet si në vijim _____;” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 2657/2015, dt. 01.12.2021).

Me këtë aktgjykim gjykata ka “refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë mbi shumat e gjykuara, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimit, dhe atë si në vijim: për dhimbje fizike nga shuma e gjykuar në lartësi prej 1,500.00 € deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 2,000.00 €, si dhe për frikën e pësuar nga shuma e gjykuar në lartësi prej 1,200.00 € deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 1,500.00 €; detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 704.00 €, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 2657/2015, dt. 01.12.2021).

XGjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin Cnr1031/15, të 12.11.2021, “në çështjen juridike të paditësit HB nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Sigma, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që kishte detyruar të paditurën që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, t’ia paguajë shumën e mjeteve si në vijim: - për dhimbje fizike shumën prej 1,100 €, për frikën e përjetuar shumën prej 900 €, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 150 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 150 €, për shpenzime të

mjekimit shumë prej 35.18 €, në shumë të përgjithshme prej 2,335.18 €, me kamatë ligjore prej 8%, ashtu që për dëmin jo material kamata do të fillojë të rrjedhë nga data e marrjes së Aktgjykimit më dt.12.11.2021 e deri në pagesën e tërësishme, kurse për dëmin material nga dita e parashtrimit të kërkesës për kompensim më dt.24.12.2014 e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm; refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë, mbi shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 2,400.00€; për frikën e përjetuar shumë prej 1,600.00€, në emër të rehabilitimit klimaterik dhe fizioterapeutik, shumë e tërësishme prej 200€, III. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës civile në shumë prej 634.40 €, në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1031/15, dt. 12.11.2021).

XIIGjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin Cnr3076/2016, të 04.10.2021,“në çështjen juridike të paditësit EV me përfaqësues të autorizuar MS kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga AK dhe NM sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit, kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që kishte detyruar të paditurën që t'i paguajë shumat e mjetëve si në vijim:- për dhimbje fizike shumë prej 1,400 Euro, - për frikën e pësuar shumë prej 1,100 Euro, - për ndihmën e personit të tretë shumë prej 200 euro, - për ushqim të përforcuar shumë prej 200 Euro, - në shumë të përgjithshme prej 2,900.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, ashtu që për dëmin jo material kamata do të fillojë të rrjedhë nga data e marrjes së aktgjykimit më dt. 04.10.2021 e deri në pagesën e tërësishme, kurse për dëmin material nga dita e parashtrimit të kërkesës për kompensim më dt.07.10.2016 e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm; ndërkaq, ishte refuzuar si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë, mbi shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 1,600.00€; për frikën e

përjetuar shumë prej 900.00€; në emër të rehabilitimit klimaterik dhe fizioterapeutik shumë të tërësishme prej 300.00 €; detyrohet e paditura që paditësve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës civile në shumë prej 634.40 Euro, në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3076/2016, dt. 04.10.2021).

Sipas këtij aktgjykimi “nga provat e administruara, gjykata erdhi në përfundim se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por kontestuese ishte vetëm lartësia e shumave të kompensimit dhe, duke qenë se e paditura nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata nuk u lëshua fare në vlerësimin e provave që kanë të bëjnë me mënyrën e shkaktimin të aksidentit, respektivisht bazën juridike të kërkesëpadisë dhe, mbi këtë bazë, duke qenë se gjykata vlerëson se e paditura mban përgjegjësinë që paditësit t'ia kompensojë dëmin - meqë shkaktari i dëmit ka lidhur kontratë me kompaninë e sigurimeve, në këto rrethana kompensimin e dëmit e bën e paditura mbi bazën e sigurimit të auto-përgjegjësisë (Sigurimit të detyrueshëm për palët e treta) në mbështetje të nenit 159 para 1 dhe 136 para 1 të Ligjit Nr 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve” (Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3076/2016, dt. 04.10.2021).

**1.2. TË DHËNAT STATISTIKORE LIDHUR ME LËNDËT PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT
JOMATERIAL NË GYKATAT THEMELORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

A. Kontestet lidhur me shpërblimin e dëmit gjatë vitit 2017 (Burimi i të dhënave:
Këshilli Gjyqësor i Kosovës – Departamenti i Statistikave)

K O N T E S T E T P Ë R S H P Ë R B L I M I N E D Ë M I T	L Ë N D Ë T Ë P A Z G J I D H U R A N Ë F I L L I M	L Ë N D Ë T Ë P R A N U A R A	G J I T H S E J L Ë N D Ë N Ë P U N Ë	N Ë B A Z Ë T Ë P R A N I M I T	N Ë B A Z Ë T Ë M U N G E S Ë S	A P R O V O H E T K Ë R K E S A	R E F U Z O H E T K Ë R K E S A	M E M A R R Ë V E S H J J E G J Y Q Ë S O R E	M E H U D H J E P O S H T Ë T Ë P A D I S Ë	M E T Ë R H E Q J E N E P A D I S Ë	N D Ë R P R I T E T P R O C E D U R A	Ë S H T Ë Z G J I D H U R N Ë M Ë N Y R Ë T J E T Ë R
	11266	6096	17362	34	27	1258	275	796	172	1741	231	398

B. Kontestet lidhur me shpërblimin e dëmit gjatë vitit 2018(Burimi i të dhënave:
Këshilli Gjyqësor i Kosovës – Departamenti i Statistikave)

K O N T E S T E T P Ë R S H P Ë R B L I M I N E D Ë M I T	L Ë N D Ë T Ë P A Z G J I D H U R A N Ë F I L L I M	L Ë N D Ë T Ë P R A N U A R A	G J I T H S E J L Ë N D Ë N Ë P U N Ë	N Ë B A Z Ë T Ë P R A N I M I T	N Ë B A Z Ë T Ë M U N G E S Ë S	A P R O V O H E T K Ë R K E S A	R E F U Z O H E T K Ë R K E S A	M E M A R R Ë V E S H J J E G J Y Q Ë S O R E	M E H U D H J E P O S H T Ë T Ë P A D I S Ë	M E T Ë R H E Q J E N E P A D I S Ë	N D Ë R P R I T E T P R O C E D U R A	Ë S H T Ë Z G J I D H U R N Ë M Ë N Y R Ë T J E T Ë R
	12421	6295	18716	13	30	1376	284	881	149	1802	268	374

C. Kontestet lidhur me shpërblimin e dëmit gjatë vitit 2019(Burimi i të dhënave:
Këshilli Gjyqësor i Kosovës – Departamenti i Statistikave)

K O N T E S T E T P Ë R S H P Ë R B L I M I N E D Ë M I T	L Ë N D Ë T Ë P A Z G J I D H U R A N Ë F I L L I M	L Ë N D Ë T Ë P R A N U A R A	G J I T H S E J L Ë N D Ë N Ë P U N Ë	N Ë B A Z Ë T Ë P R A N I M I T	N Ë B A Z Ë T Ë M U N G E S Ë S	A P R O V O H E T K Ë R K E S A	R E F U Z O H E T K Ë R K E S A	M E M A R R Ë V E S H J J E G J Y Q Ë S O R E	M E H U D H J E P O S H T Ë T Ë P A D I S Ë	M E T Ë R H E Q J E N E P A D I S Ë	N D Ë R P R I T E T P R O C E D U R A	Ë S H T Ë Z G J I D H U R N Ë M Ë N Y R Ë T J E T Ë R
	13542	7934	21476	69	26	1771	427	1271	235	1885	398	590

Ndërkaq, lidhur me vitin 2022, në 7-të Gjykatat Themelore dhe degët e tyre, paraprijnë kontestet nga kompensimi i dëmit, me gjithsej 36.888 lëndë, pasuar nga kontestet pronësore dhe kontestet që rrjedhin nga kontratat kolektive andaj, nëse kalkuloheh statistikat e lartëpërmendura rrjedh përfundimi që diku rreth 32% e lëndëve në punë gjatë këtij viti kanë qenë lëndë nga kompensimi i dëmit (Burimi i të dhënave: Këshilli Gjyqësor i Kosovës – Departamenti i Statistikave).

KONKLUZIONET

Lënda e hulumtimit të këtij disertacioni të doktoratës ngërtheunë vete trajtimin e shpërblimit të dëmit jomaterial në përgjithësi në aspekt komparativ, me fokus në Republikën e Kosovës.

Lidhur me aspektin historik, u morr vesh që, në shekullin e nëntëmbëdhjetë, me miratimin e kodifikimeve kryesore të së drejtës civile, filloi të zhvillohet kuptimi modern i konceptit të dëmit jomaterial ku normat e së drejtës civile filluan të trajtojnë gjithnjë e më shumë edhe komponentin e tyre jopasuror dhe kjo çoi në mbrojtjen e pronës personale me anë të së drejtës private, e cila lidhet ngushtë me vizionin humanist të zhvillimit të njerëzimit dhe, në këtë shekull të mësuarit për të drejtat personale bëhet një sistem i plotë dhe i rrumbullakosur ku, zhvillimi i institutit juridik të kompensimit të dëmit jomaterial është i lidhur pazgjidhshmërisht me zhvillimin e të mësuarit për të drejtat personale me çrast, nuk ka dyshim se është e pamundur të imagjinohet ndonjë sistem i mbrojtjes së të drejtave personale pa kompensim monetar për dëmet jomateriale.

Sot, ekzistimi i së drejtës për kompensimin e dëmit jomaterial nuk është më i diskutueshëm as në teorinë juridike dhe as në praktikën gjyqësore, por çështja e përcaktimit të masës së saj dhe kriterëve që duhen zbatuar gjatë përcaktimit të masës së kompensimit të drejtë monetar për lloje të caktuara të dëmit jomaterial është ende i diskutueshëm si në doktrinën juridike ashtu edhe në praktikën gjyqësore dhe, krahas kësaj çështjeje lindin edhe çështje të reja të kontestuar, përkatësisht: rrethi i subjekteve që kanë të drejtë në kompensim, format e kompensimit të dëmit jomaterial, çështja e parashkrimit dhe dhënies së kamatës ligjore si dhe çështja e kërkesave trashëgimore në bazë të kompensimit të dëmit jomaterial.

Në këtë hulumtim u konstatua që, në teorinë juridike civile dhe detyrimore nuk ka një qëndrim unik mbi përcaktimin e nocionit të dëmit jomaterial, pra nuk ekziston një koncept i pranuar botërisht i këtij nocioni, mirëpo konsideroj që, një gjë e tillë edhe nuk është e mundur me një përkufizim plotësisht të saktë të dëmit jomaterial, dhe nuk është edhe e dëshirueshme, meqë ai paraqet një koncept kompleks me një kuptim shumë të gjerë. Megjithatë, kjo nuk do me thënë se koncepti themelordhe qasja për riparimin e tij nuk duhet të përcaktohet meqë pa një kuptim të duhur të këtij dëmi, natyra e tij juridike nuk mund të përcaktohet në mënyrë adekuate dhe as që mund të zgjidhen çështjet që kanë të bëjnë me kompensimin e tij.

Në të drejtën komparative hulumtimi konstatoi një diferencë të madhe si në legjislacion ashtu edhe në praktikën gjyqësore; para së gjithash, u vërejtë që, ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet sistemeve juridike evropiano-kontinentale dhe anglo-saksone, ndonëse vërehen edhe disa ndikime të ndërsjella ku, në kuadër të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, harmonizimi i legjislacionit nacional në fushën e detyrimeve dhe marrëdhënieve ekonomike bëhet me qëllim të standardizimit të mbrojtjes së të drejtave personale në atë fushë. Megjithatë, ka ende shumë dallime ndërmjet tyre për sa i përket llojeve, metodave dhe kushteve në të cilat mund të realizohet dëmi jomaterial, mirëpo siç u morr vesh në këtë hulumtim, problemet e shumta lidhur me kompensimin e këtij dëmi specifik tentohen të kapërcehen në praktikë me interpretim të gjerë të dispozitave ligjore që zgjerojnë zbatimin e tyre dhe me një praktikë kreative gjyqësore.

Nga i gjithë hulumtimi i kryer rrjedh qartë gjetja se dëmi jomaterial është i rregulluar ndryshe në të drejtën komparative; ku shumica e kodeve civile nuk e përcaktojnë konceptin e një dëmi të tillë, por i është lënë teorisë juridike dhe praktikës gjyqësore, me çrast, praktika gjyqësore ka ndikuar veçanërisht në zhvillimin e të drejtësë kompensimit në këtë lëmi juridike. Vështrimi krahasues në këtë hulumtim tregoi që dëmi jomaterial kompensohet pavarësisht nëse ai njihet shprehimisht në një legjislacion të caktuar apo jo dhe termat apo konceptet nën të cilët fshihen format e ndryshme të atij dëmi përcaktohen ndryshe, në varësi të traditës juridike të vendeve

veç e veç. Njëashtu u konstatua që, mundësia e njohjes së të drejtës për kompensim të drejtë monetar për këtë dëm po zgjerohet gjithnjë e më shumë dhe kjo gjë paraqitetsi pasojë e progresit në mbrojtjen e të drejtave personale nëpërmjet instrumenteve të së drejtës civile dhe detyrimore meqë e drejta e kompensimit dhe kushtet në të cilat realizohet ai dëm, formësohen nën ndikimin e fortë të situatës ekonomike dhe sociale në çdo vend dhe në përputhje me specifikat e çdo sistemi të caktuar juridik.

Kompensimi i dëmit paraqet eliminimin e pasojave të dëmshme që ka pësuar i dëmtuari, të cilat janë shkaktuar nga veprimet e një personi tjetër dhe, për mënjanimin e pasojave të dëmshme, personat përgjegjës për dëmin janë të detyruar t'i japin ose t'i bëjnë diçka të dëmtuarit.

Përderisa dëmi material mund të riparohet, dëmi jo material nuk mund të riparohet e të kthehet në gjendjen e mëparshme. Prandaj, në teorinë juridike dhe gjithashtu në praktikën gjyqësore, çështja e kompensimit të saj paraqitet si e diskutueshme, me çrast siç edhe u konstatua në hulumtim, sipas një pikëpamjeje të doktrinës juridike, dëmi jomaterial nuk mund të vlerësohet në para, sepse vlerat morale nuk mund të reduktohen në para; dhënia e kompensimit monetar përfaqëson komercializimin e vlerave morale pasi pasojat e dëmshme të shkaktuara nga cenimi i pronës personale nuk mund të hiqen me pagesë në para dhe, kjo është arsyeja pse kompensimi i caktuar monetar për dëmin jomaterial në fakt paraqet një gjobë në favor të palës së dëmtuar dhe, rrjedhimisht, gjoba paraqet sanksion për shkeljen e një ndalese ligjore dhe nuk paraqet kompensim për dëmin andaj, mbrojtja penale është e mjaftueshme për pronën personale të dëmtuar, ndërsa mbrojtja juridike civile është e panevojshme andaj, konform këtij mendimi, mbrojtja civile paraqet një lloj dënimi privat kur jepen shuma të caktuara parash në emër të kompensimit të dëmit jomaterial. Ndërkaq, sipas një mendimi tjetër, kompensimi i dëmit jomaterial në të holla nuk paraqet gjobë, sepse nuk duhet të jepet në çdo rast dhe nuk është i paracaktuar në një masë, por jepet nga gjykata në bazë të vlerësimit të lirë të çdo rasti specifik dhe, meqë nëse nuk do të njihej kompensimi për dëmin jomaterial, do të rezultonte se prona mbrohet më mirë se prona personale, gjë që sigurisht nuk është e

pranueshme në aspektin juridik qytetërues dhe modern, andaj, kompensimi i dëmit jomaterial me dhënien e kompensimit të drejtë në të holla në thelb paraqet kënaqësi për personat e dëmtuar, të cilët në të vërtetë nuk mund t'i kthejnë të mirat e tyre morale të dëmtuara në gjendjen e mëparshme, por duke u kënaqur me të mirat materiale mund të arrijnë një gjendje të caktuar kënaqësie psikologjike dhe paqeje.

E drejta për shpërblimin e dëmit, përveç personave fizikë dhe juridikë, u njihet dhe një kategorie të veçantë të “personave fizikë”, akoma të palindur, por të zënë në barkun e nënës (fiksioni nasciturus). Sipas këtij fiksioni, fëmija i palindur mund të paraqitet vetëm në cilësinë e palës së dëmtuar, por jo edhe në cilësinë e autorit të dëmit. Kjo pasi edhe trupit të fëmijës akoma të palindur, fetusit, mund t'i shkaktohen lëndime trupore apo gjenetike (lëndimi i krahut, i këmbës, i kokës, gjeneve etj.). Edhe pse ende nuk e ka statusin e subjektit të së drejtës, kjo e drejtë i njihet pasi besohet se do të lindë i gjallë. Në qoftë se lind i vdekur për shkak të këtyre lëndimeve, kjo e drejtë i përket prindërve, respektivisht nënës. Për vlerësimin e frikës, dhimbjes fizike dhe dhimbjes shpirtërore, nuk ka njësi matëse, vlerësimi është kryesisht subjektiv, edhe nga analizat e mendimeve të ekspertit mjekësor, është e pamundur që me saktësi të analizohet personaliteti i personit të dëmtuar dhe intensiteti i dhimbjes së shkaktuar.

Literatura juridike civile, njeh dy mënyra përmes të cilave mund të realizohet dëmshpërblimi material: dëmshpërblimi në natyrë dhe me para, ku dëmshpërblimi në natyrë bëhet me kthimin e gjendjes së mëparshme – *restitutio in integrum in natura*, në pasurinë e të dëmtuarit ndërkaq, shpërblimi i dëmit në natyrë bëhet me kthimin e sendit në atë gjendje në të cilën ka qenë para se të shkaktohet dëmi ku këtë mënyrë të shpërblimit të dëmit e ka paraparë Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Kosovës, ashtu që kjo mënyrë e dëmshpërblimit të dëmit gjen shprehje kur dëmtuesi që e ka dëmtuar sendin e të dëmtuarit e riparon atë send ose kur të dëmtuarit i jep tjetër send me vlerë dhe lloj të njëjtë (me ndreqjen e sendit të dëmtuar ose dhënien e ndonjë sendi tjetër të llojit të njëjtë në vend të sendit të asgjësuar) ndërkaq, kur kemi të bëjmë me dëmtimin e shëndetit, kthimi në gjendjen e mëparshme bëhet me përmirësimin e shëndetit të të dëmtuarit ose aftësimin e tij për punën që e ka kryer më parë mirëpo,

në praktikë ka raste kur shpërblimi në natyrë nuk mund të realizohet dhe rasti i tillë është kur sendi i dëmtuar nuk mund të riparohet as të zëvendësohet.

Dëmshpërblimi i dëmit me para, paraqet mënyrën e shpërblimit të dëmit e cila nënkupton atë se i dëmtuari në vend të sendit të asgjësuar, merr një shumë të caktuar parash për ta blerë sendin e llojit të njëjtë dhe, kjo mënyrë e shpërblimit të dëmit gjen shprehje në rast se shpërblimi në natyrë nuk është i mundshëm, ose kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë subjekti përgjegjës, prandaj gjykata do të caktojë që ai të dëmtuarit t'ia paguajë shumën përkatëse të parave në emër të shpërblimit të dëmit dhe, shpërblimi i dëmit në para është shpërblim i dëmit me të holla si barasvlerë e përgjithshme me çrast, në praktikën gjyqësore më shumë zbatohet kjo mënyrë e dëmshpërblimit, për shkak se është më e përshtatshme dhe në disa raste shërben si e vetmja mënyrë e dëmshpërblimit.

Shpërblimi për dëmin e shkaktuar material realizohet në kontestin e veçantë civil para gjykatës kompetente dhe, në rast se dëmi është pasojë e veprës penale, Gjykata Penale mund ta shqyrtojë çështjen e dëmshpërblimit; përveç në rastet kur vërtetimi i dëmit dhe caktimi i lartësisë së tij do ta zgjaste punën e Gjykatës Penale, kjo gjykatë mund të udhëzojë të dëmtuarin në kontestin civil me qëllim të realizimit të kërkesës për dëmshpërblim.

Në aspektin komparativ poashtu, u konstatua që gjykimi i rasteve civile lidhur me shpërblimin e dëmit jomaterial, nga shteti në shtet ndryshon, dhe lartësia e kompensimit për dëmin jomaterial në disa shtete ka shuma fikse të kompensimit dhe unifikim të shumës të shprehur në të holla siç është në SHBA, ndërkaj, në disa shtete të tipit euro-kontinental, gjykatat vlerësojnë të mirën e dëmtuar, varësisht nga intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve për dëmin jomaterial.

Duhet theksuar se ndër kriteret më të rëndësishme që i merr parasysh gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial janë: lartësia e dëmit, shkalla e fajit, gjendja materiale e dëmtuesit dhe e të dëmtuarit.

Si raste të veçanta të shpërblimit të dëmit jomaterial, të cilat u trajtuan në këtë hulumtim më gjerësisht, ishin: shpërblimi i dëmit për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit, shpërblimi i dëmit për shkak të shkaktimit të vdekjes, shpërblimi i dëmit të shkaktuar me cenimin e dinjitetit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta dhe shpërblimi i dëmit kur dëmin e shkaktojnë shumë subjekte.

Në këtë hulumtim duke analizuar praktikën gjyqësore të Republikës së Kosovës në këtë temë, gjetjet treguan për veprime nga më të ndryshmet, sidomos në gjykatat e shkallës së parë, kur bëhet matja e masës së kompensimit të drejtë monetar për dëmin jomaterial ku, krahas kriterëve të përmendura tashmë nga Ligji i Detyrimeve dhe atyre që janë zhvilluar dhe verifikuar nga praktika gjyqësore, padyshim është e nevojshme të bëhet diçka më shumë për të siguruar uniformitetin e praktikës gjyqësore në këtë çështje me qëllim të zbatimit të parimit themelor kushtetues të barazisë së qytetarëve para ligjit dhe gjykatës.

Një problem i veçantë në vete, në këtë drejtim janë ekspertizat, gjegjësisht, pavarësisht se gjyqtari është laik në mjekësi dhe se për këtë ka nevojë për ndihmën e një mjeku ekspert, hulumtimi gjeti që ndonjëherë ka qasje shumë të ndryshme në gjetjet dhe mendimet e ekspertëve, sidomos kur bëhet fjalë për përcaktimin e përqindjessë reduktimit të aktivitetit jetësor meqë gjykata nuk mund të japë një dëmshpërblim të drejtë monetar pa konstatimet dhe mendimet e ekspertëve, por problemi është se nuk ka kriterë përgjithësisht të pranuar sipas të cilave përcaktohen përqindjet e uljes së aktivitetit jetësor meqë edhe vetë ekspertët nuk deklarojnë se ku e bazojnë përqindjen e deklaruar të uljes së aktivitetit jetësor, pra një ekspert jep 15%, dhe një tjetër ekspert jep 35% për dëmtime apo pasoja të njëjta ose shumë të ngjashme.

REKOMANDIMET

Duke u bazuar në konkluzionet dhe gjetjet e këtij hulumtimi si dhe objektivat kryesore që synohen të arrihen lidhur me shpërblimin e dëmit jomaterial në Republikën e Kosovës, në raport me vendet e rajonit dhe me vendet e Bashkimit Evropian, rekomandimet tona janë si vijon:

- Të bëhet unifikimi i lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, përmes dhënies së mendimeve juridike nga Gjykata Supreme e Kosovës;
- Të bëhet plotësimi dhe zgjerimi i legjislacionit civil në Republikën e Kosovës me dispozita ligjore për shpërblimin e dëmit jomaterial, ngjashëm si me “Ligjin për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje”, veçanërisht gjatë zbatimit të konceptit të dëmit jomaterial që u shkaktohet personave juridikë, me qëllim që edhe këta të shpërblehen;
- Gjithashtu, duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë edhe rrethi i personave të familjes që kanë të drejtë të përfitojnë nga e drejta për shpërblim të dëmit jomaterial me rastin e cenimit të të mirave personale të anëtarit të familjes;
- Meqenëse edhe “bashkëshorti” jashtëmartesor, ka të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial me rastin e vdekjes së “bashkëshortit” tjetër jashtëmartesor, në qoftë se mes tyre ka pasur bashkësi jetese të vazhdueshme, rekomandohet që duhet të kufizohet një minimum i kohëzgjatjes së periudhës kohore të bashkësisë së faktit që të njëjtët të konsiderohen si “bashkëshortë”, për të realizuar këtë të drejtë bashkëshorti jashtëmartesor pasjetues;
- Rekomandohet që praktika gjyqësore në Kosovë të unifikohet dhe të ndjekë praktikën e GJEDNJ në Strasburg, duke mos lejuar bartësit e funksioneve publike (veçanërisht politikanët), që paditë për shpifje kundër gazetarëve t’i

shfrytëzojnë për presion ndaj medias dhe disiplinim të gazetarëve, me ç'rast vjen deri te kufizimi i lirisë së shprehjes. Në këto raste praktika gjyqësore duhet të balancojë në mes të lirisë së shprehjes si interes publik dhe ruajtjes së nderit dhe reputacionit si interes, kryesisht privat;

- Me rastin e përcaktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, do të ishte më i drejtë përcaktimi i kriterëve për lartësinë e dëmit jomaterial me dispozita juridike, pasi kjo do të kontribuonte në zvogëlimin e numrit të kontesteve gjyqësore për shpërblimin e dëmit jomaterial, do të përcaktonte shpërblim më të përafërt për raste përafërsisht të ngjashme, si dhe për qytetarët do të mundësohej që në rrugë më të shpejtë dhe në tërësi të realizojnë të drejtën për shpërblim të dëmit jomaterial; dhe
- Për shkak të rritjes së teknologjisë dhe industrisë, si dhe mundësisë së shkaktimit të dëmit, çështja e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga këto veprimtari paraqet çështje të rëndësisë së veçantë, prandaj rekomandohet që nëpër fakultetet e drejtësisë ku akoma rregullat e shkaktimit të dëmit dhe shpërblimit të tij mësohen në kuadër të lëndës “E drejta e detyrimeve”, apo “E drejta civile”, të ndahen dhe të mësohen si një lëndë e veçantë mësimore, me emërtimin: “E drejta deliktore” apo “E drejta jashtëkontraktore” ashtu siç e kanë shumë fakultete juridike në Evropë.

L I T E R A T U R A

I. TEKSTE UNIVERSITARE DHE PUBLIKIME SHKENCORE

- Alishani, Alajdin, E drejta e Detyrimeve, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 1989.
- Morina, Sevdai, Disertacion i Doktoratës – Kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për caktimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës, Tiranë, 2017.
- Galgano, Françesko, E drejta Private, 1. Hyrje-Pronësia, Tiranë, 2003.
- Alishani, Alajdin, Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose veprimtaritë e rrezikshme në të drejtën kontinentale (Civil Law) dhe në të drejtën anglosaksone (Common Law), Prishtinë, 2011.
- Aliu, Abdulla, E drejta Civile, Prishtinë , 2013.
- Altin Shegani, Ylli Pjetërnikaj, Valbona Nano : E drejta – Law, nr. . 1 - 4 / 2 0 1 6.
- Antiç Oliver, E Drejta e Detyrimeve, botimi i gjashtë, Beograd, 2011.
- Bardhi, Anita, Përgjegjësia civile për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga të tretët në legjislacionin shqiptar (Disertacion i doktoratës), Tiranë, 2016.
- Bjelajac, Željko, Bingulac, Nenad (2016): Tendencije u sistemu izvršenja sankcija u evropskom krivičnom zakonodavstvu. Evropsko zakonodavstvo.
- Blagojević, T. Borislav (ur.). (1970): Njemački građanski zakonik (od 1986. godine): opći dio i obvezno pravo (§§ 1. do 853): tekst koji vrijedi u SR Njemačkoj. Institut za uporedno pravo, Beograd.
- Dauti, Arta, Compensation for Immaterial (Moral) Damage Due to Violation of Personality Rights in Kosovo, ACTA UNIVERSITATIS DANUBIUS, Vol. 13, no. 3/2017.

- Dauti, Nerxhivane, E drejta e detyrimeve, (Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë), Prishtinë, 2004.
- Dieter, Pscheidl, Tendovi u ishlplati naknade nematerijalne štete u nekim evropskim zemljama, Revista e ligjit të sigurimeve, NR.4/2006,
- Deliaj, Harjeta & Mitrushi Floralba, Dëmi ekzistencial, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, 2009.
- Erdelevsky, A.M. (2004). Moral damage: analysis and commentary of legislation and judicial practice. 3-rd ed. Ëolters Kluëer, 103.
- G.Galev, J. D. Anastasovska – Obligaciono pravo, Shkup, 2012.
- Gjata, Rrustem, Detyrimet Jashtëkontraktore, "Muza", Tiranë, 2010.
- Harvey, Barbara, Marston, John (2009): Cases and Commentary on Tort. Oxford, Oxford University Press.
- Hetemi, Mehdi, E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste, Prishtinë, 2002.
- Ina Hoxhaj: Pohimi dhe heshtja si mjet prove në gjykimin civil, "Avokatia", nr. 26, viti 2018.
- Jacqueline MORAND-DEVILLER, *Droit administratif: cours, thèmes de réflexion, commentaires d'arrêts avec corrigés*, Issy-les-Moulineaux, Jacqueline MORAND-DEVILLER, 2015, 808 p. (ISBN 978-2-275-04251-0)
- Jashari, Adnan, E drejta afariste - statusore, Tetovë, 2012.
- Kavran, Dragoljub (1992), Odgovornost za štetu nanetu radom uprave u uporednom pravu, sa posebnim osvrtom na anglosaksonsko pravo. Pravni život.
- Lars Noah, Comfortably Numb: Medicalizing (and Mitigating) Pain-and-Suffering Damages, 42 U. Mich. J. L. Reform 431 (2009)
- Lubisha Millosheviq: "E drejta e detyrimeve", 1972, Prishtinë.
- Maida Bećirvović - Alić & Amela Ahmatović - Ljajić, Naknada nematerijalne štete u teoriji i sudskoj praksi Republike Srbije, Sfidat Ekonomike, Viti 7, Issue 13.
- Mamuti, Afet, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni (Disertacion i doktoratës), Tiranë, 2013.

- Mariana, Semini (Tutulani), E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2002.
- Menzies, Ken, Vass, A. Antony (1989): The impact of historical, legal and administrative differences on a sanction: Community service orders in England and Ontario. *The Hoëard Journal of Crime and Justice*, 28(3)
- Metalla, Anisa, Avokate, Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, Nr.2/2012, dt.23.05.2012.
- Michel Cannarsa, Compensation for Personal Injury in France.
- Mrvić-Petrović, Nataša (2000), Pravo oštećenog krivičnim delom na naknadu štete u Velikoj Britaniji i SAD. Pravo: teorija i praksa.
- Muharremi, Merita, Përgjegjësia civile nga dëmet e shkaktuara nga automjetet në Kosovë dhe Shqipëri (Disertacion i doktoratës), Tiranë.
- Olldashi, Enkeleda, E drejta Romake, 2013, Tiranë.
- Par ex. Ch. Broche, "la notion juridique de dommage en droit de la responsabilité civile extracontractuelle", thèse 2010, Université de Grenoble
- Petrović, Zdravko, Dožić, Nikola (2011), Naknada nematerijalne štete u njemačkom pravu. U: M. Vasiljević, & V. Čolović (Ur.). Uvod u pravo Nemačke (str. 454–470). Institut za uporedno pravo, Beograd.
- Počuča, Milan (2008): *Naknada nematerijalne štete zbog pretrpljenog straha*. Privredna akademija, Novi Sad.
- Počuča, Milan (2008), Naknada nematerijalne štete zbog pretrpljenog straha. Privredna akademija, Novi Sad.
- Pop Georgiev, D. E drejta e detyrimeve”, Shkup, 1985.
- Popović, Slavoljub (1992), Odgovornost države i organizacija koje vrše javna ovlašćenja za štetu nanetu građanima i pravnim licima. *Pravni život*, 42(11–12), 1914–1925.
- Pscheidl, Dieter (2006): Trendovi u isplati naknade nematerijalne štete u nekim evropskim državama. *Revija za pravo osiguranja*, (4).

- Radevska, Marija, Kriteret për përcaktimin e dëmeve jopasurore në të drejtën tonë dhe ligjin krahasues, Republika e Maqedonisë, 2012.
- Radišić, Dr. Jakov, Obligaciono Pravo, Opšti deo, Beograd, 1979.
- Sallabanda, Andon, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 1962.
- Stanišić, Slobodan (2013), Odgovornost za štetu uslijed terorističkih akata javnih demonstracija i manifestacija U: Z.Petrović, N.Mrvić-Petrović (Urednici), *Osiguranje naknada štete* (fq. 124–125), Intermex, Beograd.
- Trifunović, Predrag (2004), Pravična novčana naknada nematerijalne štete. U: *Naknada štete i ugovor o osiguranju* (fq. 119–137), Privredna akademija, Novi Sad.
- W.V.Harton Rogers, Comparative Report in Damages for Non-Pecuniary Loss in a Comparative Perspective 246 (W.V. Harton Rogers ed.,2001) at 268-75, in G.Comande, Doing Away with Inequality in Loss of Enjoyment of Life, op.J.,Vol.1/2009, paper n.2 pp.1-18, fq. 5.
- Wagner, J. Wieńczysław (1982), Pretium doloris: pain and suffering. *The American Journal of Comparative Law*, 30(1), fq. 117–127).
- Zimmermann, R. (1996) “The law of obligations: Roman Foundations of the Civilian Tradition”, Published in the United States by Oxford University Press Inc., New York.

II. KODE, LIGJE DHE AKTE TË TJERA JURIDIKE

- Kodi Civil i Republikës Federale të Gjermanisë, i miratuar më 18 gusht të vitit 1896 dhe që ka hyrë në fuqi në 1 janar 1900
- Kodi Civil Francez (Kodi i Napoleonit), i cili ka hyrë në fuqi më 21 mars 1804.
- Kodi Civil i Përgjithshëm Austriak, i cili është miratuar më dt. 01.06.1811 dhe ka hyrë në fuqi me 01.01.1812.
- Kodi Civil Italian, i lëshuar me dekretin mbretëror n.262, dt. 16 mars 1942, ndërsa në mënyrë simbolike ka hyrë në fuqi më 21 prill 1942.
- Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i miratuar dhe i hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 2200 A (XXI), të datës 16 dhjetor, 1966, ka hyrë në fuqi më 23 mars, 1976.
- Nerxhivane Dauti, Abdulla Aliu, Ruzhdi Berisha, Adem Vokshi, Komentari - Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve- Libri I, Prishtinë, 2013.
- Kom. ZOO I (Zakona o Obligacionim Odnosima) Beograd, 1980.
- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-077.
- Ligji Civil kundër shpifjes dhe fyerjes i Republikës së Kosovës.
- Ligjit për marrëdhënie të detyrimeve i Maqedonisë, (Gazeta Zyrtare, Nr.18, dt. 5.03.2001).
- Ligji për detyrimet i Republikës së Malit të Zi, botuar në Gazetën Zyrtare, Nr. 47/2008, datë 07.08.2008.
- Ligji për procedurën kontestimore i Kosovës.

- Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga autopërgjegjësia, dt.15.09.2016, miratuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
- Ligji Nr.04/L-018 “Për Sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia”.
- Ligji për marrëdhëniet e Detyrimeve të Republikës së Serbisë, "Gazeta Zyrtare e RSFJ", Nr. 29/78, 39/85, 45/89 - vendimi i USJ dhe 57/89, "Gazeta Zyrtare e RFJ", nr. 31/93, "Gazeta Zyrtare e SCG", nr. 1/2003 - Karta Kushtetuese dhe "Gazeta Zyrtare e RS", nr. 18/2020.
- Rregullore mbi Procedurat e trajtimit të kërkesave për Kompensimin e dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm nga auto-përgjegjësia” Bordi i Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës miratoi këtë Rregullore më 27 dhjetor 2012.
- Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga autopërgjegjësia, miratuar nga bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, më 31 gusht 2016.
- Ligji numër 8510 datë 15.07.1999, për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore në Republikën e Shqipërisë.
- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Republikës Serbe, ("Gazeta Zyrtare e RSF", Nr. 29/78, 39/85, 45/89 dhe 57/89) ("Gazeta Zyrtare e R BiH", Nr. 2/92, 13/93 dhe 13/94) ("Gazeta Zyrtare RS", Nr. 17/93 dhe 3/96.
- Udhëzues, i miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, nr.41/2023 dt. 27.02.2023.

III. VENDIME GJYQËSORE

- Aktgjykim i Gjykatës së Apelit – Prishtinë, Ac.nr. 2082/2014, dt. 18.01.2017
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, C.nr. 418/17, dt. 19.12.2018
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3296/14, dt. 06.12.2019
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3472/14, dt. 04.02.2020
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1851/2015, dt.05.02.2020
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3340/13, dt. 29.01.2020
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, C.nr. 3146/2015, dt. 23.12.2019
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.829/2013, dt.18.11.2016
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr. 381/2015, dt. 09.03.2018
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.391.2015, dt.25.06.2018
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.384/2016 dt. 31.10.2018
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin C.nr.720/2016, datë 10.08.2023
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3340/13, dt. 29.01.2020
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash, C.nr.116/2011, dt. 15.02.2013
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2657/2015, dt. 01.12.2021
- Aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1031/15, dt.12.11.2021

- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3076/2016, dt. 04.10.2021
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PP/II.nr.6355/2015, datë 01.03.2017
- Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr. 3175/16, dt. 18.10.2019
- Revizion i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 133/2008 dt. 05.11.2008
- Revizion i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 133/2008 dt. 05.11.2010
- Revizion i Gjykatës Supreme të Serbisë, Rev.nr. 4518/94 dt. 21.09.1994
- Revizion i Gjykatës Supreme të Vojvodinës, Rev. nr. 176/87
- Revizion i Gjykatës Supreme të Serbisë, Rev. nr. 2606/99 dt. 6.10.1999
- Revizion i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 196 /2008 dt. 15.11.2010
- Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr. 12, dt. 13.09.2007 dhe 14.09.2007.

IV. BURIME NGA INTERNETI

- https://www.lemonde.fr/argent/article/2015/02/18/indemnites-pour-prejudice-moral-l-affaire-tapie-a-change-les-regles-fiscales_4578830_1657007.html
- <https://legaldesk.it/blog/danno-non-patrimoniale-da-sapere>
- <https://www.consulenzalegaleitalia.it/danno-patrimoniale-non-patrimoniale/>
- <https://www.anwaltfinden.at/ratgeber/schadenersatzrecht/schadenersatz/>
- <http://www.erevija.org/pdf/articles/ser/drDieterPscheidel42006.pdf>
- <http://www.jus.unitn.it/cardozo/review/2002/cannarsa.pdf>